

# BOSIMET

QË KANË  
MË SHUMË  
RËNDESI

W. T. Purkiser

# A ka vërtet rëndësi se si besoni?

A ka vërtet rëndësi sesi ju besoni? Sipas autorit, përgjigja është po. Besimet tona janë, në fakt, baza sesi ne jetojmë. Ne ia përkushtojmë veten tonë dhe jetën tonë asaj që ne besojmë se ka vlerë më shumë se gjithçka.

Pyetja në të vërtetë nuk do të jetë kurrë “A do të besoj?” Ne të gjithë jetojmë për diçka. Pyetja është “Çfarë (ose kë) të besoj?”

Nga natyra e besimit tek shpresa e së ardhmes sonë, W. T. Purkiser siguron një nga përmbledhjet më të shkëlqyera, që janë shkruar ndonjëherë, mbi besimet që kanë më shumë rëndësi.

W. T. Purkiser (1910-92) ka qënë një shkrimtar shumë i frytshëm, studiues i respektuar, një predikues i dashur brenda Kishës së Nazaretasit, e cila gjithashtu ka qënë një zë i rëndësishëm në komunitetin ungjillor të krishterë. Ai është autor ose bashkëautor i disa prej veprave më të njohura dhe më jetëgjata të traditës uestliane të shenjtërisë.

**BESIMET  
QË KANË  
MË SHUMË RËNDËSI**

**Beliefs That Matter Most  
Albanian**

**BESIMET**  
**QË KANË**  
**MË SHUMË RËNDËSI**

Nga  
W.T. Purkiser, Ph.D.

Të drejtën e botimit 1959  
Nga Beacon Hill Press of Kansas City

Përkthyer në shqip nga  
Elsa Ndreçka

Botuar në gjuhën shqipe nga Fondacioni: " Kisha Shqiptare e Nazaretasit",  
me lejen nga Beacon Hill Press of Kansas City  
Kansas City, Missouri

Shkrimet e Shënjtja janë marrë nga Diodati i Ri  
(po te mos jete thënë ndryshe)

Shtypur nga  
Vernon Publishing  
2004  
Tiranë, Albania

## Parathënie

Qëllimi i këtij libri të vogël është të përpiqet ta bëjë “besimin që u qe trasmetuar shenjtorëve një herë e përgjithmonë” (Juda 3) me interes dhe të kuptueshëm për të rinjtë e ditëve të sotme. Pjesa më e madhe e materialit është botuar si një seri artikujsh në botimet periodike *Conquest (Pushtimi)* që në 1958, dhe është ribotuar me lejen e Dr. J. Fred Parker, që ishte redaktor i *Conquest* për atë kohë.

Lexuesit e librave shkollorë mund ta vënë re mungesën e citimeve dhe shënimeve plotësonjëse në fund të faqeve (përveç citimeve nga *Kisha e Nazaretasit: Kushtetuta dhe Qeverimi*). Arsyeja nuk është se autori nuk u jep atyre asnjë meritë. Ata që e njohin literaturën do të vënë re me siguri sa i madh është vlerësimi që u bëhet atyre. Por synimi i librit nuk është të vërtetojë por të shpjegojë. Prandaj mjetet për studimet teknike janë lënë mënjanë, shpresojmë pa humbur saktësinë në përgjithësi dhe të shprehurur e kujdesshëm.

Për të qënë më të saktë, titulli i librit do të ishte *Disa besime që kanë më shumë rëndësi*. Shumë tema të rëndësishme nuk janë prekur fare, dhe disa të tjera janë prekur shumë pak. Kjo, pjesërisht sepse në origjinë libri është një seri artikujsh periodikë, dhe pjesërisht për shkak të dëshirës për t’i dhënë më shumë hapësirë subjekteve që janë më të hapura ndaj keqkuptimeve.

Dy burra po debatonin për doktrinën Monro, dhe njeri e akuzoi tjetrin se nuk ishte amerikan i vërtetë. Ky ju përgjigj atypëraty: “Por unë besoj në doktrinën Monro. E dua doktrinën Monro. Unë do luftoja deri në vdekje për doktrinën Monro. Unë të thashë vetëm se nuk e kuptoj.”

Kjo është arsyeja pse e botojmë këtë paradë të *Besimeve që kanë më shumë rëndësi* për të treguar edhe një herë se çfarë kupton besimi i krishterë.

Shpreh mirënjohjen time për Ponder W. Gilliland, ish sekretari ekzekutiv i RNN (Rinisë Ndërkombetare Nazaretase), pa interesimin e të cilit ky libër nuk do të ishte i mundur.

W.T. Purkiser

# Përmbajtja

## KAPITULL:

1. Besimet rreth sferës së besimit ..... 9  
Besimet janë të rëndësishme: Objekti i besimit fetar;  
Si e zbulon Perëndia veten e Tij.
2. Besimet rreth Perëndisë Trini ..... 25  
Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezus Krisht: Zoti Jezus  
Krisht, shpresa jonë; Fryma e Shenjtë e Perëndisë;  
Trinia
3. Besimet rreth shpengimit ..... 38  
“Ç’është njeriu, që të bie ndërmend për të?” Mallkimi  
i mëkatit: Pickimi helmues i gjarpërit: Çmimi i  
shpengimit
4. Besimet rreth jetës së re në Krishtin ..... 52  
Një përvojë personale; Pjesa e njeriut në shpëtim; Pjesa  
e Perëndisë në shpëtim; Fitore mbi mëkatin
5. Besimet rreth shenjtërimit të plotë ..... 65  
Çfarë është shenjtërimi? Gjerësia e mësimit të Dhjatës  
së Re: Ana njerëzore e shenjtërisë: Ana hyjnore e  
shenjtërimit; Disa çështje praktike
6. Besimet rreth kishës dhe të ardhmës ..... 81  
Kisha dhe kishat; Kisha dhe shërimi hyjnor;  
Eskatologjia: E ardhmja

## BESIMET E NDRYSHME RRETH SFERËS SË BESIMIT

Feja është një nga faktet madhore të jetës njerëzore. Edhe ata që nuk kanë të bëjnë fare me të, siç thonë vetë, nuk mund ta mohojnë rëndësinë e saj mbarëbotërore. Njerëzimi është fetar i pakurueshëm.

Mund të thuhet me të drejtë, atëherë, se njeriu do që të adhurojë diçka. Perënditë e tij mund të jenë perëndi të rreme. Edhe “njeriu i vetë-bërë,” siç thuhet ndonjëherë, mund të adhurojë “krijuesin” e vet, pra veten e tij, dhe kjo është idhujtaria më e madhe nga të gjitha. Por ai do të adhurojë. Ai do t’ia kushtojë veten e tij dhe jetën e tij asaj që ai beson se vlen më shumë. Ai duhet të zgjedhë cilit do t’i shërbejë. Martin Luther e ka shprehur mirë: “Çfarëdo pra, pas të cilës jepet zemra juaj, dhe mbi të cilën mbështetet zemra juaj, është pikërisht zoti juaj.”

### BESIMET JANË TË RËNDËSISHME

Kjo do të thotë se, nëse duam të jemi apo jo, të preokupuar rreth çështjes së besimit. Vërtetë ne jetojmë në një epokë e cila mburret me “realizmin” dhe që e shikon me dyshim besimin dhe të besuarit. Shkenca dhe ajo që pretendohet se është mbështetja e saj vetëm në *faktet*, duket se ka grumbulluar së tepërmi fe dhe besim deri në kufinj të jetës, për të mos thënë përtej kufijve të preokupimit të saj.

Ajo çfarë të gjithë ne duhet të bëjmë, është, të kemi një mendim të përkorë rreth *Besimeve që kanë më tepër rëndësi*, dhe pikësëpari rreth vetë besimit për jetën se si duhet ta jetojmë. Sepse, ashtu si ne do të shikojmë së shpejti, jo vetëm të drejtët rrojnë me anë të besimit, por edhe të padrejtët. Tamam edhe pyetja e vërtetë nuk shtrohet “A do të adhurojmë?” por “Kë do të adhurojmë?” po ashtu edhe pyetja



përfundimtare nuk shtrohet “A *do* të besojmë?” por “Çfarë (*ose kë*) *do* të besojmë?”

### 1. *Natyra e besimit.*

Së pari, le të flasim rreth se çfarë *do* të thotë *të besosh*. Të besosh, në përgjithësi, *do* të thotë ta marrësh për të vërtetë atë që nuk mund të provohet me siguri absolute dhe ta mbash atë me aq mirëbesim sa të jetoje me anë të saj. Në këtë mënyrë një besim ndryshon nga një opinion. Opinione janë ato rreth të cilave njerëzit debatojnë; besimet janë ato me anë të të cilave njerëzit jetojnë.

Ka një lidhje të ngushtë midis besimit dhe jetës. Të gjitha qëniet njerëzore jetojnë me anë të besimit. Ne besojmë se dielli *do* të lindë nesër, dhe askush nuk del ta vërë në diskutim shumë seriozisht këtë pikë. Por kush *do* ta *provonte* në mënyrë absolute, para se të ndodhë, që dielli *do* të ngrihet? Ne besojmë se ushqimi që hamë, *do* të na japë fuqi, por shumë kanë ngrënë dhe kanë vdekur. Idetë për të cilat ne mund të jemi absolutisht të sigurtë, janë shumë të pakta, dhe shumica prej tyre mund të shikohet se janë siguri në sferën shpirtërore.

Të futësh paratë në një bankë dhe të pranosh një çek janë akte besimi. Edhe vetë paraja është e bazuar në besimin ndaj qeverisë që e hedh atë në qarkullim. Dashuria, martesat, besimi ynë në integritetin dhe ndershmërinë e miqve tanë, madje edhe bisedat - të gjitha këto, dhe qindra detaje të tjera të jetës që ne i marrim si të garantuara, janë raste të të besuarit. Në shumicën e rasteve, besimi është i justifikuar. Në disa raste, për fat të keq, provon se është i gabuar.

### 2. *Besimi dhe fakti.*

Që këtu *do* dalim me një tjetër ide shumë të rëndësishme. Vlera e një besimi nuk mbështetet në sinqeritetin e atij që beson. Askund në jetë nuk është e vërtetë që “s’ka rëndësi se çfarë ti beson, mjafton që je i sinqertë.” Njerëzit më të rezikshëm në botë sot, janë ata që besojnë një gënjeshtër të stërmadhe dhe janë krejtësisht të sinqertë në atë besim.

Për shembull, Pali në 2 Thesalonikasve 2 thekson se ka nga ata që do t'i besojnë gënjeshtres dhe do të dënohen në atë besim. Ai tregon se ata kanë patur shanse të bollshme për të njohur dhe besuar të vërtetën, por refuzuan të bëjnë kështu. Dhe ai thotë se shpëtimi ynë është me anë të “shenjtërimit të Frymës dhe të besimit në të vërtetën” (vargu 13).

Reflektoni pak mbi këtë frazën e fundit, dhe çështja bëhet e qartë. Dy fjalët kryesore janë, sigurisht, *e vërteta* dhe *besimi*. Ato e kanë vendin së bashku, por ndonjëherë ndahen. *E vërteta* është se çfarë aktualisht është reale. *Besimi* është bindja jonë se çfarë është aktualisht reale.

Si të tilla, mund të ketë të vërteta që nuk besohen, tamam siç mund të ketë besime që nuk janë të vërteta. Por e vërteta vlen ndërkohë që ajo besohet, dhe besimet janë të parrezikshme kur janë të vërteta. Nuk është kurrë mjaft, pra, të jesh i sinqertë kur beson. Ne duhet të kemi të drejtë në ato çfarë besojmë. Nga ana tjetër, e vërteta mund të na prezantohet, por ne mund të dështojmë apo të refuzojmë ta besojmë atë.

Mbani mend, ne nuk po themi se sinqeriteti nuk është i rëndësishëm. Por ajo që po themi është se ai nuk është i mjaftueshëm. Të gjithë ata që janë të shpëtuar janë të sinqertë. Por nuk rrjedh nga ky fakt që të gjithë ata që janë të sinqertë janë të shpëtuar (ose të sigurtë), ashtu si dhe nga fakti që të gjitha delet kanë bisht nuk rrjedh se të gjitha kafshët me bisht janë dele. Disa janë dhi.

### 3. *Besimi dhe zgjedhja.*

Tani del një tjetër çështje që duhet marrë në shqyrtim. Të besosh është diçka që ne e bëjmë, dhe ne mund të zgjedhim të besojmë ose të refuzojmë të besojmë, si mund të jetë rasti. Sigurisht, ka disa besime që ne ndihemi kaq të shtrenguar t'i mbajmë, të paktën nëse duam që bota të ketë kuptim për ne. Por në shumicën e rasteve, të besosh është një akt i vullnetshëm. Ne zgjedhim të besojmë ose ne zgjedhim të mos besojmë. Kjo mund të thuhet ndryshe, që ka një element përkushtimi në besim.

Po të mos qe kështu - domethënë që besimi të ishte diçka që ne të ishim të detyruar ta kemi, dhe rreth të cilit ne të mos kishim liri zgjedhjeje - atëherë ne nuk do të ishim më të lirë, por thjesht ca makina që i binden impulseve më të forta që do të vinin tek ne nga jashtë. Jeta do ta humbte kuptimin e vet, dhe të dyja, e mira dhe e keqja, e vërteta dhe e gabuara do të ishin etiketa pa kuptim. Çdo gjë që është e arsyeshme thërret se kjo nuk është kështu. Jeta që ne jetojmë është rezultat i besimeve që ne kemi. Dhe besimet që ne kemi nuk na janë imponuar pa miratimin dhe konsideratën tonë. Ato janë reagimi i mendjes dhe shpirtit tonë kur këta ndeshen me deklarime të së vërtetës.

#### *4. Besimi dhe arsyeja.*

Është fatkeqësi e madhe që njerëzit e kanë bërë zakon t'i vënë në kontrast besimin dhe "arsyen", sikur ato të ishin polet e kundërta të diçkaje dhe që nuk shkojnë mirë së bashku. Në realitet, të dyja edhe besimi edhe arsyeja, janë kanale përmes të cilëve ne vijmë në një njohje të së vërtetës. Ato janë aleate, jo armike. Sidoqoftë, "njeriu i arsyes" mund ta neglizhojë si të parëndësishëm besimin, ose njeriu i besimit mund ta nënvlerësojë arsyen, por të dyja në fakt janë imazhi i Perëndisë në njeriun dhe të dyja janë të një rëndësie jetike për përvojën njerëzore.

Është e vërtetë që, me anë të besimit mund të pranojmë për të vërteta gjëra që me anë të arsyes nuk mund t'i kapim plotësisht. Dikush e ka krahasuar besimin me trupat parashutistë, që lëshohen prapa radhëve të ushtrisë armike dhe që qëndrojnë në pozicion, deri sa trupat sulmues të arsyes të mund të futen dhe të fitojnë. Është në natyrën e besimit të shkojë më tej se sa, për momentin, mund të ishte në gjëndje të penetronte arsyeja.

Nëse do të na duhej të jetonim brenda kufijve të ngushtë të gjërave që mund t'i kuptojmë, atëherë të gjithë do vdisnim urie ose do të shuheshim nga etja e të ftohtit. Kush vallë mund t'i kuptojë plotësisht proceset e mistershme të jetës përmes të cilave një kokërr

gruri e mbjellë në tokë, do ta shumëfishojë veten me njëqind herë a më shumë? Por a do ta refuzonit vallë bukën në tavolinë, sepse nuk e kuptoni plotësisht misterin e jetës? A ka ndonjë ndër njerëzit e arsyes që mund të na thotë me saktësi se çfarë është elektriciteti në natyrën e vet të vërtetë? Por besimi mund të shtypë butonin dhe të gëzohet me dritë ndërkohë që arsyeja mundohet me misteret e energjisë elektrike dhe magnetike.

Të besosh, atëherë, është edhe e thjeshtë edhe e thellë. Është diçka e përbashkët për të gjithë njerëzit, por është e çmuar për shkak të vlerave që i sjell jetës. Vlera e të besuarit nuk është vetëm në sinqeritetin dhe forcën, edhe pse do të ishte i pavlerë nëse nuk do të ishte i sinqertë dhe i fortë. Vlera e të besuarit qëndron në të vërtetën që kap, dhe në fuqinë e tij për t'i sjellë jetët tona në harmoni me Perëndinë, si dhe me parimet themelore, të mëdha e të pandryshueshme të universit në të cilin Ai na ka vendosur.

## OBJEKTI I BESIMIT FETAR

Themeli i të gjithë fesë është besimi në Qënie Supreme të cilin ne e njohim si Perëndia. Pothuaj të gjithë njerëzit besojnë në ndonjë lloj perëndie. Ateizmi i vërtetë është shumë i rrallë në fakt. Armiku më i rrezikshëm i fesë nuk është ateizmi teorik. Është ai që quhet “shekullarizëm,” ose ateizmi praktik, i cili nuk e mohon egzistencën e Perëndisë në teori, por që thjesht jeton sikur Perëndia të mos kishte rëndësi.

### *1. Njohja përmes përvojës.*

Për të krishterin e vërtetë përgjigja për pyetjen, “Pse besoni në Perëndinë?” do të jetë zakonisht ajo çfarë ai ka parë në vetë përvojën e tij. “Ai më takoi një ditë, dhe jeta ime ka ndryshuar. Unë besoj në Perëndinë për shkak të asaj që ai ka bërë në mua dhe për mua.”

Edhe pse ka shumë arsye të tjera për të besuar në Perëndinë, nuk ka asnjë më të mirë se kjo. Unë mund të mendoj dhe të argumentoj rreth ekzistencës së dikujt për të cilin unë kam lexuar dhe rreth të cilit kam mësuar ca fakte. Por nuk e ve kurrë në diskutim ekzistencën

e një personi që unë e kam takuar vetë personalisht. Kjo është sa për të treguar që ka dy lloj njohjesh: ka *njohuri rreth*; dhe ka *njohje me*. *Njohja me* (dikë) gjithmonë mbart një bindje dhe siguri shumë më të madhe sesa *njohuria rreth* (dikujt).

## 2. Një besim i arsyeshëm.

Por ne duhet të marrim në konsideratë disa nga arsyet e tjera që mund të japim pse ne besojmë në Perëndinë. Shumica prej tyre varen nga fakti që ky univers siç gjendet duhet të shpjegohet në një farë mënyre. Universi egziston, ky është një fakt aq i sigurtë të cilin askush nuk mund ta hedhë poshtë. Problemi është vetëm si ta shpjegojmë atë.

a. *Shkaku dhe pasoja*. Këtu, besimi në Perëndinë si Krijuesi ofron të vetmen përgjigje me të vërtetë të mirë. Të gjitha shpjegimet e evolucionit pa Perëndinë do të kërkonin shumë më tepër besim sesa fjalia e thjeshtë por e thellë e Zanafilla 1:1: “Në fillim Perëndia krijoi.” Si mundet një njeri të besojë me të vërtetë se gjithë ky univers i pafund me strukturën e vet të komplikuar e të mrekullueshme *ndodhi* vetëm përmes rastësive të verbëra dhe të pakuptimta të natyrës?

C. A. McConnell (*Dr. C. A. Mëkonëll*) në tregimin e tij të shkurtër dhe mjaft të këndshëm, “*Vajza nga fshati në kodër*,” tregon për Kerenhappuch Day, që natyrshëm i ishte vënë nofka “Happy” Day (që do të thotë “dita e gëzuar”), e që ishte vajza e vogël e një doktori agnostik nga fshati. Ulur në prehrin e të atit, në lëndinën e shtëpisë së tyre, duke shikuar yjet e ndritshëm në qiell, një mbrëmje vere, Happy pyeti, “Babi, kush i ka bërë yjet?” “Askush s’i ka bërë yjet, Keren,” u përgjigj doktori. “Thjesh ndodhën.” Dhe megjithë këmbënguljen e saj prej fëmije, kjo qe e vetmja përgjigje që ai i jepte.

Kur u kthye nga puna të nesërmen pasdite, Dr. Day gjeti një pamje të çuditshme në dyshemenë e studios së tij. Instrumentet e tij sterile të operacioneve ishin të shpërndara rreth e përqark, dhe peshqit e kuq të familjes me sa dukej u ishin nënshtruar operacioneve madhore me pasoja fatale. Kokat u ishin prerë, bishtat u ishin këputur, dhe të përbrendshmet u ishin nxjerrë përjashta.

Mbushur me dyshime, i thirri Keren-hapuch. “Happy,” e pyeti ai me ashpërsi, “kush e bëri këtë?” Me sytë e hapur fort, e pafajshmja Happy, ngriti kokën nga babai dhe i dha të njëjtën përgjigje që ai i kishte dhënë një natë më parë. “Askush nuk e bëri, babi,” këmbëngulte ajo. “Thjesht ndodhi.”

Sigurisht arsyetimi i Happy ishte po aq i mirë sa dhe i të atit. Nëse yjet dhe universi ishte e mundur që thjesht të “ndodhnin,” atëherë edhe rrëmuja në dyshtemenë e studios mund “thjesht të ndodhte.” Por kjo botë nuk është e tillë, ku gjërat thjesht ndodhin. Dikush, kur po fliste rreth pretendimit të natyralistëve se universi është produkt i rastësisë së verbër dhe ligjit të pamenduar, tha: “Unë besoj në Perëndinë sepse unë nuk i besoj mrekuillive.” Ai donte të thoshte, se ishte më e lehtë për të, të pranonte punën e dorës së një Personaliteti Krijues Suprem, sesa të besonte në një nga më të mëdhatë e të gjithë “mrekuillive,” të tillë si krijimi i një bote si kjo e jona ndodhi thjesht rastësisht.

b. *Alternativat.* Në të vërtetë, a ka vallë ndonjë mundësi zgjedhjeje të hapur për ne përveç këtyre të dyjave? Universi ynë është ose krijimi i një Perëndie të pafundëm ose rezultati i forcave të padukshme dhe të pamenduara, prej të cilave kaosi bëhet prindi i rendit të krijuar dhe gjërat ndodhin pa një shkak të vërtetë që t’i shpjegojë.

A nuk duket faktikisht sikur besimi në Perëndinë si Krijues, kërkon më pak besim sesa besimi në “evolucionin,” ose “ligjin,” ose “materien,” ose çfarëdo tjetër që i zë vendin Perëndisë në shpjegimet moderne? Nëse mund të shikosh në thelb të tyre, “besimi” më prekës dhe më prej kalamanit që mund të gjendet është “besimi” i filozofit apo shkencëtarit që beson se ky univers e ka burimin në diçka jointeligjente dhe me synime të pavetëdijshme. Ky është në fakt, i thënë me pak fjalë, budallallek.

c. *Qëllim dhe kuptim.* Edhe një herë, vetë *lloji* i universit, që ky i yni është, na jep disa të dhëna kryesore për burimin e tij. Ngado që t’i hedhim sytë, ne gjejmë shenja që na tregojnë se bota është krijuar

me qëllim dhe kuptim. Vetë fakti, se për gjërat që nuk kanë kuptim, duket se acarohemi kaq shumë, tregon se shumica e gjërave janë pjesë që i përshtaten një të tërë racionale. Ne thjesht nuk mund ta mohojmë se gjërat që përkojnë mirë së bashku janë projektuar së bashku, dhe se ajo që ka kuptim e domethënie, është produkt i inteligjencës dhe i një Mendjeje Supreme.

Një shkencëtar i madh, Sir James Jeans (*Zoti Xhejms Xhins*), ka thënë se në qoftë se ai do të mund të besonte që një univers si i yni është produkt i rastësisë dhe forcës së pamend, atëherë, do të mund të besonte, edhe që një duzinë majmunësh, që kërcejnë përmbi një duzinë makinash shkrimi, do të shtypnin praktikisht të gjitha librat e Muzeut Britanik.

d. *Personaliteti i Perëndisë*. Në besimin në Perëndinë si Krijuesi, janë të përfshira edhe besime të tjera të rëndësishme rreth Perëndisë. Njeri është se Perëndia sigurisht që është një Person. Kjo nuk do të thotë se Ai ka një trup apo formë fizike, por se ai është Mendja e pafundme që përfytyron qëllime racionale dhe vepron në mënyrë që t'i çojë ato deri në fund.

Është e vërtetë, që ne nuk duhet ta mendojmë Perëndinë si të kufizuar në mënyrat që ne jemi të kufizuar, në kohë dhe hapësirë. Sidoqoftë është gjithashtu e vërtetë që ne jemi krijuar sipas imazhit të Tij. Prandaj, arsyeja, ndjenjat, dhe kapaciteti për të zgjedhur, të cilat ne i shohim të kufizuara në veten tonë, janë reflektim i asaj çfarë Perëndia është, sigurisht pa kufizimet e njeriut.

e. *Kuptimi për besimin*. Përderisa Perëndia është një Person i pafundëm, dhe i ka krijuar qëniet njerëzore sipas imazhit të Tij, atëherë patjetër qëllimet e Tij, për personat që Ai ka krijuar, janë të mira dhe të përsosura. Perëndia na ka vendosur ne në një botë ku ne mund të rritemi në mirësi dhe në dashuri për drejtësinë dhe të vërtetën. Por ai kapacitet që na jep mundësinë të bëjmë çka është e mirë dhe e drejtë, gjithashtu na bën të hapur ndaj mëkatit dhe ligësisë. E gjithë

përvoja jonë na tregon, se Perëndia dhe Universi i Tij janë në anën e të mirës dhe e të drejtës, në kundërshtim me mëkatën dhe ligësinë.

Kjo na bën të besojmë që Perëndia krijues do të jetë gjithashtu Perëndia shpëtimtar, që ai nuk do të na lërë të ikim kuturu në rrugën e jetës sonë, pa shenja orientuese në të, dhe vetëm me një errësi në madhe në fund të saj. Që Perëndia është i pafundëm do të thotë që ne nuk duhet të presim të dimë gjithçka që mund të dihet rreth Tij. Por që Ai është i pafundëm do të thotë gjithashtu se Ai është në gjendje të gjejë rrugët për të “arritur” tek ne, për të shfaqur apo zbuluar veten e Tij tek ne.

Sepse nuk është e mjaftueshme për ne të dimë që Perëndia egziston. Ne duhet të dime çfarë lloj Perëndie Ai është, dhe cilat mund të jenë planet dhe qëllimet e Tij për ne. Bota në të cilën ne jetojmë nuk ka kuptim pa besimin në Perëndinë. As edhe jeta që ne jetojmë nuk ka kuptim pa besimin se Perëndia në fakt e ka bërë veten të njohur, duke na treguar se cila është domethënia e jetës dhe duke na ofruar ndihmën e Tij për ta jetuar atë.

## SI E ZBULON PERËNDIA VETEN E TIJ?

Krishterimi përbën një ndryshim të madh dhe thelbësor nga të gjitha fetë e tjera të botës. Të gjitha fetë flasin për kërkimin e njeriut për Perëndinë, apo për çfarëdo që mendohet të jetë përfundimtare në univers. Besimi i krishterë bazohet fort në bindjen se Perëndia nuk ka pritur që njeriu ta gjejë Atë, por se ka ardhur tek njerëzit me një vetë-shfaqje hyjnore, me kulmin e vet në ardhjen e birit të Tij të vetëmlindur, punën shpenguese të të cilit do ta shikojmë pak më poshtë.

Kjo zbulesë e Perëndisë, siç është quajtur, është një zbulesë personale. Është komunikim, në shumë mënyra, nga Personi tek personat. Është një shfaqje e vetes nga ana e Perëndisë për qëllimet e Tij shpenguese, një shfaqje ndaj personave të krijuar sipas imazhit të Tij. Ai nuk po bën të njohur një sistem të vërtetash, si të fillë, por vetë veten e Tij. Siç e ka thënë Blaise Pascal (*Blejz Paskali*) shumë



kohë më parë, Perëndia i Biblës nuk është Perëndia i filozofëve, por Perëndia i Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, Perëndia që e bëri veten të njohur si Shpëtimtari dhe Bashkëudhëtari i njeriut në rrugën e gjatë nëpër të cilën ai duhet të shkojë.

Kur ne fillojmë të pyesim: “Si mund të ndodhin këto gjëra?” ne zbulojmë se Perëndia e ka bërë veten të njohur tek njerëzit në tre mënyra kryesore: përmes veprave të Tij të fuqishme në histori; në mënyrë supreme, në vetë Birin e Tij; dhe përmes frymëzimit të Frymës së Tij në Shkrimet. Ne duhet të shikojmë shkurt secilin prej këtyre kanaleve të zbulesës.

### *1. Zbulesa e Perëndisë në histori.*

Në veçanti, në shekujt para Krishtit, “Ai i tregoi Moisiut rrugët e tij dhe bijve të Izraelit veprat e tij” (Ps. 103:7). Ishte përmes veprave të Tij të fuqishme, kryesisht, që Zoti Perëndi e bëri vullnetin e Tij të njohur. Zbulesa ishte një regjistrim i veprave të Perëndisë; Ai thirri Abrahamin “të dilte jashtë nën yjet e qiellit” pa e ditur se për ku, por duke ditur se me kë do shkonte; Ai çliroi popullin e Tij nga skllavëria e Egjiptit; lidhi me ta një besëlidhje në Sinai, dhe u dha atyre ligjin e Tij; i udhëhoqi ata në pushtimin e tokës së premtuar; ngriti Davidin, shërbëtorin e Tij, për të paradhënë imazhin e Atij që do të vinte më pas dhe do të ishte më i madh; gjykoji idhujtarinë dhe mëkatën e popullit të Tij gjatë internimit në Asiri dhe Babiloni; duke lejuar të kthehet një mbetje e pastruar dhe e zbutur nga internimi.

Me anë të veprave të Tij të fuqishme nëpër histori, Perëndia tejçoi mësimet madhështore veçantërisht të Dhjatës së Vjetër. Ai është një Perëndi që e do dhe e zgjedh një popull për veten e Tij. Ai nuk është thjesht një spektator soditës, as një “president nderi i universit,” por Zoti sovran i historisë njerëzore. Teksa profetët e mëdhenj e panë historinë njerëzore përmes syve të besimit, ata panë të shpalosej një qëllim hyjnor në ngritjen dhe rënien e kombeve. Është e dobishme të kujtojmë sesi judenjtë i quanin librat historikë të Dhjatës së Vjetër “Profetët e të kaluarës.” Perëndia flet në histori.

Por historia e shpëtimit e Dhjatës së Vjetër është në fakt një histori jo e plotë. Hedh sytë përpara për nga vepra më e fuqishme e Perëndisë, ardhja e Krishtit. Historia shkrihet me profecinë. Ajo që tashmë ka ndodhur përzihet me atë që parashihet. Dita e Zotit s'ka ardhur ende. Mbretëria politike, që Izraeli e humbi, duhet të zëvendësohet me një mbretëri të Perëndisë, që ishte në pritje të Mbretit të saj. Këtu na parashtrohet një nga kanalet më të mëdhenj të zbulesës.

### *2. Zbulesa e Perëndisë në Krishtin.*

“Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjithave gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë. Ai është shkëlqimi i lavdisë së tij, dhe vula e qënies së tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij” (Heb. 1: 1-3<sup>a</sup>).

Vetë-shfaqja supreme dhe përfundimtare e Perëndisë është “vetë Perëndia i mishëruar në Jezus Krishtin Zotin tonë,” për të cilin Gjoni shkruan: “Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte pranë Perëndisë, dhe Fjala ishte Perëndi. Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë. Askush s’e pa Perëndinë kurrë; i vetëmlinduri Bir që është në gjirin e t’Et është ai që e ka bërë të njohur.”(Gjoni 1:1, 14, 18).

Është pra, Fjala e gjallë e Perëndisë që është zbulesa perfekte e Atit. Në fakt, është e vështirë të mendosh që një Person hyjnor mund të bëhej i njohur tek personat njerëzorë në ndonjë mënyrë tjetër përveç se përmes një mishërimi, që do të thotë, veshje e natyrës njerëzore. Një Perëndi personal mund të bëhet i njohur vetëm përmes personalitetit. Më e madhja nga të gjitha veprat e Perëndisë përmblihet mirë nga Pali kur thotë: “Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin” (II Kor. 5: 19).

### *3. Zbulesa e Perëndisë në shkrimet.*

Për këtë mund të shprehemi me të drejtë në këtë mënyrë: “Por zbulesa e Perëndisë në histori dhe në Birin e Tij ndodhi shumë kohë më parë. Si mundemi ne sot ta njohim Zotin?” Përgjigjja gjendet në Fjalën e shkruar, që është një regjistrim i frymëzuar i veprave të fuqishme të Perëndisë dhe një interpretim i frymëzuar i jetës, vdekjes dhe ringjalljes shpenguese të Zotit Jezus Krisht.

a. *Libri për epokat.* Libri që na e sjell këtë njohje është Bibla, Shkrimet e shenjta, Fjala e Perëndisë. Siç e ka thënë dikur presidenti Woodrow Wilson (*Uodrou Uilson*), ne e dimë se Bibla është Fjala e Perëndisë sepse ne zbulojmë se është çelësi i lumturisë sonë, përgjegjësisë tonë, dhe i kuptimit të jetës sonë. Fryma e Perëndisë vjen tek ne përmes Shkrimit dhe na konfronton me ungjillin e Tij.

Bibla është një libër shumë i vjetër, e megjithatë i flet kohës sonë po aq qartë dhe me aq përshtatshmëri si edhe shekullit të gjashtë para Krishtit, apo shekullit të parë pas Krishtit. Është gjithmonë i kohës, sepse e vërteta e tij është e pakohë. Natyra njerëzore që ajo përshkruan me kaq çiltërsi dhe saktësi nuk ka ndryshuar përgjatë kohrave, dhe as puna e Perëndisë në jetën njerëzore nuk ka ndryshuar.

Një shikim më nga afër na tregon që Bibla është faktikisht një bibliotekë e shenjtë prej gjashtëdhjetë e gjashtë librash, tridhjetë e nëntë prej të cilëve u shkruan para Krishtit dhe formojnë Dhjatën e Vjetër; dhe njëzetë e shtatë në Dhjatën e Re, të shkruar brenda pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë vjetëve pas kohës së Zotit tonë. Libri thotë për veten që “njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur të shtyrë nga Fryma e Shenjtë”(2 Pjetrit 1: 21).

b. *Aspekti njerëzor i Biblës.* Kjo na jep dy fakte të mrekullueshme rreth Biblës. Së pari, ishin njerëz të shenjtë të Perëndisë ata që e folën dhe e shkruan Fjalën e Perëndisë. Sepse kuptohet që, nëse Perëndia do t’u fliste njerëzve, do që e nevojshme t’u fliste përmes njerëzve, në një gjuhë që ne të mund ta kuptojmë, duke përdorur

terma që ngrihen brenda përvojës njerëzore.

Këta njerëz të shenjtë të Perëndisë vinin nga çdo stacion apo ecje e jetës. Ata ishin barinj, priftërinj, profetë, mbretër, fermerë, peshkatarë, disa të pasur, disa të varfër; disa të mirëarsimuar, të tjerë të papërgatitur nëpër shkolla. Fjalët që ata përdorën ishin fjalë që vinin nga vetë përvoja e tyre, dhe shkruan në stile nga më të ndryshmet.

Kështu pra, aspekti njerëzor i Biblës është një nga burimet kryesore të forcës së saj. Na flet ne në një gjuhë që ne nuk mund ta keqkuptojmë. Ne gjejmë në faqet e saj llojin e personit që jemi. Të shkathët apo të ngadaltë, të rrëmbyer apo të kujdesshëm, intelektualë, njerëz të veprimit, njerëz të ndjenjave të mëdha, cilido që të jetë tipi i veçantë i temperamentit dhe personalitetit tonë, ne mund ta gjejmë veten tonë në faqet e Fjalës.

*c. Aspekti hyjnor i Biblës.* Por aspekti njerëzor i Biblës është vetëm gjysma e të vërtetës. Karakteri unik i Shkrimeve nuk qëndron në trupat e tyre njerëzorë, por në Frymën hyjnore që i frymëzoi shkruarit dhe që e përdor të vërtetën për të na sjellë ne tek Perëndia. Ndërkohë që ishin *njerëzit* e shenjtë të Perëndisë që shkruan, ata folën dhe shkruan të shtyrë nga *Fryma e Perëndisë*.

Këtu ne gjejmë një ngjashmëri të mrekullueshme ndërmjet fjalës së shkruar të Perëndisë në Bibël dhe Fjalës së gjallë, ose personit të Zotit Jezus Krisht. Ne tashmë kemi parë që në kapitullin e parë të ungjillit sipas Gjonit, Jezusi përshkruhet si Fjala. Ai ishte në fillim me Perëndinë dhe Ai ishte Perëndi. E megjithatë ai u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e Tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit.

Tani, Figura qendrore e besimit të krishterë është Perëndia në formën njerëzore, Perëndia-njeri, Jezus Krishti. Në kapitullin tjetër ne do të shikojmë që ai ishte një qenie njerëzore e plotë dhe e përsosur, plotësisht njeri. Por ai ishte gjithashtu tërësia e Perëndisë Trini, plotësisht hyjnor. E gjithë jeta e tij në tokë ishte një përzierje dhe bashkim i njerëzores me hyjnoren. Fakti që ai qe njeri nuk e bënte

atë të ishte më pak Perëndi. Dhe fakti që Ai ishte Perëndi nuk e ndalonte atë të hynte tërësisht në përjetimet njerëzore me përjashtimin që ai nuk mëkatoi.

Në po këtë mënyrë kaq të mrekullueshme gjejmë përzierjen e njerëzores dhe hyjnore në Bibël. Fakti, që autorët e saj ishin njerëz si ne, nuk e bën Biblën të jetë më pak Fjalë e Perëndisë. Dhe që është hyjnore në frymëzimin e saj, dhe që përgatitja e saj u drejtua dhe u ruajt prej gabimeve nga Shpirti i të Vërtetës, nuk e ndalon Biblën të zbresë në nivelin tonë dhe të gjykojë mëkatën dhe padrejtësinë në mesin tonë.

d. *Bibla si Fjala e Perëndisë.* Por duhet të theksojmë edhe diçka tjetër. Tamam si edhe Jezusi ishte Perëndia-njeri, plotësisht, po ashtu edhe Bibla ËSHTË Fjala e Perëndisë në tërësinë e vet. Kjo do të thotë, Jezusi nuk ishte pjesërisht njerëzor dhe pjesërisht hyjnor. Ai ishte plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri, në çdo qelizë të qënies së Tij. Kështu Bibla, në tërësinë e vet, është fjala e Perëndisë për njeriun përmes njerëzve.

Ka nga ata që u pëlqen të thonë se Bibla nuk është fjala e Perëndisë, por që e *përmban* Fjalën e Perëndisë. Por kjo menjëherë e zhvesh Librin nga autoriteti i tij mbi jetën dhe mendimin njerëzor. Sepse kush është ai që do të na thotë se ç'pjesë është dhe ç'pjesë nuk është fjalë e Perëndisë? Pra, në qoftë se mendojmë për Biblën se vetëm përmban zbulesën e Perëndisë, automatikisht ne ngremë arsyen tonë, ose instiktin tonë ose gjykimin tonë për të vendosur se në ç' masë është vërtet fjala e Perëndisë dhe çfarë është thjesht guacka njerëzore në të cilën përmbahet fryti?

Dhe kështu do të gjenim disa që i heqin Biblës një pjesë dhe të tjerë që i heqin një pjesë tjetër. Disa do të fshinin historinë e krijimit, disa të tjerë historinë e rënies së njeriut në mëkat. Shumë të tjerëve do t'u pëlqente të hiqnin pjesët e mrekullive nga shkrimet. Dhe kur të gjithë kritikët të kenë mbaruar së hequri e së fshiri pjesë që ata mendojnë se është lëvozhgë njerëzore, nuk do të ketë mbetur shumë në të.

Me sa duket pjesë e problemit këtu është që ne tentojmë të mendojmë vetëm në termat e brezit tonë dhe të mënyrave tona të të parit të gjërave. Ne harrojmë se zbulesa e Perëndisë në Bibël u dha për të gjithë njerëzimin; të gjithë njerëzve, kudo qofshin dhe në të gjithë kohërat. Ndonjëherë me padurim ne mendojmë se fjala e Perëndisë duhet të na jepet sipas mënyrave të të menduarit të shekullit të njëzetë. Ajo çfarë ne harrojmë këtu është se, ndërsa të gjithë librat e Biblës u shkruan *për* ne, ata të gjithë u shkruan për njerëzit që jetuan përmes shekujve të shkuar; dhe që Perëndia i donte dhe kujdesej për ta po aq shumë sa na do dhe kujdeset për ne. Shumë prej përmbajtjes së Dhjatës së Vjetër do të marrë një kuptim të ri nëse e mbani këtë parasysh.

*e. Njerëz të një libri.* Ka një konkluzion shumë praktik që del nga e gjithë kjo. Nëse Bibla është fjala e Perëndisë, atëherë ne duhet ta njohim atë më mirë dhe ta duam atë më shumë se çdo libër tjetër. Si edhe John Wesley (*Gjon Uesli*), secili prej nesh duhet të vendosë të jetë “një njeri i një libri” - jo se ne nuk do të lexojmë apo studiojmë asnjë tjetër, por që çdo libër tjetër do të jetë i lidhur drejtësisht me të vërtetën, që na silltet me anën e shkrimeve.

Një nga shkrimtarët e lashtë të Perëndisë bën pyetjen: “Si mundet një i ri (ose sigursht edhe një e re) të bëjë rrugën e tij të pastër?” Pastaj ai jep përgjigjen: “Duke e ruajtur me fjalën tënde, Të kam kërkuar me gjithë zemër; mos më lër të devijoj nga urdhërimet e tua. E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër teje” (Psalmi 119: 9-11).

*Ne besojmë në një Perëndi që ekziston nga përjetësia, i pafund, Sovran i universit; se vetëm Ai është Perëndi, krijues dhe administrues, i shenjtë në natyrë, cilësi dhe qëllim; se Ai si Perëndi, është Trini në thelbin e qënies së Tij, i zbuluar si Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë.<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> *Kisha e Nazaretasit: Kushtetuta dhe Qeverimi*, Pjesa II, Nenet e Besimit, Neni I.

*Ne besojmë në frymëzimin e plotë të Shkrimeve të Shenjta, me të cilat ne kuptojmë 66 librat e Dhjatës së Vjetër dhe të Re, të dhënë me frymëzim hyjnor, që zbulojnë në mënyrë të pagabueshme vullnetin e Perëndisë për ne në të gjitha gjërat e nevojshme për shpëtim, kështu që çdo gjë që nuk përfshihet aty nuk duhet pranuar si një nen besimi.<sup>2</sup>*

### **Për diskutim të mëtejshëm.**

1. Në ç' mënyrë besimi kërkon përkushtim?
2. Pse nuk është e mjaftueshme thjesht të jesh i sinqertë në atë që beson?
3. Cila është baza më e mirë për të vërtetën rreth egzistencës reale të Perëndisë?
4. Tregoni disa nga pikat që e bëjnë besimin në Perëndinë një besim të arsyeshëm?
5. Në ç' mënyra mund të thuhet se Perëndia e zbulon veten tek njeriu? Ç' vend dhe vlerë ka secila prej këtyre?
6. Cila është domethënia e “aspektit njerëzor të Biblës”? Po e “aspektit hyjnor të Biblës”?
7. Cili është kundërshtimi kryesor për thënien se Bibla “përmban Fjalën e Perëndisë”?

<sup>2</sup> *Ibid.* Neni IV.

## II

# BESIMET RRETH PERËNDISË TRINI

Në kapitullin e mëparshëm pamë që besimi fetar ka për objekt Personin suprem që ne e njohim si Perëndia. Ne pamë gjithashtu se Perëndia i një universi moral si ky, në të cilin ne jetojmë, me siguri që do ia zbulonte veten krijesave të Tij. Kjo zbuluesë, pohojnë të krishterët, ndodh përmes veprimit të Perëndisë në histori, dërgimit të Birit të Tij në botë, si dhe Biblës, të cilën Shpirti i të Vërtetës që e ka frymëzuar, e bën atë të jetojë për ne.

Atëherë, çfarë mund të besojmë rreth Perëndisë? Një njeri ka thënë se për të Perëndia ishte një lloj “mjegulle e zgjatur.” Por besimi nuk është fryti i kërkimit tonë të verbër pas Perëndisë. Në kuptimin e plotë të fjalës besimi është përgjigja jonë ndaj zbuluesës së Perëndisë, që na konfronton në Krishtin përmes Shpirtit të Tij. Këtu, e thënë shkurt, është ajo çfarë të krishterët duan të thonë kur ata flasin për Trininë.

### PERËNDIA DHE ATI I ZOTIT TONË JEZUS KRISHT

Asgjë më e rëndësishme s’është thënë ndonjëherë rreth Perëndisë sesa ajo që ai është “Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezus Krisht” (Ef. 1: 3). Të gjitha rrezet e të vërtetës, që kishin shkëlqyer përmes faqeve të Dhjatës së Vjetër, janë mbledhur së bashku dhe janë fokusuar në një dritë rrëzëllyese mbi fytyrën e Jezus Krishtit. Ai na tregon sesi është Perëndia. Sepse Perëndia i Biblës është Perëndia që është si Krishti.

#### *1. Një Perëndi i dashurisë së shenjtë.*

Është shkruar dhe është folur shumë rreth Perëndisë, gjë që na ndihmon të kuptojmë Atë dhe rrugët e Tij me njerëzit. Kudo në Shkrimet deklarohet se Perëndia është Shpirt i pafund; i përjetshëm



në egzistencë, që do të thotë pa fillim dhe pa fund; i pandryshueshëm dhe i përsosur; i pranishëm kudo dhe i plotfuqishëm; i gjithëditur, plotësisht i mençur, dhe plot mirësi; një Perëndi i drejtësisë, i të vërtetës dhe i hirit. Ai është Zoti i vetëm sovran i historisë që ulet në gjykimin e gjithë mëkateve njerëzore, kombëtare dhe individuale. Por përtej gjithë kësaj, Ai është një Perëndi i dashurisë së shenjtë. Kjo është ajo që ne shikojmë kur mendojmë rreth Jezusit. “Kush më ka parë mua ka parë Atin,” tha Shpëtimtari ynë në vargjet e paharrueshme të Gjonit 14: 9-10, “...fjalët që po ju them nuk i them nga vetja, Ati që qëndron në mua, është Ai që i bën veprat.”

Ati dhe Perëndia i Zotit tonë Jezus Krisht është një Perëndi i dashurisë së shenjtë: kjo përmbledh mësimet e Dhjatës së Re dhe Dhjatës së Vjetër. Ka një mendim sikur shenjtëria e Perëndisë del më shumë në pah në Dhjatën e Vjetër dhe se dashuria e Perëndisë del më shumë në pah në Dhjatën e Re. Por nuk duhet ta teprojmë në këtë pikë. Dhjata e Vjetër deklaroi dashurinë e Perëndisë: “Po, të kam dashur me një dashuri të përjetshme” (Jer. 31:3). Dhjata e Re na tregon sa e madhe është kjo dashuri: “Se Perëndia e deshi aq shumë botën, sa dha birin e tij të vetëmlindurin”(Gjoni 3:16). Po ashtu Dhjata e Re deklaroi shenjtërinë e Perëndisë: “Por ashtu si është i shenjtë ai që ju thirrri, të jini dhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj” (1 Pjetrit 1:15), ndërsa citon deklaratën e madhe të Dhjatës së Vjetër: “Jini të shenjtë, sepse unë Zoti, Perëndia juaj, jam i shenjtë” (Lev. 19:2).

Këta dy terma, shenjtëri dhe dashuri, as që mund të lejohet të shihen si të ndarë. Shenjtëria pa dashurinë do të na linte një Perëndi të gjykimin dhe zemërimin. Dashuria pa shenjtërinë do ta kuptonte Zotin si diçka vetëm pak më shumë se një ndjenjë fisnike. Në kombinimin e dashurisë me shenjtërinë ne shohim më qartë “Perëndinë dhe Atin e Zotit tonë Jezus Krishtit.”

## 2. *Shenjtëria e Perëndisë*

Të gjitha përpjekjet për të përshkruar shenjtërinë e Perëndisë përplasen në kufizimet e përvojës tonë njerëzore. Ka një rrezatim

madhështor në shenjtërinë hyjnore, që është pothuaj ekuivalenti i vetë Hyjnisë. Respekti nderues, me të cilin njerëzit e kohës së vjetër e shikonin “Të Shenjtin e Izraelit,” është një qortim i qendrueshëm ndaj çfarëdo lloj familiariteti të parespektueshëm.

Shenjtëria e Perëndisë nënkupton antagonizmin e Tij pa pushim ndaj gjithçkaje që është e mëkatshme dhe e ndotur. Ai i “ka sytë tepër të pastër për të parë të keqen dhe nuk e shikon dot paudhësinë” (Hab. 1:13). Gjithashtu nënkupton mbështetjen e tij të pandryshuar për drejtësinë, të vërtetën dhe integritetin. Jezusi u lut për dishepujt e Tij në atë që është me të vërtetë lutja e Zotit, në kapitullin e shtatëmbëdhjetë të Gjonit: “O Atë i shenjtë, i ruaj ata në emrin tënd, ata që me ke dhënë, që të jenë një sikurse ne” (v. 11). Ne do të vëmë në dukje, në kapitujt e mëpasëm, që të dyja këto aspekte të shenjtërisë së Perëndisë përfshihen në shenjtërinë, në të cilën Ai i thërret njerëzit e Tij ( I Thes. 4:7). Pra shenjtëria përfshin si një pastrim të brendshëm nga papastërtia dhe mëkati i brendshëm ashtu edhe një vajosje pozitive për shërbim dhe jetë të drejtë.

### 3. *Dashuria e Perëndisë.*

Që Perëndia është dashuri është pohimi me bindje i apostullit Gjon (I Gjonit 4:16). I gjithë hiri i Tij dhe të gjitha dhuratat e Tij rrjedhin nga ky fakt. Ishte dashuria hyjnore që nxiti krijimin e njeriut, që nxiti planin e shpengimit të njeriut kur mëkati përçau qëllimin e parë të Perëndisë, dhe që dërgoi Birin e Tij në botë për të pajtuar familjen njerëzore me Atin. “Por Perëndia e tregon dashurinë e Tij ndaj nesh në atë që, kur ne ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne” (Rom. 5:8). “Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e Tij për shlyerjen e mëkateve tona” (I Gjonit 4: 10).

Perëndia s’mund të jetë ndryshe, përveçse dashuri. Edhe ajo që Bibla e përshkruan si zemërim të Perëndisë është një shprehje e dashurisë së Tij. E kundërta e dashurisë nuk është zemërimi por urrejtja. Zemërimi i Perëndisë është ana tjetër e dashurisë,

kundërshtimi i pandryshuar i Perëndisë ndaj asaj që shkatërron ata të cilët Ai i do.

Një herë një baba dëgjoji dy djemtë e tij të vegjël duke bërë një diskutim serioz. Më i madhi i bërtiste më të voglit: “Nëse ti je i keq, babi nuk do të të dojë ty. “Babai i thirri dy djemtë e tij pranë vetes. “Kjo nuk është e vërtetë,” tha ai. “Kur ju jeni të mirë babi ju do juve me një dashuri që e bën atë të lumtur. Kur ju jeni të prapë, babi ju do ju me një dashuri që e bën atë të trishtuar.” Fakti që dashuria e Perëndisë është e drejtë dhe e shenjtë dhe, që e dënon të keqen, nuk e bën atë të jetë më pak dashuri. Në fakt, po të mos ishte dashuria kështu, atëherë nuk do të ishte dashuri fare. Ta lësh mëkatin të shkojë i papërmbajtur dhe ligësinë të shkojë e padënuar, do të ishte indifirencë shpërfillëse dhe jo dashuri e vërtetë.

## ZOTI JEZUS KRISHT, SHPRESA JONË

Në qëndër të Biblës ngrihet figura e Zotit Jezus Krisht. Kush është Ai dhe çfarë Ai mësoi, janë kriteri me anë të cilit çdo bindje që i takon besimit të krishterë, duhet të interpretohet përfundimisht.

Ka diçka rreth Jezusit që mjafton ta tregosh dhe tërheq fjalë admirimi dhe respekti. Edhe ata që kanë qënë dyshimplotë rreth fesë në përgjithësi, nuk vonojnë të shprehin vlerësim të lartë për personin dhe karakterin e Jezusit.

Por besimi i krishterë rreth Krishtit është më shumë sesa miratim i përgjithshëm i asaj që Ai ka bërë dhe ka mësuar. “Ç’ mendoni ju për Krishtin?” (Mat. 22: 42) është një pyetje që shkon drejt e në thelb të besimit, që një person mban, dhe bën ndarjen ndërmjet besimit dhe mosbesimit. Të jesh i krishterë do të thotë *më shumë* sesa të kesh pikëpamjet e duhura rreth Jezusit, por zor se mund të dojë të thotë *më pak*.

Faktikisht, çfarë ne dimë rreth Krishtit në nivel intelektual, varet nga dëshmia e Shkrimeve. Kjo dëshmi, e marrë si një e tërë, është e qartë dhe e pagabueshme, dhe jep dëshmi për dy fakte madhore rreth

personit të Zotit Jezus Krisht. Ne i përmendëm këto në kapitullin e kaluar teksa përshekruam dy të vërtetat madhore rreth vetë Biblës, por tani do t'u kthehemi edhe një herë.

### *1. Natyra njerëzore e plotë.*

I pari prej këtyre dy fakteve madhore në dëshminë e Biblës është fakti i natyrës njerëzore së Tij të plotë. Ai nuk ishte gjysëm njerëzor dhe gjysëm hyjnor. Ai ishte plotësisht njerëzor, në atë masë që “i vinte keq për dobësitë tona” dhe “u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar” (Heb. 4:15).

Këtë duhet gjithmonë ta mbajmë parasysh. E vetinja mënyrë sesi Perëndia vërtetë mund ta zbulonte veten e tij, ishte të merrte formën e natyrës njerëzore, dhe të na tregonte neve me anë të Birit të Tij, se kush është Ai, po ashtu edhe çfarë do Ai që ne të jemi. Një qenie qiellore mund të shpallë kërkesat e ligjit, por dashuria dhe hiri i Perëndisë mund të shihej vetëm kur u shfaqën në një personalitet të gjallë. Ne nuk mund të pajtoheshim me Perëndinë në qoftë se Pajturesi ynë nuk do të merrte natyrën tonë dhe të mund të kapte dorën tonë si edhe dorën e Atit tonë.

### *2. Hyjnia e Krishtit.*

Fakti tjetër madhor, të cilin Bibla e dëshmon, është fakti i hyjnisë së Krishtit. Nuk është e mjaftueshme të flasësh për “hyjninë” e Tij, pasi kishte shumë “hyj” në kohët biblike, dhe shumë “perëndi” adhuroheshin nga qytetarët e botës së Mesdheut. Dhe në qoftë se hyjnia e Jezusit do të mjaftonte për të krishterët e hershëm, atëherë ata s’do të ishin përballur me kurrfarë persekutimi, sepse atje ku ka shumë perëndi, ka vend edhe për një tjetër më shumë. Edhe sot ka shumë njerëz që flasin për “natyrën hyjnore” të njeriut ose për “shkëndijë hyjnore” në çdo shpirt njerëzor.

Pohimi i krishter rreth Jezusit është se Ai është me të vërtetë Perëndia, dhe është besimi në Hyjninë e Tij, për hir të të cilit shenjtorët dhe martirët dhanë jetën e tyre. Ata me gëzim zunë vendin e tyre në

“kishën e tij, të cilën ai e ka fituar me gjakun e tij” (Vep. 20: 28). Ata folën për, “misterin e mëshirës”: Perëndia u shfaq në mish, u shfajësua në Frymë, u duk ndër engjëj, u predikua ndër johebrenj, u besua në botë, u ngrit në lavdi” (I Tim. 3: 16). Ata jetuan në shpresën e “...të shfaqurit e lavdisë të të madhit Perëndi dhe të Shpëtimtarit tonë Jezus Krisht” (Tit 2: 13); ata folën për Të si Fjala që ishte në fillim me Perëndinë dhe që ishte Perëndi (Gjoni 1: 1); dhe ata e adhuruan Atë si “Zoti im dhe Perëndia im” (Gjoni 20: 28).

Ky besim i madh u forcua prej faktit që Jezusi nuk u lind me një proces lindjeje të natyrshëm, por u lind prej një të virgjëre, përmes fuqisë së Shpirtit të Shenjtë. Ata që e vënë në dyshim lindjen e Jezusit prej të virgjërës, duhet të mendojnë mirë alternativat e këtij besimi, sepse Shkrimet e bëjnë pagabueshmërisht të qartë se Jozefi nuk ishte babai i Zotit tonë. Është e pabesueshme sesi Perëndia do të lejonte që mishërimi i Krishtit të ndodhte në një mënyrë të tillë si sugjerohet nga alternativa.

### 3. *Qëllimi i mishërimit.*

Pse, duhet të lindë pyetja, Perëndia mori formën njerëzore në këtë mënyrë, dhe në personin e Jezus Krishtit, hyri në historinë e njerëzimit, duke i ndarë epokat më vete si para Krishtit dhe pas Krishtit, në atë çfarë dikush e quajti “llogjika e bindshme e kalendarit”? S’ mund të gjendet përgjigje më e mirë se sa përgjigjja e Shën Palit, të cituar më parë: “Perëndia e ka pajtuar botën me veten në Krishtin” (II Kor. 5: 19).

Në këto nëntë fjalë ka shumë vëllime teologjike. Tragjedia e madhe e mëkatit njerëzor kishte sjellë ndarjen tonë nga Perëndia. Kërkesat e drejta të ligjit moral duhen përmbushur, një ligj sipas të cilit mëkati sjell vdekjen po aq pashmangshmërisht dhe sigurisht sa edhe që nata vjen pas perëndimit të diellit. Duke u bërë Ai vetë Ofrimi për mëkatin tonë, Ai që nuk kishte asnjë mëkat për të cilin të meritonte vdekjen, duke siguruar një zëvendësues të pranueshëm për dënimin e mëkateve tona me anë të vdekjes së Tij në kryq, dhe duke u ngritur

sërish për shfajësimin tonë, Jezus Krishti bëhet Shpëtimtari i të gjithëve që besojnë në Të.

#### 4. *Besimi në Krishtin.*

Këto fjalët e fundit kanë të bëjnë me një çështje të cilën duhet ta shqyrtojmë me kujdes. Askund Shkrimi nuk premtonte jetë të përjetshme për ata që kanë ide të drejta rreth Krishtit, sado të rëndësishme që mund të jenë këto ide. Gjithmonë fjalët janë “Beso në,” ose, “Beso në Zotin Jezus Krisht dhe do të shpëtohesh ti dhe familja jote” (Vep. 16: 31).

Sepse të besosh mund të ketë dy kuptime. Mund të kuptojë vetëm “t’i konsiderosh për të vërteta ide të caktuara rreth diçkaje/dikujt.” Ose mund të kuptojë, ashtu siç është e drejtë në fakt, “të mbash ide të caktuara rreth diçkaje/dikujt, në atë masë sa që t’ia kushtosh jetën tënde.” Besimi nuk është thjesht një çështje intelektive. Është një vepër e vullnetit. Do të thotë, të mbështetesh në diçka ose në dikë, t’ia kushtosh jetën atij dhe ta të zgjedhësh atë si parimin që kontrollon jetën tënde.

Kështu besimi në Krishtin është besim shpëtues, kur të drejton në një dorëzim të jetës tënde ndaj vullnetit të Tij, dhe në një mbështetje të plotë në fuqinë e Tij për të shpëtuar. Por rezultatet e besimit të tillë në jetën tonë nuk janë vetëm çfarë *ne* bëjmë rreth tij, por çfarë *Ai* bën në ne. Dhe Ai punon në ne përmes Frymës së Tij të Shenjtë.

### FRYMA E SHENJTË E PERËNDISË

Kur Jezusi u përball me kryqin, Ai u tregoi dishepujve të Tij për ankthin dhe trishtimin që ikja e Tij do t’u shkaktonte atyre. Por bashkë me këto paralajmërime ai u dha edhe disa nga premtimet e Tij më të mëdha. “Unë do t’i lutem Atit,” tha Ai, “dhe Ai do t’ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju, Frymën e së Vërtetës, që bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e

njuh; por ju e njihni, sepse qëndron me ju dhe do të jetë në ju” (Gjoni 14: 16-17).

Dhe pikërisht temës së besimeve rreth Frymës së Shenjtë ne do t’i kthehemi pas kësaj në përmbledhjen e *Besimet që kanë më tepër rëndësi*. Zor se do mund të mendonim për ndonjë tjetër temë që të kishte më tepër rëndësi në të jetuarin praktik të jetës së krishterë.

### 1. “Një Ngushëllues tjetër”

Krishti tha për Frymën e Shenjtë se Ai do të ishte një Ngushëllues tjetër. Kjo fjalë ndonjëherë përkthehet “avokati” ose ashtu si do të thotë në kuptimin e vet origjinal, “Dikush i thirrur të të jetë pranë për të ndihmuar.”

Edhe fjala më e vjetër “Ngushëllues,” ka një thellësi interesante të kuptimit të vet kur përdoret për Frymën e Perëndisë. Nuk do të thotë “Dikush që jep ngushëllim apo lehtësim në pikëllim,” siç do sugjeronte kjo fjale për ne sot. Në vend të kësaj, vjen nga dy terma latine: *con*, që do të thotë “me”; dhe *fortare*, fjalë nga e cila rrjedhin fjalët tona “fortesë” dhe “fortifikoj,” që do të thotë “forcoj ose fuqizoj.” Ngushëlluesi pra, është Dikush që vjen me pushtet për t’i bërë të krishterët të fortë.

Ne do të shohim në pjesën tjetër që doktrina e krishterë mbi Trininë do të thotë njohje dhe pranim i tre Personave hynore në një natyrë ose në Perëndinë Trini. Personi i Tretë i Trinisë është Fryma e Shenjtë.

Tani le të shikojmë dy pikat kyçe. E para është personaliteti i Frymës së Perëndisë.

### 2. Personaliteti i Frymës.

Fryma e Shenjtë është një person. Asnjëherë nuk është e saktë t’i referohemi Frymës së Shenjtë si jopersonal. Ai është një personalitet hyjnor ashtu si janë edhe Jezusi ose Perëndia-Atë.

Disa emra të ndryshëm janë përdorur në Bibël për t’ju referuar Personit të Tretë të Trinisë. Në Dhjatën e Vjetër, ai quhet “Shpirti i

Perëndisë,” ose “Shpirti i Zotit.” Ne na tregohet për punën e Tij në krijim në vargun e dytë të Biblës, ku thuhet: “Fryma e Perëndisë fluturonte mbi sipërfaqen e ujërave” (Zan. 1:2).

Në Dhjatën e Re, Ai quhet “Fryma e Shenjtë,” “Ngushëlluesi,” “Fryma e Krishtit,” “Fryma e së vërtetës,” “Fryma e hirit,” “Fryma e birësimit,” dhe po ashtu “fryma e ... fuqisë, e dashurisë, dhe e një mendje të shëndoshë.”

### 3. *Hyjnia e Frymës.*

Pika e dytë kyçe që duhet patur parasysh rreth Frymës së Shenjtë është Hyjnia e Tij. Këtu Bibla na mëson se të gënjesh Frymën e Shenjtë është si të gënjesh Perëndinë (Vep. 5:3-4); Ai është i përjetshëm, ashtu si edhe Perëndia-Atë dhe Perëndia-Bir (Heb. 9:14); dhe kisha përdor forma të pagëzimit dhe të bekimit që i bashkojnë emrin e Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë në terma paralele dhe të barabartë (Mat. 28:19; II Kor. 13:14).

### 4. *Fryma dhe jeta e krishterë.*

Tani le të shikojmë ç’vend zë ky Person Hyjnor në mënyrën e të jetuarit të të krishterit. Rëndësia e kësaj mund të përmbliidhet me thënien se, kontakti ndërmjet Perëndisë Atë dhe Krishtit Jezus Birit në një rën anë dhe e shpirtit njerëzor në anën tjetër, është përmes Frymës së Shenjtë.

Jezusi ua mësoi këtë gjë qartë dishepujve të Tij gjatë bisedës së Tij të fundit me ta, në kapitujt 14 deri 16 të Gjonit. Fryma e Shenjtë do të zërë vendin e Zotit tonë Jezus Krisht në jetën e të krishterëve (14:18); Ai do t’u mësojë çdo gjë, dhe do t’u kujtojë të gjitha gjërat që Jezusi u kishte mësuar (14:26); Ai do të frymëzojë dëshminë për Krishtin (15:26-27); dhe është më mirë për të krishterët të kenë Frymën me vete sesa prezencën e vetë Zotit Jezus në mish (16:7).

*a. Puna e tij gjithë-përfshirëse.* Ne mund të shikojmë kështu se nuk ka fare jetë shpirtërore pa Shpirtin e Perëndisë. Para se të



kthehemi në besim, ne zgjohemi dhe bindemi nga Fryma e Shenjtë (Gjoni 16:8). Fillimi i një jete me të vërtetë të krishterë është rilindja nga Fryma (Gjoni 3:5-6). Ne nuk mjafton vetëm të jemi të lindur nga Fryma por edhe të pagëzuar me Frymën gjithashtu (Mat. 3:11). Dhe gjatë gjithë jetës së tij të krishterë besimtari vazhdon të udhëhiqet nga Fryma (Rom. 8:14).

*b. Zbatuesi hyjnor.* Kjo është arsyeja pse Dr. Daniel Steele (*Daniel Still*) e quajti Frymën e Shenjtë “Zbatuesi i Hyjit.” Ai ilustroi doktrinën e Trinisë duke theksuar se në çdo qeverisje ka tre funksione apo pushtete. Është funksioni legjislativ apo ligjvënës, i përfaqësuar nga parlamenti në qeverisjen tonë. Pastaj është funksioni gjyqsor, i përfaqësuar nga gjykatat e vendit. Dhe përfundimisht është edhe funksioni ekzekutiv që zbaton ligjet, i përfaqësuar nga kryeministri dhe kabineti i tij.

Kështu pra në Trini, është Perëndia Ati, ligjvënësi. Është Jezus Krishti, Biri, Gjykatësi hyjnor i gjithë njerëzimit. Dhe është Fryma e Zotit, zbatuesi.

Dhe ashtu si dhe marrëdhëniet e individit me qeverinë dhe veprimet e qeverisë, për sa kanë të bëjnë me individin, rregullohen me anë të degës ekzekutive të qeverisë, po ashtu edhe Fryma e Shenjtë është Ai që zbaton brenda jetës njerëzore vullnetin dhe planin e Perëndisë.

*c. Mëkati që nuk falet.* S’ka dyshim, që kjo është arsyeja pse i vetmi mëkat i pafalshëm i përmendur në bibël është mëkati i blasfemisë ndaj Frymës së Shenjtë ( Mat. 12:31). Të kryesh këtë mëkat do të thotë të eliminosh shpirtin tënd nga të gjitha kontaktet e mundshme me Perëndinë dhe hirin e Tij. Sepse, nëse lidhja këputet, asnjë mesazh për ndihmë dha as përgjigje të faljes nuk mund të dërgohen apo merren.

Është mëse e rëndësishme pra, që ne të ruajmë një qëndrim me druajtje dhe respekt ndaj Frymës së Shenjtë. Përmes Tij dhe punës

së Tij në ne, na sillet tek ne ajo çfarë Zoti ynë bleu në kryq për ne. Besimet e duhura rreth Frymës janë një pjesë vitale e sistemit të krishterë të *Besimeve që kanë më shumë rëndësi*.

## TRINIA

Ka qënë e pamundur të flasim për Perëndinë e Biblës pa përmendur termat trinitar dhe Trini. Kësaj të vërtete të vështirë do t'i kushtojmë tani pak më shumë vëmendje. Këtu, e thënë me pak fjalë, është besimi madhështor i krishterimit historik, që përmbledh besimin tonë rreth Perëndisë, rreth Krishtit, dhe rreth Frymës së Shenjtë. Është bindja se Perëndia është Tre në Një: që Perëndia Ati dhe Perëndia Biri dhe Perëndia Fryma e Shenjtë janë tre Persona në një natyrë. Nuk janë tre Perëndi, por një Perëndi i vetëm, në ekzistencë si Ati, Biri, dhe Fryma e Shenjtë.

### *1. Baza e së vërtetës.*

Nuk ia vlen të pretendojmë tani sikur ne mund të kuptojmë në mënyrë të përsosur gjithçka që përfshihet në doktrinën e Trinisë. Por do të na ndihmojë të mbajmë mend se ky besim madhështor nuk është një doktrinë teorike dhe abstrakte e sajuar për t'i ngatërruar mendimet tona- një tip testi inteligjence fetare. Përkundrazi, del drejt e nga jeta dhe besimi praktik i komunitetit të krishterë. Është rezultati i vendosjes së tre fakteve madhore së bashku: së pari, fakti i unitetit të Perëndisë Trini; së dyti, fakti i hyjnisë së Zotit Jezus Krisht; dhe së treti, fakti i personalitetit dhe hyjnisë së Frymës së Shenjtë. Asnjë prej këtyre fakteve nuk mund të lihet jashtë pa hequr dorë nga besimi i Dhjatës së Re. Nevoja për t'i vendosur ato së bashku dhe për t'i mbajtur ato në balancën e duhur është ajo që ngre doktrinën e Trinisë.

### *2. Kufijtë që duhen respektuar*

E vërteta që ne mundohemi të kapim është që Perëndia është një në natyrë dhe tre në person. Shumica e shpjegimeve kanë tendencën

të theksojnë ose unitetin ose trininë në kurriz të tjetrës. Pra, ata kanë tendencën të dalin me idenë ose të tre perëndive ose të një Perëndie në tre manifestime apo operime. Asnjë nga analogjitë tona, sado të dobishme, nuk duken dhe aq të përshtatshme: qofshin qeveritare, psikologjike, fizike dhe biologjike. Këtu, si dhe në vende të tjera të sferës së besimit, kur shpjegimi na duket i pakuptueshëm, na duhet të mbahemi më fort pas fakteve. Kjo nuk na justifikon nga përdorimi i mendjes sonë për të menduar thellë rreth besimit të krishterë, por na tërheq vëmendjen të mos pretendojmë pagabueshmëri në interpretim. Mendja që nuk është modeste, teksa mendon për gjëra hyjnore është pothuaj me siguri të plotë e gabuar.

Me këtë kujdes dhe brenda këtyre kufijve, atëherë, ne mund të shënojmë se çdo qeveri përbëhet nga tre funksione si i përmendëm më sipër: legjislativ, gjyqësor, dhe ekzekutiv. Në një përshkrim të tillë nuk janë tre qeveri, por një. Çdo individ njerëzor do të mund të shihet si një tip trinie, me arsyen, vullnetin, dhe ndjenjat duke formuar në këtë mënyrë një njësi të vetme psikologjike. Një trup ndriçues qiellor, si për shembull dielli, ekziston në hapësirë si një qendër gravitacionale që rrezaton dritë dhe nxehtësi. Së fundi, organizmi biologjik zotëron një nivel të lartë uniteti. Por është një unitet në shumës, shumë organe dhe qeliza që përbëjnë një jetë të vetme.

*Ne besojmë në një Perëndi që ekziston nga përjetësia, i pafund, Sovran i universit; se vetëm Ai është Perëndi, krijues dhe administrues, i shenjtë në natyrë, cilësi dhe qëllim; se Ai si Perëndi, është Trini në thelbin e qënies së Tij, i zbuluar si Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë.<sup>3</sup>*

*Ne besojmë në Jezus Krishtin, Personin e dytë të Perëndisë Trini, se Ai ishte përjetësisht një me Atin, se Ai u mishërua nga Shpirti i Shenjtë dhe u lind nga Virgjëresha Mari, kështu që dy natyra të plota*

<sup>3</sup> Ibid, Neni I.

*dhe të përsosura, domethënë Hyjnia dhe natyra njerëzore, u bashkuan në një Person, Perëndi i vërtetë dhe njeri i vërtetë, në Perëndinë-njeri.*

*Ne besojmë se Jezus Krishti vdiq për mëkatet tona, dhe se Ai me të vërtetë u ngrit nga të vdekurit dhe e mori sërish trupin e Tij, së bashku me të gjitha gjërat që i takojnë përsosmërisë së natyrës së njeriut, me të cilin Ai u ngjiti në qiell ku edhe ndërmjetëson për ne.<sup>4</sup>*

*Ne besojmë në Shpirtin e Shenjtë, Personin e Tretë të Perëndisë Trini, se Ai është i kudondodhur dhe efektivisht aktiv në dhe me Kishën e Krishtit, duke bindur botën për mëkat, duke ripërtërirë ata që pendohen dhe besojnë, duke shenjtëruar besimtarët dhe duke i drejtuar në të gjithë të vërtetën ashtu siç është në Jezusin.<sup>5</sup>*

### **Për diskutim të mëtejshëm.**

1. Cila është lidhja ndërmjet shenjtërisë dhe dashurisë së Perëndisë?
2. Diskutoni mbi rëndësinë e mbajtjes në balancën e duhur besimin në natyrën njerëzore dhe hyjninë e Jezus Krishtit.
3. Cila është rëndësia e lindjes së Krishtit përmes virgjërisë?
4. Për ç'arsye duhet të tregojmë kujdes t'i referohemi Frymës së Shenjtë si person?
5. Ç'vend ka Fryma e Shenjtë në jetën e krishterë?
6. Cilat janë tre faktet e vendosura së bashku në doktrinën e Trinitë?
7. Cilat janë dy rreziqet e kundërta që duhet të shmangim kur mendojmë për Perëndinë trini?

<sup>4</sup> *Ibid*, Neni II.

<sup>5</sup> *Ibid*, Neni III.

### III

## BESIMET RRETH SHEPENGIMIT

Disa herë në kapitujt e mëparshëm ne kemi aluduar që plani i Perëndisë për qëniet njerëzore ishte një plan shpëtimi. Një fjalë tjetër për këtë është “shpengimi.” Në kuptimin e vet fjalë për fjalë, të shpengosh do të thotë të blesh rishtas, të rimarrësh; të sigurosh lirinë, si për shembull prej robërisë, duke paguar një çmim. Një shqyrtim më nga afër i fjalës, në kuptimin që përdoret nëpër gjithë Biblën, tregon se shpengimi përfshin tre elementë: viktima që do të shpengohet, gjendja apo kushtet prej të cilave viktima duhet shpenguar, dhe mjetet ose çmimi me anë të cilit çlirimi sigurohet. Këto do të na shërbejnë si nën ndarje të këtij kapitulli.

### Ç’ËSHTË NJERIU?

Preokupimi dhe plani i madh i Perëndisë nëpër epoka ka patur të bëjë me racën njerëzore. Për ta kuptuar shpengimin ne duhet të dimë diçka rreth atyre që janë objektet e tij. Pas Perëndisë, njeriu është tema më e rëndësishme në Bibël. Zanafilla së pari na prezanton me Perëndinë në punën e Tij krijuese. Menjëherë, megjithatë, kthehet tek natyra njerëzore dhe vendi i njerëzimit në krijimin e Perëndisë. Dikush e ka vënë në dukje rëndësinë relative të shpirtit njerëzor në raport me gjërat e krijuara: “Zanafilla i kushton dy kapituj krijimit dhe katërmbëdhjetë Abrahamit.”

#### *1. Origjina e njeriut.*

Shumë ide të gabuara rreth natyrës njerëzore korrigjohen në këtë histori të hershme të Zanafillës për njeriun. Kjo histori anullon përgjithmonë të gjitha filozofitë natyraliste për të cilat njerëzimi s’është gjë tjetër përveçse produkti i fundit i një procesi evolucionari, me një sistem nervor të organizuar vetëm pak më mirë sesa ai i kafshëve.

Është interesante të theksojmë këtu se fjala “krijoj” është përmendur vetëm tre herë në kapitullin e parë të Zanafillës. Të gjitha veprat e tjera të Perëndisë janë përshkruar përmes përdorimit të fjalëve “bëri” ose “le të jetë.” Tre herët e foljes “krijoj” u referohen universit material (v. 1), jetës së ndërgjegjshme (v. 21), dhe qënies njerëzore (v. 27).

Bibla njih faktin që trupat tanë fizikë janë prej pluhurit të tokës. Elementi më të vërtetë i rëndësishëm i natyrës njerëzore gjendet në fjalët “frymë” dhe “shpirt”, sepse Perëndia fryu në vrimat e hundës së Adamit një frymë jete (fjalë për fjalë “shpirtin e jetës”); “dhe njeriu u bë një qenie (“shpirt” në disa përkthime) e gjallë”( Zan. 2:7).

## *2. Imazhi i Perëndisë në njeriun.*

Pikërisht në sferën e shpirtit dhe frymës ne mbartim imazhin e Perëndisë. Dhe pikërisht kjo na bën të jemi më shumë se kafshë; çfarë, në fakt, na bën qytetarë të dy botëve. Fizikisht, biologjikisht, ne jetojmë në botën e natyrës, trupat tanë jetojnë mbi bazën e po atyre lloj procesesh që rregullojnë dhe jetën e kafshëve. Mendërisht, shpirtërisht, ne jetojmë në një sferë më të lartë, në të cilën ne kemi kapacitete shumë më të mëdha se të çdo qenieje tjetër e gjallë.

Ndërkohë që është e vërtetë se mëkati ka dëmton imazhin moral të Perëndisë në natyrën njerëzore, njeriu megjithatë vazhdon të mbajë shumë prej imazhit të natyrshëm të Perëndisë në kapacitetin e tij për mendim intelektual dhe aftësinë për të marrë vendime. Po të mos që kështu, ne jo vetëm që do kishim humbur përjetësisht prej Perëndisë, por edhe s’do kishim kurrfarë kapaciteti që të mund t’i përgjigjeshim hirit të Tij kur të na shfaqej.

## *3. Qytetaria në dy botë.*

Fakti që ne, si qenie njerëzore, jemi qytetarë të dy sferave, shkakton shumë nga tensionet dhe presionet që ne ndjejmë mbi vete. Tërheqja e fizikes dhe natyrale është shumë e fortë. Disa e jetojnë jetën e tyre pothuajse plotësisht në nivelin thjesht të kënaqjes së nevojave dhe instikteve kafshërore.

Nga ana tjetër, është pothuaj e pamundur që një qenie njerëzore të jetë plotësisht e kënaqur duke jetuar si një bimë apo si një kafshë. Ekziston edhe një tërheqje e botës shpirtërore, ashtu si edhe presioni, që me raste ndihet zbehtë, por që vërtetë ekziston gjithmonë, i ligjit moral. Vetëm njeriu, në gjithë krijesën tokësore, është subjekt i shqisës “duhet.”

#### 4. *Natyra e lirisë njerëzore.*

Një nga trillet e kohëve të fundit në studimin e natyrës njerëzore njihet si “determinizmi.” I shprehur në mënyra të ndryshme, determinizmi është idea se njerëzit, janë krijesa të trashëgimisë dhe mjedisit të tyre, dhe sjelljet e tyre janë rezultat i lojës së forcave të jashtme mbi ta. Në formën e vet më ekstreme kjo pikëpamje është fatalizmi, dhe çon në një dorëzim pasiv ndaj rrethanave.

Asgjë tjetër s’mund të ishte më larg nga e vërteta rreth njeriut të Shkrimit. Bibla nuk e mohon forcën e tendencave mëkatore ose faktin e dobësisë njerëzore. Por pohon me forcë faktin e lirisë së zgjedhjes. Hiri fuqizues i Perëndisë u jepet të gjithëve, duke bërë të mundur ngritjen përtej robërisë së mishit dhe rrethanave.

#### 5. *Qëllimi i duhur i jetës njerëzore.*

I lidhur ngushtë me idenë e gabuar të determinizmit është nocioni se, çështjet e të mirës dhe të keqes në jetën njerëzore, përcaktohen nga kënaqësia apo lumturia që prodhohen nga forma të caktuara të sjelljes. Janë të shumtë ata që sot na mësojnë se çfarëdo që në jetë ofron kënaqësinë dhe lumturinë më të madhe është rrjedhimisht e mirë dhe e drejtë.

E kundërt me këtë është bindja biblike se jeta nuk është një kupë që duhet zbrazur, por një masë që duhet mbushur, se ne nuk jemi në tokë për të parë sesa mund të marrim prej saj vetëm për veten tonë, por që të japim kontributin tonë, për të lënë pas vetes sonë një njerëzim sadopak më mirë, për shkak se ne kemi jetuar. Fundi kryesor i njeriut nuk është të jetë i lumtur, por që të *meritojë* lumturinë.

Është e vërtetë se lënda e parë e qënieve njerëzore mund të përdoret për të ndërtuar taverna të sensualitetit dhe epshit. Por ajo

gjithashtu mund të përdoret për të ndërtuar tempuj, që i kushtohen Perëndisë dhe ngritjes së mbretërisë së Tij në zemrat e njerëzve. Siç e ka shkruar dikush:

*A s'është e çuditshme  
Që princër e mbretër  
Dhe kllounë e palaço  
Dhe njerëz të zakonshëm  
Si ju dhe unë  
Ndërtues të përjetësisë  
Jemi?*

*Secilit një çantë veglash  
Një masë e paformë  
Një libër rregullash  
I jepen  
Dhe secili duhet të bëjë  
Para fundit të jetës  
Një bllok pengese  
Ose një gur rrugicësh*

#### *6. Nënkuptimet e pavdekësisë*

Në këtë lidhje, ne nuk duhet të harrojmë kurrë mësimin e qartë që na japin, si arsyeja ashtu dhe Shkrimi, që njeriu është një krijesë e destinuar të jetojë përjetësisht. Qenia e vërtetë, shpirti i cili është thelbi ynë, nuk vdesin kur trupi ynë shuhet. Kjo i shton një dimension të ri e të vërtetë jetës njerëzore. Është tjetër gjë të bëjmë zgjedhjet tona sikur gjithçka që ne kemi për të jetuar janë rreth shtatëdhjetë vitet në tokë, dhe është tjetër gjë t'i bëjmë zgjedhjet tona me horizonte të përjetësisë në mendjen tonë.

Të jetosh kështu nuk është të jesh jashtëtokësor apo jopraktik. Por është të jetosh dhe të sillesh siç u shkon për shtat qenieve të pavdekshme. Suksesi ynë nuk mund kurrsesi të matet nga çfarë po lëmë pas nesh. Mund të matet nga ku ne po shkojmë. Dhe vetëm duke mbledhur “thesare në qiell” ne mund t'i shërbejmë Perëndisë dhe epokës tonë në mënyrën më efektive.



Psalmisti ka thënë: “Kur mendoj qiejtë e tu, që janë vepër e gishtërinjve të tu, hënën dhe yjet që ti ke vendosur, çfarë është njeriu që ta mbash mend, dhe biri i njeriut, që ta vizitosh?” (Ps. 8:3-4). Sa madhështore dhe e denjë është përgjigja e tij: “Megjithatë ti e bërë pak më të ulët se Perëndia, dhe e kurorëzove me lavdi dhe nder. E bërë të mbretërojë mbi veprat e duarve të tua dhe vure çdo gjë nën këmbët e tij. Dhentë dhe bagëtitë e tjera, madje dhe bishat e egra” (Ps. 8:5-7).

## MALLKIMI I MËKATIT: PICKIMI HELMUES I GJARPRIT

Në fillim të kapitullit ne pamë që shpengimi i ofrohet viktimës për t’u shpenguar dhe pamë gjendjen apo kushtet, çlirimi prej të cilave është i nevojshëm. Tani do ta kthejmë vëmendjen tonë tek gjendja në të cilën njeriu ka rënë.

### 1. Gjendja e vështirë njerëzore

Të gjithë studiuesve të jetës njerëzore u bën përshtypje një sëmundje e çuditshme që e mundon racën njerëzore. Në një botë të mbushur plot me burime të natyrës, të mjaftueshme për një jetë të paqshme dhe të begatshme për të gjithë njerëzit e vet, në vend të qetësisë dhe paqes ne gjejmë terroret e luftës, urrejtje, epsh, dhunë dhe egoizëm.

Ajo që është quajtur “gjendja e vështirë njerëzore” ka nevojë të shpjegohet. Pse vallë potenciali i madh i jetës së njeriut në këtë botë është mundur kaq gjerësisht? Duhet me siguri të ketë një shpjegim për mjerimin universal të sjellë nga “sjellje jonjerëzore e njeriut ndaj njeriut.”

Përgjigja biblike, dhe e vetmja, është se sëmundja e shpirtit dhe frymës së njeriut është rezultat i “pickimit helmues të gjarpërit.” Është mëkati. Vesi është dhunimi i ligjeve të natyrës. Krimi është dhunimi i ligjeve njerëzore dhe shoqërore. Mëkati është dhunimi i ligjit të Perëndisë. Asnjë person me mend nuk e mohon se “të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë” (Rom. 3:23).

### 2. Origjina e mëkatit.

Por ndryshe nga ç’thonë shumë sociologë të sotëm, mëkati nuk filloi në një lagje të varfër. Dhe për sa i përket njerëzimit filloi në një

kopësht, Kopshti i Edenit. Dhe filloi kur prindërit e parë të rracës njerëzore zgjodhën të mos i binden urdhërit të Perëndisë, dhe nën sugjerimin e gjarpërit ndoqën rrugën e rebelimit. Që nga kapitulli i tretë i Zanafillës deri tek Zbulesa, dëshmia që Bibla jep është e njëjta. Shpirti njerëzor është i sëmure me mëkatin, dhe të gjitha zgjedhjet dhe veprimet e tij janë të ngjyrosura nga kjo sëmurdje që shtrihet thellë-thellë brenda tij.

### 3. *Mëkati, problem i dyfishtë*

Sepse mëkati, ashtu si Bibla na mëson, është e dylojshëm. Kjo tregohet nga vetë forma me të cilën e gjejmë fjalën. Përdoret si emër në numrin njëjës, “mëkat,” dhe zakonisht do të thotë një gjendje e shpirtit, siç thotë Pali në Rom. 6:12: “Le të mos mbretërojë pra mëkati në trupin tuaj të vdekshëm, që t’i bindeni atij në epshet e veta.” Dhe përdoret edhe si folje, si në rastin kur Jezusi tha: “Ja ti u shërove; mos mëkato më që mos të të bëhet një gjë më e keqe” (Gjoni 5:14). Këtu tregon një veprim të bërë, diçka që ne kemi në dorë të zgjedhim, të bëjmë ose të mos e bëjmë.

*a. Mëkati si një gjendje.* Ne jemi të gjithë të lindur në mëkat, si një gjendje, me një natyrë morale të privuar nga shenjtëria e Perëndisë, dhe si rrjedhojë të prishur moralisht. Disa janë munduar të kuptojnë se si kjo gjendje e mëkatshme mund të përçohej nga një brez në tjetrin, meqë ato karakteristika që ne marrim gjatë kursit të jetës sonë nuk transmetohen tek pasardhësit tanë.

Përgjigja për këtë mund të gjendet pjesërisht kur ne reflektojmë se në kopësht, me anë të mëkatit të tyre të parë, Adami dhe Eva humbën shenjtërinë në të cilën ata ishin krijuar, e cila u ishte dhënë atyre përmes prezencës së Perëndisë. Ata u prishën në natyrën e tyre për shkak se ata u privuan nga drejtësia e Perëndisë përmes mëkatit të mosbindjes dhe rebelimit. Atë çfarë ata nuk e zotëronin nuk mund të trashëgohet nga brezi tjetër; prandaj raca e tyre u prish për shkak se ishin të privuar nga drejtësia që prindërit e tyre nuk e kishin.

Sigurisht, asnjë ilustrim nuk është në gjendje të hedhë dritë të plotë mbi përvojën njerëzore në këtë pikë. Por të gjithë ama e dimë se

një njeri që shkapërderdh një pasuri, sjell varfëri mbi veten dhe fëmijët e tij. Mëkati si një gjendje është më shumë se sa mungesë e drejtësisë por vjen si rezultat i humbjes së shenjtërisë, ashtu si verbëria vjen prej humbjes së shikimit, apo errësia vjen prej mungesës së dritës.

*b. Mëkati si një vepër ose akt.* Pra, ekziston problemi i jetës mëkatore. Mëkati ka qenë përkufizuar si “vendosje në qendër të jetës sonë të vullnetit tonë vetë-kërkues në vend të vullnetit vetë-dhënës të Perëndisë.” Bibla na mëson se thelbi i një jete mëkatore është mosbesimi. Jezusi tha për shembull se Fryma e Shenjtë do ta bindë botën për mëkat, “sepse nuk besojnë në mua” (Gjoni 16:9). Hermann Schultz (*Herman Shultc*) shumë kohë më parë ka thënë: “Rrënja kryesore e mëkatit është mosbesimi, i cili në dhuratën e dashurisë së Perëndisë shikon një kufizim jodashamirës.”

A nuk e përmbledh kjo mëkatin? Pse i thyejnë njerëzit ligjet dashamirëse dhe të favorshme të Perëndisë, dhe në vend të tyre zgjedhin rrugët e tyre egoiste të të jetuarit? A nuk është sepse ata udhëhiqen nga një mosbesim dyshues, i cili dyshon nëse vullneti i Perëndisë është vërtet i mirë dhe që pretendon se rruga e njeriut është më e mirë?

#### 4. *Mëkati si i vullnetshëm.*

Megjithatë, le ta themi diçka drejt e qartë. Me gjithë faktin që mëkati është kaq i zakonshëm dhe kaq i përhapur, le të mos biem në grackën e të menduarit se njerëzimi është mëkatshëm. Ka dy mënyra se si njerëzit e trajtojnë faktin e papëlqyer të mëkatit. Njëra është ta mohojnë atë - dhe kjo është mënyra e njerëzve jofetarë. Dhe tjetra është mënyra e shumë njerëzve fetarë - ta bëjnë atë kaq të gjerë saqë përfshin brenda të gjitha llojet e gabimeve dhe dështimeve, madje edhe ato që janë të pavetëdijshme apo të pashmangshme.

T’i vësh çdo gjëje etiketën e mëkatit dhe të deklarosh se asnjë qenie njerëzore nuk mund të rrojë pa mëkat, ashtu si bëjnë shumë sot, është pothuaj se ta lësh mëkatin pa asnjë rëndësi të veçantë. Të deklarosh që njeriu mëkaton çdo ditë, në fjalë, mendime, dhe veprime, me idenë se kjo përshtatet me modestinë e krishterë, është të jesh

një milion milje larg theksit që Bibla vë mbi natyrën e mëkatit dhe natyrën e shpëtimit nga mëkati.

Shkrimi e përshkruan mëkatin në të gjithë realitetin e vet të tmerrshëm dhe të shëmtuar, si rebelimi që e konsideron asgjë ligjin e shenjtë të Perëndisë. Mëkati gjithmonë përfshin zgjedhjen dhe vullnetin. Nuk është i pavullnetshëm dhe pa dashje. Dhe ata tek të cilët ungjilli vjen, por refuzojnë çlirimin prej mëkateve të tyre që ky ju ofron, bëhen “fajtor të trupit dhe gjakut të Krishtit” (1 Kor. 11:27) sepse me këtë akt ata afirmojnë atë princip që e çoi në kryq Zotin Jezus Krisht.

### 5. *E vetmja shpresë.*

Por ka një fakt të gëzueshëm rreth mëkatit, dhe vetëm një. Fakti është që Jezusi erdhi t’i shpëtojë njerëzit e Tij nga mëkatet e tyre (Mat. 1:21). Me anë të forcës së madhe të kryqit të Tij mëkatet e jetës sonë mund të na falen, dhe mëkati i natyrës sonë mund të na pastrohet (1 Gjoni 1:9). Nuk ka asnjë ilaç tjetër për sëmundjen e shpirtit tonë. Helmi i pickimit të gjarprit është fatal; por, “Ashtu si Moisiu e ngriti lart gjarprin në shkretëtirë, kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut, që kushdo që beson në të të mos humbasë por të ketë jetën e përjetshme” (Gjoni 3: 14-15).

## ÇMIMI I SHPENGIMIT.

Idea e tretë e shpengimit është çmimi apo mjetet për çlirimin nga gjendja e robërisë e atyre që janë në robëri. Disa modernë do të përpiqeshin mos ta konsideronin këtë si një pjesë të rëndësishme të shpengimit të krishterë, por të bësh kështu do të thotë që shpengimi të humbasë fuqinë dhe domethënien e tij. Nëse i bëjmë pyetjen kishës së hershme: “me ç’ mënyra apo me çfarë çmimi u ble shpengimi ynë?” ka vetëm një përgjigje: “Gjaku i çmuar i Krishtit, si të qengjit të patëmetë dhe të panjollë” (1Pjetrit 1:19).

Këtu, si askund tjetër, ne hyjmë vërtetë në “vendin shumë të shenjtë” të besimit të krishterë. Njeriu duhet ta shikojë Kryqin duke rënë në gjunjë. Çdo prespektivë tjetër është e destinuar ta

shtrembërojë atë. Bashkë me apostullin e madh, ne mund të afirmojmë pa asnjë hije dyshimi se “Krishti vdiq për mëkatet tona” (1Kor. 15:3). Ne mund të mos jemi në gjendje të kuptojmë ose shpjegojmë plotësisht se *si* vdekja e Krishtit na sjell jetë të re. *Fakti* i shlyerjes së mëkateve është i padiskutueshëm. *Teoritë* rreth shlyerjes së mëkateve mund të jenë më pak të sigurta.

### 1. *Kryqi dhe dashuria e Perëndisë.*

Diçka duhet thënë që në fillim, dhe duhet thënë aq qartë sa askush të mos e keqkuptojë. Shpengimi në Krishtin, është mbi të të gjitha, zbulesa supreme e dashurisë së Atit (Gjoni 3:16; Rom. 5:8). Është një gjysëm e vërtetë, por që shpejt shndërrohet në një gabim të tërë, në nocionin që në një mënyrë apo në një tjetër Krishti qëndroi në mes të zemërimit të pamëshirshëm të Atit dhe të mëkatarit të pafatë. Një vajzë e vogël erdhi në shtëpi nga Shkolla e së dielës dhe e befasoi të ëmën me daklaratën: “Mami, unë e dua Jezusin, por e urrej Perëndinë.” “Pse, çfarë do të thuash me këtë?” pyeti mamaja e alarmuar. “Mirë pra, mësuesja na tregoi sot se Perëndia ishte i inatosur me ne për shkak të mëkateve tona dhe deshi të na çonte në ferr; Por Jezusi vdiq në vendin tonë dhe nuk e lejoi Atë. Kështu që unë e dua Jezusin, por e urrej Perëndinë.”

Hija e një teologjie të lashtë ndodhet në fjalët e vajzës. Kjo teologji ngre kokë sa herë që ne duke mos mbajtur parasysh mishërimin, lejojmë që kryqi të qëndrojë i vetëm. Atëherë shlyerja bëhet flijimi i një jete njerëzore të përsosur në Perëndinë, që blen meritën ose paguan dënimin, përfitimet e së cilës mund t’u shpërndahen njerëzve përmes një prifti ose me anë të “dekreteve të pandryshueshme” të vetë Atit. Korrigjimi i kësaj është të përmendim dhe një herë: “Perëndia e ka pajtuar veten me botën në Krishtin” (2 Kor. 5:19). Kalvari qëndron në qëllimin e Atit (Vep. 2:23) si mjeti me anën e të cilit Perëndia e shpengon njeriun në veten e Tij.

### 2. *Përmasa e shpengimit.*

Janë të paktën tre nevoja madhore në marrëdhënien ndërmjet njeriut dhe Perëndisë, të cilat kryqi i Krishtit i plotëson. Po ta

kuptojmë këtë qartë do të na ndihmojë të kuptojmë çmimin dhe përmasën e shpengimit. E para është se gjykimi i Perëndisë për mëkatin nuk është arbitrar, për t'u përjashtuar me pëlqimin e Tij, por është rezultat i faktit se kush është Ai dhe se Ai duhet gjithmonë të jetë përderisa është Perëndi. E dyta është se, mëkati gjithmonë vjen tek njerëzit i maskuar, i fshehur, dhe duhet të demaskohet. E treta është se, fuqitë dhe personifikimet e ligësisë, që e kanë mbajtur në robëri jetën njerëzore, duhet të thyhen që të ketë një çlirim të vërtetë, dhe që fuqia e Shpirtit hyjnor të sundojë. Secilës prej këtyre ne duhet t'i japim vëmendje të veçantë.

*a. Natyra hyjnore dhe gjykimi i mëkatis.* Çdo kuptim i kryqit duhet të fillojë tek përshkrimi i madh që Pali jep për shfajësimin përmes Krishtit Jezus: “Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij, për të treguar kështu drejtësinë e tij për faljen e mëkateve, që janë kryer më parë gjatë kohës së durimit të Perëndisë, për të treguar drejtësinë e tij në kohën e tanishme, me qëllim që ai të jetë i drejtë dhe shfajësues i atij që ka besimin e Jezusit” (Rom. 3:25-26).

Fjala *propitiation* (që mund të përkthehet si “plotësimi i kërkesës” ose “shpërblim”) është një fjalë e vështirë për t'u përkufizuar qartë. Është përdorur në shumë mënyra që kanë qënë një milion milje larg nga e vërteta biblike rreth shlyerjes së mëkatis. Nga ana tjetër, prezanton faktin se kryqi i Krishtit plotëson një kërkesë të thellë dhe themelore të natyrës së Perëndisë: “që ai të jetë i drejtë” dhe në të njëjtën kohë “shfajësues i atij që ka besimin në Jezusin.” Kryqi njëkohësisht përlligj shenjtërinë e Perëndisë dhe durimin e treguar prej Tij në faljen e mëkateve.

Ka një simbolizim të kësaj në vetë formën e kryqit. Shtylla e tij vertikale përfaqëson drejtësinë dhe shenjtërinë e Perëndisë, të cilat gjithmonë dalin në gjykimin e mëkatis. Shtylla e tij horizontale përfaqëson dashurinë dhe hirin e Perëndisë. Sa herë që dashuria dhe hiri ndeshen me mëkatin, rezultati është një kryq. Kryqi tregon se sa kushton mëkati, dhe se sa kosto supreme u mbart nga vetë Perëndia.

Perëndia në Krishtin mbarti pasojat e mëkatit njerëzor në Kalvar, dhe si rezultat i kësaj, Perëndia i dashur mund t'i falë për hir të Krishtit ata që pendohen dhe besojnë, dhe megjithatë të vazhdojë të jetë i drejtë dhe i shenjtë, pa të cilat Ai nuk do që Perëndi.

*b. Mëkati i demaskuar.* Kalvari jo vetëm që e përligj shenjtërinë e Perëndisë dhe zbulon dashurinë e tij; por gjithashtu demaskon mëkatin njerëzor. Forca më e madhe e mëkatit është fakti se ai vjen i maskuar. Në njëmijë mënyra ai fsheh veten. E maskon veten pas justifikimeve, arsytimit, rrethanave, dhe ndikimit të të tjerëve. Kryqi ia zëvat dhe ia hedh tutje maskën, si dhe tregon se ç'përbindësh është mëkati, dhe se natyra e tij e vërtetë është rebelim i plotë dhe absolut ndaj dashurisë së Perëndisë.

Ju nuk mund ta shihni se ç'është në të vërtetë mëkati, përveçse nën dritën e kryqit. Drita e zbehtë e standarteve morale të sotme, është si "nata në të cilën të gjithë viçat duken njëloj." Por drita e shenjtë që shkëlqen që nga Kalvari, i bën të dukshme të gjitha hijet e ngjyrave dhe ndryshimet e cilësive. Në një shkollë të së dielës, në ditën e Pashkës punëtorët i dhanë secilit fëmijë nga një zambak, të bardhë dhe shumë të bukur. Një nga gratë vuri re një nga fëmijët, që vinte nga lagjet e varfëra, i cili po shikonte zambakun e vet dhe lotët e binin rrebesh nëpër faqet e palara. "Si e ke hallin, zemër? Nuk të pëlqen zambaku yt?" e pyeti punëtorja. "Oh, po, është shumë i bukur," iu përgjigj fëmija; "por kurrë më parë s'e kam ditur sa i pistë që jam."

*c. "Christus Victor" Krishti fitimtar.* Askush s'e ka kapur me të vërtetë mësimin e Dhjatës së Re rreth kryqit, për sa kohë që nuk ka dëgjuar lajmin e triumfit të tij mbi mëkatin, vdekjen, djallin, dhe të gjitha principatat dhe pushtetet për të cilat u fol në predikimet e kishës së hershme. Nuk flitet askund për mundje por vetëm çlirim. Krishti nuk është viktima e urrejtjes së njerëzve të këqinj ose të rrethanave tragjike. Ai është fitimtari mbi mëkatin, dhe vdekjen, dhe mbi të gjithë principatat dhe pushtetet e errësirës që e mbanin njeriun të skllavëruar. Kush mund të mos e vërë re triumfin në fjalët e Palit:

“Dhe bashkë me të Perëndia ju dha jetë ju, që kishit vdekur në mëkate dhe në parrethprerjen e mishit, duke jua falur të gjitha mëkatet. Ai e zhvlerësoi dokumentin e urdhërimeve, që ishte kundër nesh dhe ishte kundërshtar, dhe e hoqi nga mesi duke e mbërthyer në kryq; dhe mbasi i zhveshi pushtetet dhe principatat, ua tregoi sheshit njerëzve, duke ngadhnyer mbi ata në të (dmth në kryqin)” (Kol. 2:13-15)?

Ja cila është arsyeja pse shkrimtarët e Dhjatës së Re e theksojnë pa u lodhur ringjalljen e Krishtit. “Sepse po të rrëfesh me gojën tënde Zotin Jezus, dhe po të besosh në zemrën tënde se Perëndia e ngjalli prej së vdekurish, do të shpëtohesh” (Rom. 10:9). Në ringjalljen e Krishtit ne kemi vulën dhe shenjën e mrekullueshme të fitores së kohërave. Ashtu si dikush e ka përshkruar, dita e vërtetë arriti më në fund. Fortesa e pathyeshme e mëkatit dhe ligësisë u thye. Kundërshtari vazhdon të luftojë, por ai lufton si një armik, mundja e të cilit është vulosur dhe është e sigurtë. Të gjitha forcat e tiranisë që e mbanin njeriun në skllavëri, u mposhtën nga Perëndia në Krishtin, i cili i mundi ata përgjithmonë me anë të veprimit, që ai vetë kreu përmes flijimit të Kalvarit.

Le të shikojmë edhe diçka tjetër këtu. Kjo, jo vetëm që ishte një fitore një herë e përgjithmonë mbi principatat dhe pushtetet e ligësisë në univers; por ishte gjithashtu pika e fillimit për veprën e vazhdueshme të Krishtit, të shpërndarjes së fryteve të fitores së Tij, në zemrën dhe në jetën e individëve njerëzorë me anën e Frymës së Shenjtë. Krishti fitimtar është Bashkëkohësi ynë i përjetshëm. Ne nuk adhurojmë Krishtin e kryqëzimit, por Krishtin Zot të gjallë dhe të tanishëm. Në fitoren e Tij ne triumfojmë; tani mbi mëkatin; dhe përfundimisht, kur dita e fitimit të vijë, edhe mbi vdekjen. “Dhe në qoftë se Fryma e atij që ringjalli Krishtin prej së vdekurish, banon në ju, ai që e ringjalli Krishtin prej së vdekurish do t’ju japë jetë edhe trupave tuaj vdekatarë me anë të Frymës së tij që banon në ju” (Rom. 8:11).

*Ne besojmë se mëkati erdhi në botë përmes mosbindjes së prindërve tanë të parë dhe vdekja përmes mëkatit. Ne besojmë se mëkati është dy llojesh: mëkati origjinal ose shthurje (prishje morale), dhe mëkati aktual ose personal.*



*Ne besojmë se mëkati origjinal ose shthurje është ajo prishje e natyrës së gjithë pasardhjes së Adamit, me anë të së cilës çdo njeri ka shkuar shumë larg nga drejtësia fillestare, ose nga gjendja e pastër e prindërve tanë të parë në kohën kur u krijuan, ai kundërshton Perëndinë, është pa jetë shpirtërore dhe i prirur drejt së keqes në mënyrë të vazhdueshme. Ne gjithashtu besojmë se mëkati origjinal vazhdon të ekzistojë në jetën e besimtarit të ripërtërirë, derisa zemra të pastrohet plotësisht nga pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë.*

*Ne besojmë se, mëkati origjinal ndryshon nga mëkati aktual në atë që ai përbën një prirje të trashëguar për në mëkatin aktual, për të cilin asnjë nuk është përgjegjës deri në kohën kur zgjidhja e siguruar në mënyrë hyjnore, neglizhohet ose refuzohet.*

*Ne besojmë se mëkati aktual ose personal është shkelje e vullnetshme e një ligji të njohur të Perëndisë nga një person moralisht i përgjegjshëm. Prandaj nuk duhet ngatërruar me mangësitë e pavullnetshme dhe të pashmangshme, dobësitë, të meta, gabimet, dështimet ose devijime të tjera nga një standart sjelljeje e përsosur që janë efekte të mbetura që nga Rënia. Megjithatë, këto efekte të pafajshme nuk përfshijnë qëndrime ose reagime në kundërshtim me shpirtin e Krishtit, të cilat me të drejtë mund të quheshin mëkate të shpirtit. Ne besojmë se mëkati personal është së pari dhe në thelb shkelje e ligjit të dashurisë; dhe në lidhje me Krishtin mëkati mund të përkufizohet si mosbesim.<sup>6</sup>*

*Ne besojmë se Jezus Krishti, me anë të vuajtjeve të Tij, dhe derdhjes së gjakut të Tij dhe me anë të vdekjes së Tij të meritueshme në kryq, realizoi një shlyerje të plotë për të gjithë mëkatin njerëzor, dhe se kjo Shlyerje është baza e vetme për shpëtim, dhe se është e mjaftueshme për çdo individ të racës së Adamit. Shlyerja është e efektshme në një mënyrë plot hir për shpëtimin e atyre që janë të papërgjegjshëm, dhe për fëmijët në moshën e pafajsisë, por është e efektshme për shpëtimin e atyre që arrijnë moshën e përgjegjësisë*

<sup>6</sup> *Ibid.*, Neni V.

*vetëm kur ata pendohen dhe besojnë.<sup>7</sup>*

*Ne besojmë se krijimi i racës njerëzore në ngjashmëri me Perëndinë, përfshinte aftësinë për të zgjedhur midis të drejtës dhe të gabuarës, dhe se kështu qëniet njerëzore u bënë të përgjegjshme moralisht; se përmes rënies së Adamit ata u prishën moralisht aq sa nuk mund të kthehen tani dhe të përgatisin veten me forcat e tyre natyrore dhe me vepra për besim dhe për të kërkuar Perëndinë. Por ne gjithashtu besojmë se hiri i Perëndisë përmes Jezus Krishtit u është dhënë falas të gjithë njerëzve, duke i aftësuar të gjithë ata që dëshirojnë të kthehen nga mëkati tek drejtësia, të besojnë në Jezus Krishtin për faljen dhe pastrimin e mëkateve dhe të vazhdojnë me vepra të mira të pëlqyeshme dhe të pranueshme para syve të Tij.*

*Ne besojmë se të gjithë individët, ndonëse në zotërim të përvojës së ripërtëritjes dhe të shenjtërimit të plotë, mund të bien nga hiri dhe të tërhiqen nga besimi dhe, në qoftë se ata nuk pendohen për mëkatet e tyre, do të jenë të pashpresë dhe përjetësisht të humbur.<sup>8</sup>*

### **Për diskutim të mëtejshëm**

1. Cili është imazhi i Perëndisë në njeriun?
2. Ç'konkluzione mund të nxirren nga besimi në pavdekësinë?
3. Çfarë thotë bibla në lidhje me gjendjen e vështirë të njeriut dhe origjinën e saj?
4. Në çfarë kuptimi është mëkati një problem i dyfishtë?
5. Cili është rezultati praktik i quajtjes së çdo gabimi njerëzor mëkat?
6. Cili është dallimi ndërmjet faktit dhe teorisë në shlyerje?
7. Cilat janë tre nevojat e mëdha në pajtimin e Perëndisë me njeriun, që janë plotësuar me anën e kryqit të Krishtit?
8. Pse Dhjata e Re vendos kaq shumë theksin mbi ringjalljen e Krishtit?

<sup>7</sup> *Ibid.*, Neni VI.

<sup>8</sup> *Ibid.*, Neni VII.

## IV

### BESIMET RRETH JETËS SË RE NË KRISHTIN

Ai erdhi nga errësira - jo se ishte frikacak, por mezi priste një takim personal me Mjeshtrin.

Emri i tij: Nikodem

Sfondi i tij shoqëror: trajnim fetar dhe moralshmëri e rreptë.

Nevoja e tij: një shpirt i uritur, i robëruar nga mëkati, dhe i hutuar nga dyshimet.

Jezusi nuk kaloi kohë me gjëra të parëndësishme. Ai shkonte drejt e në thelb të nevojës shpirtërore. “Ti duhet të lindësh sërish,”- tha Ai.

Sa i ngjashëm që është me ne Nikodemi! Ne pothuaj mund ta dëgjojmë atë të pyesë. A nuk është disi sarkazëm? “Si mund të lindë njeriu kur është plak?” A mundet ai, me anë të ndonjë magjie, të fillojë nga e para një jetë të re fizike?

Nevoja, përgjigjet Jezusi, nuk është për një rilindje fizike. Është fjala për një rilindje të shpirtit. Ta rifillosh jetën nga e para në kuptimin fizik, nuk do të ndihmonte në të vërtetë, sepse “Ç’ka lindur nga mishi është mish, por ç’ka lindur nga Fryma është frymë.” Ajo që nevojitet është jetë shpirtërore; dhe jeta shpirtërore fillon vetëm me lindjen shpirtërore - lindje të re, lindje nga lart, lindje të Shpirtit.

Por Nikodemi nuk ka mbaruar me argumenta. “Si mund të ndodhin këto gjëra?” (Gjoni 3:9) pyet ai sikur të donte të thoshte: “Është e pamundur, unë nuk mund ta kuptoj.”

Jezusi përgjigjet: “Ti nuk mund të kuptosh plotësisht misteret e gjërave tokësore, mënyrën si fryn era, ndryshimet e motit. Si mund të shpresosh të kuptosh gjërat qiellore?” Por shpëtimi nuk qëndron në të kuptuarin, por në pranimin. “Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të

vetët nuk e pranuan, por të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë, atyre që besojnë në emrin e Tij” (Gjoni 1:11-12).

Këtu ne njihemi me konceptin biblik në lidhje me natyrën dhe fillimin e jetës së krishterë. Nuk është rezultat i shkollimit, ose kulturës, ose vetë-disiplinimit. Nuk është të kthesh monedhën nga ana tjetër; është të të jepet një jetë e re. Nuk është reformim; është ripërtëritje.

## NJË PËRVOJË PERSONALE

Është për t’u theksuar që në fillim se fillimi i jetës në Krishtin, është një ngjarje me kalendarin dhe gjeografinë e vet. Ndodh në një kohë dhe vend të caktuar. “Kthimi” ose “shndërrimi”, siç ne e quajmë atë zakonisht, është një periudhë e dallueshme në jetën e krishterë.

### 1. Ide të gabuara.

Nuk është e drejtë të themi “të gjithë njerëzit janë bijtë e Perëndisë për nga natyra.” Për nga natyra ne jemi të gjithë bijtë e zemërimit (Efes. 2:3) dhe bijtë e djallit (1Gjoni 3:8, 10). Të bëhesh fëmija i Perëndisë do të thotë një përgjigje personale ndaj një Krishti personal që na konfronton me kërkesën e Tij për besnikëri të jetës sonë.

Duke qënë i rritur në një familje të krishterë nga prindër të krishterë, nuk e bën individin të krishterë. Siç është thënë: “Perëndia ka shumë fëmijë, por *asnjë* nip apo mbesë.” I tillë është misteri i shpirtit njerëzor, që secili për veten e vet duhet të zgjedhë rrugën nëpër të cilën shpirti i tij do të shkojë.

Të shkuarit rregullisht në kishë dhe të qenit anëtar i kishës nuk e bën dikë të krishterë, ashtu si të shkuarit rregullisht në garazh nuk e bën dikë një automobil. As pagëzimi nuk është i mjaftueshëm. Një i ri që u përpoq të zëvendësojë shpëtimin personal me pagëzimin pranoi me ironi se ai kishte hyrë në ujë një mëkatar i thatë dhe kishte dalë një mëkatar i lagur, dhe kjo ishte e gjitha që kishte ndodhur në

të. Pagëzimi do të thotë diçka vetëm kur është “një shenjë e jashtme e punës së hirit përbrenda.”

As edhe një njohje e drejtë e doktrinës së krishterë dhe një siguri për të vërtetat e saj nuk të shpëton në vetvete. “Ti beson se ka vetëm një Perëndi. Mirë bën: edhe demonët besojnë dhe dridhen” (Jakobi 2:19) – dhe janë demonë megjithatë.

## *2. I hapur për të gjithë.*

E gjitha kjo do të thotë se shpëtimi është i hapur për të gjithë me të njëjtat kushte. Perëndia nuk ka preferenca. Ai paracakton jetë të përjetshme për të gjithë ata që pranojnë për veten e tyre mëshirën e hirin e ofruar nga ungjilli i Krishtit. Se çfarë do të thotë ky pranim do ta shohim pas pak. Këtu është e rëndësishme të kapim të vërtetën, se Perëndia zgjedh për të shpëtuar të gjithë ata që besojnë në Birin e Tij dhe Shpëtimtarin tonë. Dhe meqë të gjithë mund të shpëtohen, të gjithë janë pa arsye; dhe ai që nuk shpëtohet ndërkohë që i jepet drita e ungjillit, duhet të pranojë faktin se vetëm ai është përgjegjës për gjendjen e tij.

## **PJESA E NJERIUT NË SHPËTIM**

Të jemi të sigurtë se feja ka dy anë. Njeriu ka pjesën e tij dhe Perëndia ka pjesën e Tij. Pjesa e njeriut, në kthimin e tij në besim apo në jetën e re, është përshkruar nga Shkrimi si pendim dhe besim.

### *1. Pendimi.*

Jezusi u tha farisenjve se arsyeja pse ata nuk u prekën nga predikimi i Gjon Pagëzorit, ndërkohë që shumë mëkatarë po ktheheshin, ishte sepse “as mbasi i keni parë këto gjëra, nuk u penduat për t’i besuar” (Mateu 21:32). Pali, në të njëjtën mënyrë, në Veprat 20:21, e përmbledh predikimin e tij me fjalinë që përmban “pendimin te Perëndia, dhe besimin në Zotin tonë Jezus Krisht.” Duke folur për fillimin e jetës së krishterë, autori i letrës së Hebrenjve i referohet me “themel pendimi nga vepra të vdekura dhe nga besimi te Perëndia” (Heb. 6:1).

Tani ka nga ata që na mësojnë se të shpëtohesh gjithçka që nevojitet është “thjesht të besosh.” Por referencat që sapo cituam na tregojnë se, përpara se ne të *mund* të besojmë, që Perëndia do të na falë mëkatet tona, është e nevojshme të pendohemi.

Dhe pendimi, të jemi të sigurtë, shpesh keqkuptohet. Shumë njerëz, ndoshta, do të thoshnin se pendimi është një “keqardhje e perëndishme për mëkatin,” dhe ata do mund të besonin se po citojnë nga Bibla. Sidoqoftë, ajo çfarë Bibla thotë në të vërtetë është: “Trishtimi sipas Perëndisë në fakt, sjell pendim për shpëtim për të cilin njeriu nuk i vjen keq” (2 Kor. 7:10). Sepse, ju e shikoni, se pendimi nuk është një ndjenjë apo një emocion. Pendimi është një veprim, një vendim. Është vendimi për t’i dhënë fund mëkateve dhe gjithçkaje që nuk i pëlqen Perëndisë, për të rrëfyer mëkatet, për t’i braktisur ato, dhe për të dalë nga “bota e mëkateve.” Dikush ka thënë me të drejtë: “Mund ta shprehni pendimin me shkronjat: B-R-A-K-T-I-S.”

Perëndia “i urdhëron të gjithë njerëzit dhe kudo që të pendohen” (Veprat 17:30). Pendimi është porta e drejtë dhe rruga e ngushtë që të çon në jetën, në Mbretërinë. Gjon Pagëzori (Mat. 3:2), vetë Jezusi (Marku 1:15), Pjetri (Veprat 2:38), dhe Pali (Veprat 20:21) të gjithë predikuan pendimin, dhe katedrat e kishave të sotme s’mund ta neglizhojnë pa vënë veten në rrezik.

Lidhur ngushtë me pendimin është “dëmshpërblimi” i cili do të thotë drejtvendosje e të gjitha gabimeve të të shkuarës ndaj të tjerëve, me aq sa të jetë e mundur. Ky nuk është vetëm një mësim i Dhjatës së Vjetër (Eksodi 22:3v); tregohet edhe në Dhjatën e Re në veprimet e rojtarit të burgut në Filipi, reagimi i menjëhershëm i të cilit ndaj ungjillit ishte të lante plagët, që kamzhiku i tij kishte shkaktuar mbi kurrizin e apostujve (Veprat 16:30-33). Në fakt, sinqeriteti dhe ndershmëria nuk do të kërkonin asgjë më pak.

Në disa raste, i vetmi korrigjim i mundshëm i gabimeve të së shkuarës, është një rrëfim i përuhur dhe një përpjekje e sinqertë për pajtim me ata ndaj të cilëve kemi mëkatuar. Jezusi tha: “Nëse ti, pra,

po paraqet ofertën tënde te altari, dhe atje kujtohesh se yt vëlla ka diçka kundër teje, lëre atje ofertën tënde para altarit dhe shko pajtohu më parë me vëllanë tënd; pastaj kthehu dhe paraqite ofertën tënde (Mat. 5:23-24).

Qëndrimi i penduar shihet gjithashtu në gatishmërinë për të falur, dhe për të vazhduar të falim, ata që bëjnë gabime ndaj nesh. Një fjalë që shpesh e përsëriti Mësuesi ynë e gjejmë te Marku 11:25: “Dhe kur nisni të luteni, nëse keni diçka kundër ndokujt, faleni, që edhe Ati juaj që është në qiejt, t’juaj falë mëkatet tuaja.” Një thënie e tillë duket se e shqetësoi Pjetrin. “Zot, nëse vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri shtatë herë?” Përgjigja e Jezusit ishte: “Unë nuk të them deri në shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë” (Mateu 18:21-22; krs. v.23-35).

## 2. Besimi

Besimi, nga ana tjetër, është ana tjetër e pendimit. Me të vërtetë, këto nuk janë dy, por një. Pendimi, të largon nga mëkati, dhe besimi të kthen tek Perëndia. Përkufizimi i famshëm i Dwight Moody (*Duajt Mudi-t*) ishte: “Besim do të thotë ta pranosh Atë (Jezusin) duke braktisur çdo gjë.”

Pjesa e dytë përfshin atë që e quajtmë pendim; ne lëmë dhe braktisim gjithçka që është e mëkatshme dhe e papëlqyer për Atin tonë qiellor, e kundërt me Fjalën e Tij dhe me ndërgjegjen tonë. Pjesa e parë përfshin kuptimin e besimit: ne pranojmë Krishtin si i vetmi dhe i gjithëmjaftueshmi Shpëtimtar i yni. Thelbi i këtij përkufizimi është që *njeriu* duhet të vendosë *për veten* dhe të *vetpërkushtohet*.

Thuhet se një ushtar e shprehu kthimin e tij te Krishti me këto fjalë: “Unë isha duke marshuar rrugës poshtë për në ferr, kur Kapiteni i shpëtimit tim thirri: ‘Ndal! Prapa kthehu! Para marsh!’ “ Kjo nuk është gjuhë teologjike, por shpreh qartë lidhjen ndërmjet besimit dhe pendimit. Secila prej tyre është e pamundur pa tjetrën, tamam si një njeri nuk mund të kthejë kurrizin e tij nga veriu pa kthyer më

parë fytyrën e tij nga jugu. Pendimi, t'i kthesh shpinën mëkatit, dhe besimi, të kthesh fytyrën nga Perëndia, janë dy anë të të njëjtit proces.

Tamam, siç nuk mund të ketë besim pa pendim, po ashtu nuk mund të ketë pendim (në sensin biblik) pa besim. Të rrëfesh mëkatet pa marrë faljen e tyre përmes besimit nuk është veçse të krenohesh për mëkatet e tua para Perëndisë.

Nuk mund të theksohet sa duhet se besimi është shumë më tepër se “aprovim i së vërtetës së ungjillit.” Është përkushtim ndaj Krishtit dhe mbështetje e plotë në të. Martin Luter ka thënë: “I vetmi besim që të bën të krishterë është ai që e dorëzon veten tek Perëndia.” Pasi kanë qënë të ndarë në mënyrë të gabuar për shumë vite nga teologjia moderne, besimi dhe bindja tani po shikohen sërish si dy terma të lidhur ngushtë me njëri tjetrin - kaq ngushtë të lidhur së bashku saqë një studiues i kohëve të fundit deklaroi se ato pothuaj mund të përdoren në vend të njëra tjetrës. Autori i këngës e pa atë që teologët s'e shikonin:

*Beso dhe bindu  
Se tjetër rrugë s'ka  
Për të qënë i lumtur në Jezusin  
Veçse bindu e beso*

## PJESA E PERËNDISË NË SHPËTIM

Kur i kthehemi pjesës së Perëndisë në shpëtim, gjejmë gjithashtu dy aspekte ose dy faza. Kur ne pendohemi (duke rrëfyer dhe duke i braktisur mëkatet) dhe besojmë (duke pranuar Krishtin si Shpëtimtarin tonë me anë të besimit në vdekjen e Tij shlyese), atëherë Perëndia bën dy gjëra: Ai e fal të kaluarën, dhe Ai na jep risinë e jetës për të tashmen dhe të ardhmen.

### 1. Shfajësimi

Falja është ajo që ne e quajmë “shfajësimi.” Do të thotë që Perëndia e fshin kujtimin e shkeljeve tona dhe nuk i ruan më ato



kundër nesh. Mëkatet tona të së kaluarës janë në sytë e Perëndisë sikur të mos kishin qënë kurrë.

Duhet thënë se shfajësimi është për nga vetë natyra e vet “falje e mëkateve që janë kryer më parë” (Rom. 3:25). Të japësh mësim, siç bëjnë disa, se falja e Perëndisë menjëherë përfshin të gjitha mëkatet e së shkuarës, të gjitha mëkatet e së tashmes, të gjitha mëkatet e së ardhmes, do të thotë të ushqesh një fantazi të rrezikshme. Falja të shkarkon nga borxhi për mëkatet e së shkuarës për sa ka të bëjë me të qënit fajtor dhe me dënimin.

Diçka tjetër duhet theksuar këtu gjithashtu: falja ka të bëjë me fajin e mëkateve dhe nuk do të thotë domosdo se të gjitha pasojat e mëkateve të së shkuarës janë eliminuar. Shfajësimi është një akt ligjor në mendjen e Perëndisë i cili në vetvete nuk e ndryshon statusin e përkohshëm të personit të shfajësuar. Kjo do të thotë se, në masën që mëkati përfshin pasoja fizike dhe shoqërore, ato mbase do lipset të mbarten edhe pasi shfajësimi na ka pastruar nga ndëshkimi hyjnor. Një i ri që e dobëson trupin e tij “duke plotësuar teka të mbrapshta” ose “duke rendur pas kotësive” do t’i duhet të jetojë në vuajtje, sëmundje dhe kufizime për gjithë jetën e tij. Dikush që e përfshin veten e tij në një marrëdhënie bashkëshortore të mëkatshme dhe jo të drejtë, mund të mos çlirohet kurrë nga gjurmët e kësaj dhe mund të vuajë pasojat me dëshpërim personal, edhe pasi mëkati t’i jetë falur.

Jezusi e ilustroi këtë të vërtetë në atë që ne e njohim si “Shëmbëlltyra e djalit plangprishës” tek Luka 15:11-32, kur ai citoi fjalët e babait drejtuar djalit më të madh, “Çdo gjë që kam është e jotja”(v. 31). Iu dha falje djalit më të vogël dhe pajtim me të atin, por pasuria që e mori me vete në vendin e largët humbi. Ai e kishte “prishur gjithë pasurinë, duke bërë një jetë të shturur”(v. 13), dhe u kthye duarbosh në vendin nga i cili ishte nisur duarplot. Le të mos e harrojmë kurrë: udhëtimi për në vendin e largët është më i kushtueshëm sesa mund ta përballojë ndonjeri nga ne. Ndërsa plagët e mëkatit mund të shërohen, gjurmët e tij mbeten.

## 2. Ripërtëritja

Pjesa e dytë e veprës së Perëndisë kur ne pendohemi dhe besojmë, është se ai na jep risinë e jetës. Këtë ne e quajmë ripërtëritje. Fjalë për fjalë do të thotë atë, rreth së cilës Jezusi i foli Nikodemit, një lindje e re. “Nëse dikush është në Krishtin,” tha Pali, “ai është një krijesë e re: gjërat e vjetra kanë shkuar; ja të gjitha gjërat u bënë të reja” (2 Kor. 5:17).

Ndërkohë që shfajësimi mund të përshkruhet si ndryshim në qëndrimin e Perëndisë ndaj nesh, ripërtëritje përfshin një ndryshim aktual që ndodh brenda nesh. Është fillimi i asaj që në kapitullin tjetër do ta quajmë “shenjtërimi,” puna e Frymës së Perëndisë për të na shpëtuar nga sundimi i mëkatit.

Sepse mëkati në jetën tonë nuk përfshin vetëm fajësimin tonë, por edhe skllavërinë. Pali e bën të qartë, veçantërisht në diskutimin e tij klasik tek Romakët 7, që asnjë person nuk mund ta çlirojë veten nga kjo skllavëri me vullnetin e vet. Vetëm me anë të “larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë” (Titi 3:5), mundemi ne të shpëtohem nga zakone dhe qëndrime mëkatore, që janë pjesë e natyrës së atyre që jetojnë pa Krishtin.

Ne bëhemi pjesëmarrës të Krishtit “të ringjizur jo nga një farë që priset, por që nuk priset, me anë të fjalës së Perëndisë së gjallë dhe që mbetet përjetë” (1 Pjetrit 1:23). Pa këtë rilindje të shpirtit, nuk ka jetë dhe ecje të krishterë: “Në qoftë se ndokush nuk e ka Frymën e Krishtit, ai nuk i përket atij” (Rom. 8:9).

Ne tashmë i kemi cituar përshkrimet e qarta të Palit për të krishterin e Dhjatës së Re: “në Krishtin” dhe “një krijesë e re,” për të cilin të gjitha u bënë të reja (2 Kor. 5:17). Jeta e re në Krishtin do të thotë një marrëdhënie e re me Perëndinë duke qënë i pajtuar me Të (v. 18). Gjithashtu do të thotë një qëllim i ri në jetë, për t’i shërbyer Perëndisë dhe për ta kënaqur Atë, një fuqi e re në tundime (1 Kor. 10:13); dhe një konceptim i ri i kuptimit të ekzistencës dhe destinacionit të njerëzimit.

### 3. *Birësimi*

E lidhur shumë ngushtë me lindjen e re është idea e birësimit. Kjo është një nga mënyrat më të preferuara të Palit për të përshkruar statusin e ri të besimtarit në Krishtin (Rom. 8:15; Gal. 4:5; Efes. 1:5). Mund të thuhet se ndërsa përtëritja ka të bëjë me natyrën e re brenda nesh përmes së cilës ne bëhemi me të vërtetë fëmijë të Perëndisë, birësimi ka të bëjë me privilegjet dhe statusin, të cilat u përkasin atyre që bëhen fëmijë të Perëndisë. Dy prej këtyre mund t'i nënvizojmë. Këto janë siguria dhe trashëgimia.

*a. Siguria.* Edhe tek Romakët edhe tek Galatasve, Pali e lidh birësimin tonë si fëmijë të Perëndisë me prezencën e Shpirtit të Tij, që dëshmon për faktin se ne jemi të pranuar prej Tij: “Sepse ju nuk keni marrë një frymë robërie, që të keni përsëri frikë, po keni marrë frymën e birësisë, me anë të së cilës ne thërrasim: “Abba, o Atë!” vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë” (Rom. 8:15-16); “Që të shpengonte ata që ishin nën ligj, që ne të fitojmë birërinë. Dhe duke qënë se jeni bij, Perëndia dërgoi Frymën e Birit të Tij në zemrat tuaja që thërret: “Abba, Atë!” (Gal. 4:5-6)

Dëshmia e Shpirtit është ai sens i sigurisë që Perëndia ua jep atyre që besojnë në Birin e Tij për shpëtim. Kjo është shumë më tepër se shprehjet “do doja që,” ose “shpresoj që,” ose “mendoj se” me të cilat kaq shumë vetë përshkruajnë mardhënien e tyre me Perëndinë. Ky në fakt është një shpëtim “e di që.” Çdo lloj tjetër është një përshkrim jo plotësisht sipas Shkrimit.

*b. Trashëgimia.* Pali jo vetëm që e lidh sigurinë me birësimin; ai gjithashtu e lidh atë me idenë e trashëgimisë: “Dhe nëse jemi bij, jemi edhe trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë të Krishtit, nëse vuajmë me të dhe lëvdohemi me të” (Rom. 8:17); “Prandaj ti nuk je më shërbëtor, por bir; dhe në qoftë se je bir, je edhe trashëgimtar i Perëndisë me anë të Krishtit” (Gal. 4:7).

## FITORE MBI MËKATIN

E gjithë puna e shndërrimit merret me problemin e veprave të mëkatit në jetën tonë. Shfajësimi, siç e kemi parë, zgjidh problemin e mëkateve së të shkuarës duke i hequr ata nga defteri. Ripërtëritja merret me problemin e mëkateve të tashme dhe të ardhme duke thyer fuqinë e zakoneve mëkatore dhe duke na siguruar hirin për të patur një jetë me fitore.

*1. Të aftë për të mos mëkatuar.*

Nuk është se për të krishterët është i pamundur mëkatimi. Por që ata janë të aftë të mos mëkatojnë me anë të hirit të Perëndisë brenda tyre. Deri sa ai të shenjtërohet plotësisht, besimtari do të ndeshet kundër gjendjes së banimit të mëkatit brenda zëmrës së tij. Por premtimi i Perëndisë është që Ai të na ruajë me anë të fuqisë së Tij. “Perëndia është besnik,” na siguron Fjala e Tij, “dhe nuk do të lejojë që t’ju tundojnë përtej fuqive tuaja, por me tundimin do t’ju japë edhe rrugëdalje, që ju të mund ta përballonit” (1 Kor. 10:13).

Duhet ta pranohet se shumë të kishterë, të deklaruar si të tillë, nuk përjetojnë një fitore të tillë. Shumë prej tyre u kanë mësuar të mos presin gjë tjetër përveçse të “mëkatojnë çdo ditë në fjalë, mendime dhe vepra,” dhe t’i rrëfejnë “mëkatet” e tyre çdo natë para se të bien të flenë. Disa të tjerë e zgjerojnë kuptimin e mëkatit për të përfshirë si mëkat të gjitha llojet e dobësisë njerëzore dhe gabimeve të pavullnetshme, megjithatë jetojnë jetë mjaft të devotshme pavarësisht nga teologjia e tyre e gabuar. Por tragjedia qëndron në faktin se të presësh humbjen do të thotë ta pësosh me siguri atë, dhe ta zgjerosh aq shumë idenë e mëkatit sa ta quash çdo gjë mëkat, siç e pamë në kapitullin e kaluar, do të thotë në fakt të mos quash asgjë mëkat. Domethënë, vija e mprehtë ndarëse ndërmjet mëkatit dhe dobësisë apo mungesës njerëzore fshihet, ndërsa shkeljet e vërteta, që ne bëjmë kundër hirit dhe mirësisë së Perëndisë, nuk duken të jenë më serioze sesa gabimet që ne nuk mund t’i shmangim.

## 2. *Fjala e Zotit është e qartë.*

Shumë referenca biblike mund të jepeshin për ta hedhur poshtë këtë nocion “të shenjtëve mëkatore” (për shembull, Rom. 5:8; 6:1, 15; 8:2-3; Gal. 2:17-18; 1 Thes. 2:10; Heb. 9:26, si fillim). Por tre shembuj nga 1 Gjoni do të na shërbejnë për të ilustruar përmbajtjen e të gjithë atyre: “Ai që thotë ‘Unë e kam njohur atë,’ dhe nuk zbaton urdhërimet e tij, është gënjeshtar dhe e vërteta nuk është në të”(2:4). “Kush kryen mëkat është nga djalli, sepse djalli mëkaton nga fillimi; prandaj është shfaqur Biri i Perëndisë: për të shkatërruar veprat e djallit. Kush lindi nga Perëndia nuk kryen mëkat, sepse fara e Perëndisë qëndron në të dhe nuk mund të mëkatojë sepse lindi nga Perëndia”(3: 8-9). “Ne e dimë se kushdo që ka lindur nga Perëndia nuk mëkaton; ai që ka lindur nga Perëndia e ruan veten e tij, dhe i ligu nuk e prek atë”(5:18).

Një sy i mprehtë e dallon një kontradiktë të dukshme ndërmjet pohimit të 1 Gjoni 3:9, “Nuk mund të mëkatojë sepse ai ka lindur nga Perëndia,” dhe asaj që përmendëm pak më parë rreth faktit që të jesh një i krishterë nuk do të thotë që nuk je në gjëndje të mëkatosh, por që je i aftë të mos mëkatosh. Ndoshta një perifrazim i vargut në tërësi do ta qartësojë mospërputhjen: “Kush është një njeri i ndershëm nuk vjedh; sepse ndershmëria e tij mbetet në të: dhe ai nuk mund të vjedhë sepse ai është një njeri i ndershëm.” Kjo e tregon të qartë kuptimin e fjalës “nuk mund” në vargun tonë. Pra nuk do të thotë se njeriu i ndershëm nuk ka dëshira ose duar e këmbë që do ta bënin atë të aftë për të marrë diçka që nuk i përket atij. Por se e thotë qartë se një njeri i ndershëm “nuk mund” të vjedhë – sepse në momentin që ai vjedh ai nuk është më një njeri i ndershëm por një hajdut. Gjoni bën të njëjtin kontrast ndërmjet farës së ripërtërirë të Perëndisë dhe kryerjes së mëkateve. Thjesht është e pamundur të jesh një “shenjtor mëkatar” po ashtu siç është e pamundur të jesh një njeri i ndershëm hajdut, një gënjeshtar që thotë të vërtetën apo një tradhtar besnik.

## 3. *Dëshmi e përuhur.*

Edhe një herë, nuk ka asnjë mendim për përgëzim të vetes apo krenari shpirtërore këtu. Është Krishti ai që na shpëton ne nga mëkatet

tona. Është hiri i Tij që na aftëson të jetojmë si i pëlqen Atij. Do të ishte arrogancë për këdo që do të thoshte: “Unë nuk mëkatoj.” Është një dëshmi e përvullur, e dhënë me sinqeritet nga shumë të krishterë të vërtetë dhe të sinqertë, të thuhet: “Gjaku i Jezus Krishtit, Birit të Tij, më pastron mua nga çdo mëkat.” Ndryshimi mes të dyjave është thelbësor. E para lartëson veten dhe si e tillë përgënjeshtrohet - sepse të lartësosh veten përmbi Krishtin është në fakt mëkat. E dyta lavdëron hirin e Perëndisë dhe vendos në vend të parë gjakun që na pastron dhe na ruan.

Sa e mrekullueshme është jeta në Krishtin! Jeta në fakt fillon, jo në lindjen, as në moshën njëzet e një vjeçare, as në të dyzetat as në të tetëdhjetat, por tek Kalvari. Këtu ne fillojmë të ecim në risinë e jetës, trashëgimtarë të pasurive të Tij në lavdi me anë të Krishtit Jezus.

*Ne besojmë se pendimi, i cili është një ndryshim i sinqertë dhe tërësor i mendjes në lidhje me mëkatit, duke përfshirë një ndjenjë faji personal dhe një kthim të vullnetshëm prej mëkatit, kërkohet nga të gjithë ata që përmes veprimit apo qëllimit bëhen mëkatarë ndaj Perëndisë. Shpirti i Perëndisë u jep të gjithë atyre që pendohen ndihmë për pendesën e zemrës dhe shpresë për mëshirë kështu që ata të mund të besojnë në faljen dhe jetën shpirtërore.<sup>9</sup>*

*Ne besojmë se shfajësimi është akti hirplotë dhe juridik i Perëndisë, me anë të të cilit Ai u jep falje të plotë për të gjithë fajet dhe çlirim të plotë nga dënimi për mëkatet e kryera, si dhe pranim si të drejtë, të gjithë atyre që besojnë në Jezus Krishtin dhe e pranojnë Atë si Zot dhe Shpëtimtar.*

*Ne besojmë se ripërtëritja ose lindja e re, është ajo punë e hirshme e Perëndisë me anë të së cilës natyra morale e besimtarit të penduar ngjallet shpirtërisht dhe i jepet atij një jetë shpirtërore e veçantë, e aftë për besim, dashuri dhe bindje.*

<sup>9</sup> *Ibid*, Neni VIII.

*Ne besojmë se birësimi është ai akt i hirshëm i Perëndisë, me anë të të cilit besimtari i shfajësuar dhe i ripërtërirë, bëhet bir i Perëndisë.*

*Ne besojmë se shfajësimi, ripërtëritja dhe birësimi ndodhin në të njëjtën kohë në përvojën e atyre që kërkojnë Perëndinë dhe merren duke pasur si kusht besimin, të paraprirë nga pendimi; dhe se Shpirti i Shenjtë jep dëshmi për këtë punë dhe gjendje hiri.<sup>10</sup>*

### Për diskutim të mëtejshëm

1. Si bëhen qëniet njerëzore fëmijë të Perëndisë?
2. Çfarë përfshin pjesa e njeriut në shpëtim?
3. Cila është natyra e pendimit? Si lidhet me dëmshpërblimin? Po me besimin shpëtues?
4. Në çfarë kuptimi është besimi shpëtues më shumë se “pranimi i të vërtetave të ungjillit”?
5. Cila është pjesa e Perëndisë në shpëtim? Çfarë do të thotë shfajësim? Ripërtëritje? Birësim?
6. Çfarë mund të thuhet në lidhje me të krishterin e vërtetë dhe problemin e mëkatit në jetën e tij?
7. Si duhet një i krishterë të dëshmojë për faktin e fitores mbi mëkatin?

<sup>10</sup> *Ibid.*, Neni IX.

## BESIMET RRETH SHENJTËRIMIT TË PLOTË

Që puna e Perëndisë në ne nuk përfundon me lindjen e re, ka qënë besimi unanim i të krishterëve të vërtetë që nga koha e apostujve deri sot. Faza më e rëndësishme e punës së hirit hyjnor brenda nesh njihet si shenjtërim.

Kjo na shpie në arenën e madhe të besimeve rreth shenjtëritimit të plotë. Shenjtërimi për nga rëndësia që ka nuk mund të shmanget. Por duhet ta kuptojmë dhe ta kërkojmë.

### ÇFARË ËSHTË SHENJTËRIMI?

Përkufizimi më i gjerë i shenjtëritimit, dhe ai me të cilin praktikisht të gjithë protestantët konservativë bien dakord, është se shenjtërimi është puna e Perëndisë Fryma e Shenjtë në lidhje me karakterin moral të njerëzve të Tij, ku Ai i çliron ata nga mbretërimi i mëkatit dhe i sjell në devocion të plotë ndaj qëllimeve dhe vullnetit të vet. Kjo do të thotë se shenjtërimi, në kuptimin e vet më të gjerë, do të thotë të tërë punën shpenguese të Perëndisë, në atë masë që natyra jonë njerëzore është aktualisht e ndryshuar dhe jeta jonë është sjellë në harmoni të vërtetë me vullnetin e Perëndisë.

Është kaq e zakonshme të vëmë re se në këtë kuptim shenjtërimi *fillon* me lindjen e Frymës, të cilën e pamë në kapitullin e kaluar, dhe *përfundohet* me pagëzimin me Frymën. Ajo me të cilën ne jemi vërtetë të preokupuar është, pra, shenjtërimi i plotë, siç shprehet tek 1 Thes. 5:23, nga Pali: “Dhe Perëndia i paqes ju shenjtëroftë ai vetë tërësisht; dhe gjithë fryma juaj shpirt e trup, të ruhet pa të metë për ardhjen e Zotit tonë Jezus Krisht.”

Çfarë, pra, është shenjtërimi në kuptimin më të plotë të fjalës? Ndoshta dy përkufizime të tjera do të na ndihmojnë të marrim



kuptimin e saj biblik. Në *Leksikonin grek të Tajer* (Thayer) ne gjejmë fjalën origjinale për shenjtërimin si të përkufizuar “përkushtim ose shenjtërim, pastrim.” Në fjalorin *Webster’s New International Dictionary* kuptimi i termit është “veprimi ose procesi i hirit të Perëndisë, me anën e të cilit ndjenjat e njeriut janë pastruar, ose kanë larguar mëkatin dhe janë lartësuar në një dashuri supreme për Perëndinë dhe drejtësinë.”

## GJERËSIA E MËSIMIT TË DHJATËS SË RE

Bibla e përshkruan shenjtërimin e plotë në disa mënyra të ndryshme. Flet për të si rezultati i pagëzimit me Frymën e Shenjtë (Vepr. 1:5), i cili e pastron zemrën me anë të besimit (Vepr. 15:8-9). Quhet pastërti e zemrës (Mat. 5:8; Jak. 4:8); pastrim i vetes nga çdo ndotje e mishit dhe e frymës (2 Kor 7:1); pastrim nga çdo mëkat (1 Gjoni 1:7); kryqëzim i njeriut tonë të vjetër dhe anulim i trupit të mëkatit (Rom. 6:6); shenjtërim (Heb. 12:14); përsosmëri e krishterë ose dashuri e përkryer (Mat. 5:48; 1 Gjoni 4:17-18); të qënit njeri frymëror (1 Kor. 2:15; 3:1); tërësia e bekimeve (Rom. 15:29); dhe prehja e besimit (Hebr. 4).

Diçka për gjerësinë e mësimin të Dhjatës së Re rreth shenjtërimit të plotë, mund të shihet në referencat që sapo dhamë. Mësojmë akoma më shumë kur vëmë re se secili prej autorëve të mëdhenj të Dhjatës së Re jep dëshmi për natyrën dhe nevojën për një përjetim të tillë.

### 1. Autorët e ungjijve.

Në ungjijtë sinoptikë, që janë Mateu, Marku, dhe Luka, ne gjejmë kontrastin e madh ndërmjet pagëzimit të Gjonit me ujë për pendim dhe falje të mëkateve dhe pagëzimit të Krishtit me Frymën e Shenjtë si pagëzim me zjarr, ku ai pastron lëmin e vet dhe mbledh grurin në hambarë. (Mat. 3:11-12; Mark 1:8; Luka 3:16-17). Dhe përderisa uji dhe zjarri nuk mund të përzihen së bashku, këto pagëzime nuk mund të jenë në të njëjtën kohë. Meqenëse pagëzimi është një ngjarje që ndodh në një kohë dhe vend të caktuar, pra pagëzimi me Frymën

e Shenjtë nuk mund të ishte “gradual” po ashtu si edhe pagëzimi me ujë.

*a. Mateu.* Përveç kësaj, Mateu thekson bekimin e veçantë për ata që janë të pastër në zemër (Mat. 5:8). Meqenëse të gjitha lumturitë e tjera kanë të bëjnë me klasa njerëzish aktualisht prezentë, Jezusi, me siguri edhe këtu, mësonte se ka aktualisht njerëz zemrat e të cilëve janë pastruar. Duke folur për drejtësinë e brendshme të dashurisë, Ai gjithashtu tha: “Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej” (Mat. 5:48).

*b. Marku.* Marku thekson faktin se burimi i të keqes në jetën njerëzore është brenda tij, prishja morale që vjen nga një zemër e kontrolluar prej mishit, jo ndotje nga jashtë (Marku 7:21-23). Ai gjithashtu na tregon mësimin e Jezusit se ligji suprem është të duash Perëndinë me gjithë zemrën, shpirtin, mendjen dhe fuqinë tënde, dhe të duash të afërmin tënd si veten (Marku 12:29-31), një standard ky i mundshëm vetëm për ata dashuria e të cilëve është bërë e përsosur me anë të Frymës (1 Gjoni 4:12-13).

*c. Luka dhe Veprat.* Luka na mëson se Krishti erdhi në mënyrë që njerëzit e Tij të mund t’i shërbenin Perëndisë pa frikë, “në shenjtëri dhe në drejtësi përpara atij gjithë ditët e jetës sonë” (Luka 1:73-75). Ai citon premtimin e Krishtit për fëmijët e Perëndisë, “aq më tepër Ati juaj qiellor do t’u dhurojë Frymën e Shenjtë atyre që ia kërkojnë” (Luka 11:13); dhe jep urdhëresën e Zotit tonë: “Dhe ja, unë po dërgoj mbi ju premtimin e Atit tim, por ju qëndroni në qytetin e Jeruzalemit deri sa të visheni me pushtet nga lart” (Luka 24: 49).

Në Veprat e Apostujve, Luka tregon në detaje përmbushjen e premtimit të Zotit në ditën e Rrëshajave (Vep. 2:1-4), për Samarinë (Vep. 8:14-17), për Saulin nga Tarsi (Vep. 9:17), në shtëpinë e centurionit Kornel (Vep. 10:34-37, 44; 11:15; 15:8-9), dhe në Efes (Vep. 19:1-7). Luka gjithashtu citon fjalët e Palit “Dhe tani, o vëllezër, unë po ju lë te Perëndia dhe te fjala e hirit të tij, që është në gjendje t’ju ndërtojë dhe t’ju japë trashëgimin në mes të të gjithë të shenjtëruarve” (Vep. 20:32); dhe ngarkimin e Krishtit “që t’u çelësh

sytë atyre dhe t'i kthesh nga errësira në dritë dhe nga pushteti i Satanit te Perëndia, që të marrin me anë të besimit në mua faljen e mëkateve dhe një trashëgim në mes të të shenjtëruarve”( Vep. 26:18).

*d. Gjoni dhe shkrimet e tij.* Në ungjillin e Gjonit ne gjejmë premtimet më të qarta të Frymës që janë dhënë para ditës së Rrëshajave: Gjoni 7:38-39; 14: 15-17; 14: 26-27; 16: 7-13; dhe lutjen e madhe të Jezusit në Gjonin 17:15-22.

Dy prej këtyre pasazheve meritojnë vëmendje të veçantë. Në Gjoni 14:15-17, Jezusi thotë: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia. Dhe unë do t'i lutem Atit dhe ai do t'ju japë një Ngushëllues tjetër, që do të qëndrojë përgjithmonë me ju, Frymën e së Vërtetës, që bota nuk mund ta marrë, sepse nuk e sheh dhe nuk e njeh; por ju e njihni, sepse qëndron me ju dhe do të jetë në ju.” Këtu ne shohim se premtimi është për ata që e duan Krishtin dhe i mbajnë urdhërimet e tij; bota nuk mund ta marrë Ngushëlluesin e premtuar. Ai është me besimtarët, por është premtuar se Ai do të vijë për të banuar në ta në një mënyrë të re dhe më të plotë.

Në lutjen e Jezusit tek Gjoni 17 ne gjejmë kërkesën kyçe në vargun 17: “Shenjtëroji në të vërtetën tënde; fjala jote është e vërteta.” Ata për të cilët Jezusi u lut e kishin zbatuar fjalën e Perëndisë (v. 6); Zoti ishte përlëvduar në ta (v. 10); dhe ata nuk ishin prej botës ashtu si edhe Ai nuk ishte prej botës (v. 14, 16). Lutja është thënë që gëzimi i Tij të bëhet i plotë në ta (v. 13); që ata të mbroheshin nga i ligu (v. 15); që ata të jenë një (v. 21); që bota të mund të besojë (v. 23); dhe që ata të mund të jenë me Krishtin dhe të shohin lavdinë e Tij në fund (v. 24).

Në letrën e parë të Gjonit ne gjejmë një theksim të fortë të pastrimit nga i gjithë mëkati dhe të përsosmërisë së dashurisë “Po të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë, kemi bashkësi njeri me tjetrin, dhe gjaku i Jezus Krishtit, Birit të Tij na pastron nga çdo mëkat”(1 Gjoni 1:7). “Dhe kushdo që e ka këtë shpresë në të, le ta pastrojë veten, siç është i pastër ai”(1 Gjoni 3:3); dhe, “Në këtë dashuria u përsos në ne (që të kemi guxim në ditën e gjyqit): sepse sikurse është ai, po kështu jemi edhe ne në këtë botë. Në dashuri nuk ka

frikë, madje dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën, sepse frika ka të bëjë me ndëshkimin, dhe ai që ka frikë nuk është i përsosur në dashuri”(1 Gjoni 4: 17-18).

## 2. Shkrimet e Palit

Shkrimet e Palit janë në mënyrë të veçantë plot me mësim të shenjtërisë së plotë, meqë vetë Pali ishte misionari dhe teologu i madh i kishës së hershme. Në 1 Thesalonikasve theksi është në mënyrë të veçantë mbi shenjtërimin si një “bekim i dytë,” siç do ta shohim duke krahasuar 1. Thes. 3:10; 4:3, 7-8; dhe 5:22-24 me dëshminë e apostullit të dhënë në kapitujt 1 dhe 2 për përvojën e sinqertë të krishterë të këtyre njerëzve.

Në Rom. 6-8, Pali flet për punën totale të Perëndisë në shenjtërimin, edhe të pjesshëm edhe të plotin. Kapitulli 6 merret me idealin e shenjtërisë; kapitulli 7 tregon se as ligji as forca e vullnetit dhe karakterit nuk mund të merret në mënyrën e duhur me mëkatit e brendshëm; dhe kapitulli 8 nxjerr në dukje çlirimin e madh: “Sepse ligji i Frymës i jetës në Jezus Krishtin më çliroi nga ligji i mëkatit dhe i vdekjes”(v. 2). Është Fryma e Perëndisë që na çliron ne nga mendja e kontrolluar prej mishit (v. 6), që përmbush drejtësinë përbrenda (v. 4), që garanton ringjalljen e trupave tanë vdekatarë (v. 11), që dëshmon për marrëdhënien tonë me Perëndinë (v. 14-17), që na ndihmon në dobësitë tona, dhe që na drejton në lutjet tona (v. 26-27).

1 Korintasve flet për nevojën urgjente për shenjtëri (3:1-2) dhe përshkruan punën e dashurisë (13:1-13). 2 Korintasve na kujton për premtimet e Perëndisë për fëmijët e Tij, dhe na nxit: “Duke i pasur këto premtime, o të dashur, le të pastrojmë veten nga çdo ndotje e mishit dhe e frymës dhe ta përfundojmë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë”(v. 7:1). Galatasve tbekson nevojën për një kryqëzim të përbrendshëm (2:20; 6:14) si mjeti i vetëm për t’i dhënë fund betejës së mishit kundër Frymës (5:17, 24).

Tek Efesianët ne lexojmë për shenjtërinë në lidhje me kishën;

në qëllimin e Perëndisë (1:4); lutjen e apostullit (3:14-21); qëllimin e shërbesës (4:11-13); “njeriun e vjetër” dhe “njeriun e ri” (4:22-24); plotësinë e Frymës (5:18); dhe dashurinë e Krishtit për kishën (5:25-27). Tek Filipianët, shenjtëria shihet si përsosmëri e krishterë (3:12-15). Tek Kolosianët, shenjtëria përshkruhet si rezultat i jetës së ringjallur (3:1-14) me të gjitha kërkesat etike që vijnë.

Në letrën drejtuar Timoteut dhe Titit ne lexojmë se dashuria prej një zemre të pastër është synimi i urdhëresës (1 Tim. 1:5); se nëse dikush e pastron veten e tij nga çdo gjë që do ta ndotte do të jetë “një enë nderi, e shenjtëruar dhe e dobishme për të zotin, e përgatitur për çdo vepër të mirë” (2 Tim. 2:21); ndërkohë që mësimet e hirit janë të përshkuara se “na mëson të mohojmë pabesinë dhe lakmitë e botës, sepse ne rrojmë me urtësi, me drejtësi dhe perëndishmëri në këtë jetë; duke pritur shpresën e lume dhe të shfaqurit e lavdisë të të madhit Perëndi dhe të Shpëtimtarit tonë Jezus Krisht, i cili e dha veten për ne, për të na shpenguar nga çdo paudhësi dhe për të pastruar për vete një popull të veçantë, të zellshëm në vepra të mira” (Tit 2:12-14).

### 3. *Hebrenjve.*

Autori i letrës drejtuar Hebrenjve flet për qëllimin e Krishtit për shenjtërimin (2:11), dhe na kujton se përjetimi i Izraelit në lidhje me Kananin është një përshkrim i prehjes së besimit për besimtarët (kapituj 3 dhe 4). Ai i nxit të gjithë të synojnë përkryerjen” (6:1), duke na siguruar se Krishti është në gjendje të shpëtojë plotësisht (7:25). Gjaku i Jezus Krishtit është shumë më tepër i aftë të shenjtërojë sesa gjaku i demave dhe i cjepeve (9:13-14), sepse Krishti vetë është Flijimi me anën e të cilit ne shenjtërohemi përmes vullnetit të Perëndisë (10:9-10, 14).

Ne duhet “të kërkojmë paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk ka për ta parë Perëndinë” (Heb. 12:14). Dhe në qoftë se nuk bëjmë kështu humbasim hirin e Perëndisë (v. 15), ose turbullohemi nga ndonjë rrënjë e hidhur që na ndot (v. 15), ose madje

vuajmë fatin e Esaut i cili për një dëshirë momentare shiti të drejtën e tij të parëbirtisë dhe më vonë, kur ai deshi të trashëgojë bekimin, iu refuzua (v. 16-17). Meqë Krishti e derdhi gjakun e Tij për të shenjtëruar njerëzit e Tij, ne duhet të mbartim poshtërimin e Tij (13:12-13). Edhe bekimi i madh madje është një thirrje shenjtërimi: “Dhe Perëndia i paqes, që e ngriti nga të vdekurit, me anë të gjakut të Besëlidhjes së amshuar, Bariun e madh të dhënve, Perëndinë tonë Jezus Krisht, ju bëftë të përsosur për çdo vepër të mirë, që të kryeni vullnetin e tij, duke punuar te ju atë që është e pëlqyer përpara Tij, me anë të Jezus Krishtit, të cilit i qoftë lavdi në shekuj të shekujve. Amen” (13:20-21).

#### 4. *Jakobi*

Jakobi, me prirjen për të qënë praktik, merret me të dyja, si me nevojën e të pashenjtëruarve ashtu edhe me mënyrën për plotësimin e saj. “Është një njeri me dy mendje, i paqëndrueshëm në të gjitha rrugët e veta.” “Afrohuni te Perëndia dhe ai do t’ju afrohet juve; pastroni duart tuaja, o mëkatarë; dhe pastroni zemrat tuaja o njerëz me dy mendje” (1:8; 4:8). Ai dëshiron fort që feja të jetë “e pastër” dhe “pa njolla”(1:27), dhe që dituria me anë të së cilës ne të jetojmë të jetë “së pari e pastër” (3:17).

#### 5. *Pjetri*

Pjetri vë në dukje se shenjtërimi është puna e Frymës (1 Pj. 1:2), dhe se motivimi suprem për fëmijët e Perëndisë për të qënë të shenjtë është shenjtëria e Perëndisë (1 Pj. 1:15-16), dhe se pastërtia vjen me anë të bindjes ndaj të vërtetës me anë të Frymës (1 Pj. 1:22). Me anë të premtimeve të Perëndisë ne mund t’i shpëtojmë “prishjes që është në botë për shkak të lakmisë” dhe të bëhemi “pjestarë të natyrës hyjnore” (2 Pj. 1:4). Duke patur parasysh kthimin e Zotit ne duhet të jetojmë çdo ditë “me një sjellje të shenjtë dhe të perëndishme” (2 Pj. 3:11).

## ANA NJERËZORE E SHENJTËRISË

Mund t'ju kujtohet se kur folëm për kthimin në besim ne pamë se kishte dy anë në këtë ngjarje të madhe, ana njerëzore dhe ajo hyjnore. Pa u ndaluar këtu për të folur për të gjitha nënkuptimet e saj, ne mund të themi se shenjtërimi i plotë ka gjithashtu dy anë, një anë njerëzore dhe një hyjnore. Ana njerëzore e shenjtërisë është kushtimi, ose veçimi ynë për përdorim dhe zotërim hyjnor. Ky është kuptimi që termi kryesisht kishte në përdorimin e Dhjatës së Vjetër, ku njerëzit e zgjedhur duhet të shenjtërojnë veten (psh., Joz. 3:5), Tempullin (2 Kron. 29:5), ose ofrimet në altar (Eks. 29:27).

Në Dhjatën e Re ana njerëzore e shenjtërisë përshkruhet nga Pali si “përkushtim” ose “paraqitje” e vetes tek Perëndia (Rom. 6:13, 19; 12:1). Është interesante të vëmë re se kjo thuhet qartë se është diçka që vetëm një i krishterë mund ta bëjë, “ata që janë të gjallë prej së vdekurish” (Rom. 6:13), një që është një nga vëllezërit pjestarë të dhembshurisë së Perëndisë (Rom. 12:1).

### *1. Pendimi dhe përkushtimi në kontrast me njëri-tjetrin.*

Ka një ndryshim thelbësor ndërmjet përkushtimit dhe pendimit ose dorëzimit të jobesimtarëve. Mëkatari i pakthyer në besim mund t'i rrëfejë mëkatet e tij por vetëm një i krishterë mund të paraqesë një personalitet të shpenguar si një sakrificë e gjallë për Perëndinë. Pendimi i kthen sytë kryesisht për nga e shkuara. Kujdesja e tij është faji dhe ndëshkimi i mëkateve të së shkuarës. Qëllimi i tij është falja dhe jeta e re në Krishtin. Nga ana tjetër, përkushtimi shikon për nga e ardhmja. Kujdesja e tij është të ofrojë një ofertë, e frymëzuar nga mëshira që Perëndia tashmë ka dhënë, diçka që në fakt përbën një “shërbesë të mençur.” Qëllimi i saj është pastrimi i zemrës dhe plotësia e Frymës.

Kjo është një arsye e madhe pse shenjtërimi duhet gjithmonë të pasojë kthimin në besim ose rilindjen. Nuk është se Perëndia nuk mund të falë dhe të shenjtërojë plotësisht në një moment të vetëm, por sepse ne nuk mund të përmbushim kushtet për të dyja këto

aktivitete të hirit hyjnor në të njëjtin moment. Sepse, kuptohet, se askush nuk mund të vijë tek Perëndia si një rebel që i dorëzon Atij “armët e tij të rebelimit”, dhe në të njëjtën kohë, si një fëmijë që bën një përkushtim të plotë ndaj Atit Qiellor, që ai e do shumë. Nuk është e nevojshme të ketë ndonjë kohë të gjatë nga pendimi tek përkushtimi, por është psikologjikisht e pamundur që ato të ndodhin në të njëjtin moment.

## 2. Përkushtimi për jetë.

Le të themi gjithashtu se përkushtimi nënkupton jetën shpirtërore, dhe është për jetën dhe jo për vdekjen. Kjo thuhet në të dyja pasazhet për përkushtimin tek Romakëve 6 dhe 12. Ne duhet t'i kushtojmë veten tonë si “të gjallë prej së vdekurish” (6:13), dhe ta paraqesim “trupin” tonë si “fli të gjallë” (12:1). Në këtë të fundit në veçanti, kontrasti është me flijimet e vdekura të altarit të hebrenjve. Termi i Palit për “trupin” është një term me përdorim mjaft të gjerë, që në fakt përfaqëson krejt personalitetin. Siç e shprehu dhe autori i këngës, përkushtimi përfshin:

*Miqtë dhe koha dhe pasuritë tokësore  
Shpirt e trup, ty të takojnë  
Plotësisht ty, përgjithmonë*

## 3. Përkushtimi një akt i përcaktuar.

Është mirë të vëmë në dukje këtu se, ky përkushtim është gjithmonë i pëshkruar si një dhuratë e plotë një herë e përgjithmonë. Forma gramatikore e pëdorur është e njëjtë me atë që Jezusi përdori kur po fliste për martesën e një burri, i cili braktis nënën dhe babain e vet dhe “bashkohet” me gruan e tij (Marku 10:7). Përfshin një akt në një kohë të caktuar me të njëjtën dhënie të vetes plotësisht si në betimin martesor: “Në të mirë e në të keq, kur të jem i pasur e kur të jem i varfër, kur të jem mirë e kur të jem sëmurë... deri sa vdekja të na ndajë.” Kjo është arsyeja pse shërbesa e “ripërkushtimit” është po aq pa vend sa edhe “rimartesa” në familjet e zakonshme. Një



ripërkushtim është i domosdoshëm (ose i mundshëm) vetëm kur përkushtimi i parë është tërhequr.

#### *4. Përkushtimi dhe e panjohura*

Metafora jonë e martesës mund të na mësojë edhe më shumë të vërteta rreth dorëzimit të vetes sonë tek Perëndia. Ashtu si martesa përmban më shumë sesa dhëndri dhe nusja mund të parashikojnë, po kështu edhe përkushtimi përfshin “një tufë të panjohurash,” siç do mund ta shprehim. Përkushtimi është fillimi i një marrëdhënieje të re me Perëndinë, ndërlikimet e së cilës do të na duhet e gjithë jeta për t’i zgjidhur. Në këtë sens përkushtimi ka një aspekt progresiv të vetin. Ndërsa talente të reja zhvillohen, zotërime dhe marrëdhënie të reja vijnë, horizonte të reja në jetë hapen, këto që të gjitha duhet t’i nënshtrohen po atij përkushtimi madhështor të fillimit, me të cilin e dorëzuam veten tek Perëndia për herë të parë.

Edhe një herë, duhet të thuhet se përkushtimi nuk është ndaj shërbimit, ose ndaj shërbesës, ose ndaj misionit ndërkombëtar, ose vetë kishës, por ndaj Perëndisë. Pali i përshkruan besimtarët maqedonas me këto fjalë: “Por dhanë veten më përpara te Perëndia dhe pastaj te ne sipas vullnetit të Perëndisë” (2 Kor. 8:5). Ndonjë fushë e veçantë shërbimi, ndonjë pikësynim i dëshiruar fort, ndonjë marrëdhënie e lakmuar mund të jenë një problem kur besimtari bën përkushtimin e tij. Por dhurata është për vetë Perëndinë, për t’u përdorur prej Tij ashtu si e sheh Ai të përshtatshme.

#### *2. Përkushtimi dhe besimi.*

Ashtu si pendimi është dhe duhet të jetë i lidhur me besimin, po ashtu përkushtimi është dhe duhet të jetë i lidhur me besimin. Sepse ne nuk shenjtërohemi me anë të përkushtimit, por me anë të besimit (Vepr. 15:8-9; 26:18; Gal. 3:14). Në fund të vullnetit të dorëzuar duhet të vijë një hap për në errësirë, një kërcim për në premtimet e Perëndisë, “një konsiderim” se ne jemi “të vdekur për mëkatin, por të gjallë për Perëndinë, në Jezus Krishtin, Zotin tonë” (Rom. 6:11).

Disave ky hap u duket mjaft i vështirë. Ata mezi presin të shohin dhe të kuptojnë, të “ndjejnë” diçka që u tregon se puna u bë. Por Perëndia i ruan bekimet për kohën kur besimi i plotë dhe i vendosur, ndoshta me dëshpërim, e kap “premtimin e Atit.” Si do mund të ishte ndryshe? Nëse Perëndia do jepte së pari ndjenjën, kështu që besimi të mund të kishte ndonjë provë, atëherë besimi do të që në ndjenjën dhe jo në Perëndinë. Dhe kur ndjenja të ndryshonte, ashtu siç e kanë zakon njenjat, besimi do të shembej.

Nuk ka kurrë mjaft fjalë për ta theksuar sa duhet rëndësinë e kësaj. Përkushtimi nuk është i mjaftueshëm. Me mijëra besimtarë të ndershëm ia kushtojnë veten e tyre Perëndisë, disa prej tyre shumë herë, por kurrë s’e marrin vulën hyjnore në jetën e tyre sepse nuk e ndërmarrin këtë hap të rëndësishëm besimi. Dhe në fakt, një dhuratë nuk është dhuratë përderisa të merret. Deri sa dikush ta marrë mbetet një ofertë, por jo dhuratë. Kështu edhe përkushtimi e gjen vulën dhe substancën e vet në Zotërimin e Shpirtit të Perëndisë që na shenjtëron. Dhe plotësohet kur, në përgjigje të besimit të përshtatshëm, Perëndia e vulos pranimin nga ana e Tij.

## ANA HYJNORE E SHENJTËRIMIT.

Ana hyjnore e shenjtërimin është pastrimi, heqja e mëkateve ose bërja i shenjtë. Kjo nuk është diçka që ne mund ta bëjmë vetë për veten tonë; por që Fryma e Shenjtë e bën në ne. Dhe jo vetëm që ka një anë njerëzore dhe një hyjnore, si dhe kthimi në besim, por edhe një aspekt pozitiv dhe një negativ. Negativisht, është puna pastruese dhe shenjtëruese, që e pastron plotësisht natyrën e gjithë mëkatit dhe padrejtësisë të brendshme. Pozitivisht, është prezenca e Shpirtit të Perëndisë në plotësinë e vet.

### 1. *Pastrimi nga natyra mëkatore të brendshme*

Mëkati, prej të cilit na pastron shenjtërimi i plotë është përshkruar në mënyra të ndryshme në Dhjatën e Re. Është “mendje e kontrolluar

nga mishi” (Rom. 8:6-7), “ligji i mëkatit dhe i vdekjes” (Rom. 8:2), “njeriu i vjetër” dhe “trup i mëkatit” (Rom. 6:6), ose “rrënja e hidhur” (Heb. 12:15). Dhe këto s’kanë të bëjnë me ato që ne kemi bërë, por me dispozitat dhe tendencat tona me të cilat ne kemi lindur.

*a. Termat teologjike.* Teologët kanë disa terma të tjerë me anë të cilëve ata përshkruajnë këtë natyrë të mëkatit të brendshëm. Ata e quajnë atë mëkati origjinal ose mëkati nga lindja, që do të thotë se është lindur me natyrën njerëzore, “mëkati në racën,” siç e quante C. W. Ruth. E quajnë atë shthurje ose prishja morale, e cila ka të bëjë me tendencat që shtyjnë në mëkatin aktual. Ata e përshkruajnë atë si “armiçësi” kundër vullnetit të Perëndisë, e që nuk i nënshtrohet ligjit të Tij (Rom. 8:7), që thotë “Jo” kur Perëndia thotë “Po,” dhe thotë “Po” kur Perëndia thotë “Jo.” Si një mama që ishte duke disiplinuar djalin e saj të vogël dhe e çoi jashtë në kuzhinë, e uli në një karrige, e urdhëroi ashpër të mos lëviste deri sa ajo t’i thoshte se mund të ikte. Pak më vonë, teksa ishte duke bërë ca punë në një dhomë tjetër, ajo thirri: “Gjoni, a je akoma i ulur atje?” Ai u përgjigj: “Po, mami. Jam i ulur jashtë... por në këmbë këtu brenda!”

*b. Çlirim i plotë.* Është e tepërt të themi këtu se asnjë nuk mund ta dojë Zotin Perëndi me gjithë zemrën, shpirtin, mendjen dhe forcën e vet, ose t’i japë Atij shërbim plotësisht të pranueshëm, për aq kohë sa kjo kundërshti të ekzistojë përbrenda. “Pengimi”ose “kundërveprimi” janë pak a shumë si një njeri që mund ta kapë një hajdut duke plaçkitur shtëpinë e tij, e fut atë në dollap, dhe ulet përpara derës me pushkën në prehër për ta patur në kontroll hajdutin. Një rrugë tepër më e mirë për t’u marrë me një situatë të tillë është të thërrasësh policinë dhe t’ia dorëzosh atij hajdutin. Metoda e Perëndisë quhet “kryqëzim” dhe “anullim” (Rom. 6:6), gjë që do të thotë të shkatërrosh plotësisht këtë natyrë mëkatore.

Le të mos e vrasë asnjëri mendjen rreth problemit artificial sesi natyra e mëkatit mund të kthehet në zemër nëse besimtari i shenjtëruar tërhiqet. Kjo do që njëlloj sikur të diskutonim sesi kthehet errësira kur drita shuhet, si vjen varfëria kur pasuritë shpërdorohen, ose si

rishfaqet sëmundja kur shëndeti na lë. Ne e dimë se errësia është e pranishme kur drita shuhet, varfëria egziston atje pasi pasuritë shpërdorohen, dhe sëmundja është atje ku humbet shëndeti. Errësira, varfëria, dhe sëmundja janë reale dhe përfshijnë padyshim të këqija. Por se janë në fakt realitete që vijnë si rezultat i një nevoje të paplotësuar. “Privim” dhe “prishje” janë terma të lidhur ngushtë me njeri tjetrin.

## 2. Pajisja hyjnore.

Ne tashmë kemi folur diçka për anën pozitive të veprës shenjtëruese të Perëndisë. Është vënia në fron përbrenda e Frymës së Shenjtë në sundimin e Tij të shenjtërimit. Kjo është një pajisje pozitive me fuqinë për të jetuar një jetë të shenjtë dhe shërbesë efektive. Nuk ka të bëjë aq shumë me diçka “madhështore” apo “ të mrekullueshme”, sesa ka të bëjë me shkëlqimin e qetë dhe depërtues të personalitetit, që është joshës dhe tërheqës. Është fuqi që *tërheq* më shume se *shtyn*. “Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut”(Veprat 1:8).

## DISA ÇËSHTJE PRAKTIKE

Tani le t'i kthehemi tre çështjeve praktike në lidhje me shenjtërinë.

### 1. Nuk na çnjerëzon

Së pari, ne duhet të kujtojmë gjithmonë se, ndërkohë që shenjtërimi i plotë si akti i Perëndisë në zemrën tonë ndryshon natyrën tonë të mishit, nuk na çnjerëzon ne. Tendenca dhe dispozitat e mishit janë mëkatore në vetvete, dhe ato nuk mund kurrë t'i nënshtrohen Ligjit të Perëndisë (Rom. 8:7). Impulse dhe qëndrime të tilla përfshijnë zilinë, xhelozinë, lakminë, zemërimin egoist, fyerjen, armiqësinë, thashethemet, shpirtligësinë, krenarinë, cinizmin,

hidhërimin dhe dëshirën për diçka që është për nga natyra e ligë. Nga gjëra të tilla ne duhet të pastrohemi.

Sidoqoftë, ka në ne shumë shtysa, dëshira, nxitje të cilat janë krejt njerëzore, dhe thelbësore për jetën dhe mbarëvajtjen në këtë tokë. Për shembull instiktet madhore të vetë-mbrojtjes, seksit, nxitjes për të pasur diçka, kuriozitetit, ambicjes (e cila mund të jetë e shenjtë ose mëkatore) – të gjitha këto mund të gjejnë shprehjen e tyre në mënyra që janë në pajtim me ligjin e Perëndisë.

Por meqë këto shtysa apo nevoja mund të shprien në mëkat, i shenjtëruari mund të bjerë. Mishi i mëkatshëm duhet çrrënjësuar; natyra njerëzore brenda nesh duhet të nënshtrohet dhe të drejtohet. Pali vetë tha: “Madje e mundoj trupin tim dhe e nënshtroj, se mos, pasi t’u kem predikuar të tjerëve, të bëhem për t’u përjashtuar”(1 Kor. 9:27).

## 2. *Nuk ka standard të dyfishtë*

Së dyti Perëndia nuk ka një standard të dyfishtë. Shumë të rinj kanë idenë se ka një standard të ulët për të shfajësuarit dhe një standard të lartë për të shenjtëruarit plotësisht. Ne dëgjojmë ndonjëherë: “unë mund t’ia plotësoj dëshirat vetes time në këto praktika të diskutueshme sepse siç e sheh unë nuk kam thënë ndonjëherë se jam i shenjtëruar plotësisht.”

Ky është një mjet i djallit për ta dënuar shpirtin njerëzor. Lavdia e shenjtërisë është se e bën të mundshme që të krishterët të jetojnë ashtu si Fjala e Perëndisë ua kërkon të gjithë njerëzve të jetojnë. Asnjë fëmijë i Perëndisë nuk mund ta përfshijë veten, pa u dënuar, në asnjë gjë për të cilën ai e di se një i shenjtëruar nuk do ta bënte.

## 3. *Rritje e pakufizuar.*

Së treti, shenjtërimi i plotë nuk është fundi, është vetëm fillimi. Nuk është një terminal; është një pikë fillimi. Kjo është çfarë Pali sugjeroi kur ai përshkroi zbritjen e Frymës në të në Ditën e Rrëshajëve

si “fillimi” (Vep. 11:15). Treguesi më i vërtetë se dikush nuk e ka kuptuar kuptimin e vërtetë të shenjtërisë së krishterë është qëndrimi se “kam arritur,” të qënit i vetëkënaqur dhe i vetëpranuar.

Përkundrazi, shenjtërimi është vetëm fillimi i një rritjeje që do të zgjasë për gjithë jetën “në hirin dhe në njohjen e Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë Jezus Krisht” (2 Pj. 3:18). Është e vërtetë se puna shenjtëruese e Perëndisë është e plotë në një moment të kohës, por e jona jo. Sepse ana njerëzore e shenjtërimit nuk do të thotë vetëm kushtim i vetes para pastrimit, por edhe ngarkim pas tij. “Tani përfundojeni edhe bërjen që, ashtu si që dëshira për të dëshiruar, kështu të jetë edhe për ta përfunduar sipas mundësive që keni” (2 Kor. 8:11).

*Ne besojmë se shenjtërimi i plotë është ai akt i Perëndisë, që vjen pas ripërtëritjes, me anë të të cilit besimtarët çlirohen nga mëkati origjinal ose shturja, sillen në një gjendje përkushtimi total ndaj Perëndisë, me bindje të shenjtë dhe në dashuri të përsosur.*

*Ai realizohet me anë të pagëzimit me Shpirtin e Shenjtë, dhe përfshin, në një përvojë, pastrimin e zemrës nga mëkati, si dhe praninë e vazhdueshme përbrenda të Shpirtit të Shenjtë, duke e fuqizuar besimtarin për të jetuar dhe shërbyer.*

*Shenjtërimi i plotë sigurohet nga gjaku i Jezusit, ndodh në një moment me anë të besimit, paraprihet nga përkushtimi i plotë; dhe Shpirti i Shenjtë jep dëshmi për këtë punë dhe gjendje hiri.*

*Kjo përvojë njihet gjithashtu me emra të ndryshëm që përfaqësojnë fazat e ndryshme të saj, emra të tillë si “përsosmëria e krishterë,” “dashuria e përsosur,” “pastërtia e zemrës,” “pagëzimi me Shpirtin e Shenjtë,” “plotësia e bekimit,” dhe “shenjtëria e krishterë.”*

*Ne besojmë se ka një dallim të qartë midis një zemre të pastër dhe një karakteri të pjekur. E para merret në një çast, si rezultat i shenjtërimit të plotë; e fundit është rezultat i rritjes në hir.*

*Ne besojmë se hiri i shenjtërimin të plotë përfshin shtysën për t'u rritur në hir. Megjithatë, kjo shtysë duhet të ushqehet me ndërgjegje dhe vëmendje të kujdesshme ndaj kërkesave dhe proceseve të zhvillimit shpirtëror dhe përmirësimit në karakter dhe personalitet, të ngjashëm me Krishtin. Pa një orvatje të tillë të qëllimtë, dëshmia e dikujt mund të dëmtohet dhe vetë hiri mund të pengohet dhe përfundimisht të humbasë.<sup>11</sup>*

### Për diskutim të mëtejshëm

1. Cili është përkufizimi i përgjithshëm i shenjtërimin? Si përkufizohet ai në fjalor?
2. Cilat janë disa nga mënyrat se si përshkruhet shenjtërimi i plotë në Dhjatën e Re?
3. Përshkruaj në ç'mënyra autorë të ndryshëm të Dhjatës së Re flasin për nevojën dhe mundësinë për shenjtërim të plotë.
4. Cila është ana njerëzore e shenjtërisë? Në ç'mënyra janë pendimi dhe kushtimi të ndryshme?
5. Si lidhet kushtimi me të ardhmen e panjohur?
6. Çfarë përfshihet në anën hyjnore të shenjtërimin?
7. Çfarë është që bën të mundur që një person i shenjtëruar të bjerë në mëkat?
8. A ka Perëndia një standard të dyfishtë për sjelljen, një për të kthyerit në besim dhe një tjetër për të shenjtëruarit?

<sup>11</sup> *Ibid*, Neni X.

## VI

### BESIMET RRETH KISHËS DHE TË ARDHMES

Deri ne këtë pikë ne e kemi konsideruar besimin e krishterë sikur ai të ishte plotësisht një çështje individuale apo personale. Kjo është vetëm një pjesë e të vërtetës. Mund të ndodhë që ne të *vijmë tek* Perëndia një nga një, në një takim thellësisht personal. Është njësoj e vërtetë që ne shkojmë *me Perëndinë* së bashku me të tjerët të cilët kanë ardhur tek Ai, në bashkësinë e Frymës së Tij e cila është Kisha.

Një nga veprat e para të sherbesës së Zotit tonë ishte të zgjidhte një grup të vogël prej dymbëdhjetë dishepujsh që të ishin me të, të cilët Ai i quajti apostuj (Luka 6:13). Në përgjigje të rrëfimit të frymëzuar të Pjetrit, “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë,” Ai dha premtimin: “Mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin atë”(Mat. 16:16, 18). Urdhërimi i Tij i madh për ndjekësit e Tij ishte, “Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen”(Mat.28:19-20).

#### KISHA DHE KISHAT

Kushdo që lexon mësimet e Dhjatës së Re në lidhje me kishën i bën përshtypje fakti që termi është përdorur në dy mënyra. Ai është përdorur në një kuptim shumë të përgjithshëm për të përfshirë të gjithë ata që adhurojnë Krishtin në Frymën, dhe është përdorur në një mënyrë shumë specifike për të përshkruar një grup të caktuar të krishterësh. Për shembull, në kuptimin e parë, “edhe Krishti e ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të, që ta shenjtërojë, pasi e pastroi me larjen e ujit me anë të fjalës” (Ef. 5:25-26); dhe në të dytin “por Diotrefi... i përjashton nga kisha”(3 Gjo.9-10).



### *1. Kisha universale*

Kisha universale është numri i plotë i atyre që janë kthyer nga mëkati dhe kanë pranuar hirin e Perëndisë në të vërtetën. Ajo është “Kisha e shenjtë universale” e Kredos së apostujve. Ajo ekziston në çdo epokë dhe në çdo vend e komb mes njerëzve. Lista e anëtarëve të saj është libri i jetës i qengjit (Zbu. 21:27). Ajo është trupi i Krishtit ( Rom. 12:5), nusja e Qengjit (Zbu. 21:9), tempulli i Perëndisë së gjallë (2 Kor. 6:16), një ushtri me flamuj të shpalosur (KiK. 6:4) dhe triumfuese (Zbu. 19:14). Ajo nuk është një organizatë, por një organizëm, një bashkësi e Frymës.

### *2. Kishat e veçanta*

Nga ana tjetër, kishat e veçanta janë të përbëra nga individë besimtarë të cilët kanë një besim të përbashkët dhe kryejnë një program të përbashkët. Kishat e veçanta, duke qënë njerëzore dhe të përbëra nga qenie njerëzore të gabueshëm, janë organizata njerëzish që përpiqen së bashku të jetojnë jetën e Frymës në një botë që është herë armiqësore dhe herë indiferente, ku çdo kishë lokale është një bashkësi e Frymës. Kishat kanë kredot, modelet e adhurimit, metoda të dallueshme të shërbesës së krishterë, disiplina anëtarësimi, dhe të gjitha së bashku formojnë kishën e dukshme mbi tokë.

### *3. Mjetet e Hirit*

Kishat e veçanta sigurojnë për anëtarët e tyre “mjetet e hirit” si adhurimin publik, predikimin e ungjillit, dhe mundësitë për bashkësi në shërbim. Ato janë gjithashtu kujdestare të sakramenteve, nga të cilat protestantët në përgjithësi pranojnë dy: pagëzimin dhe darkën e Zotit.

Akoma dhe më shumë duhet thënë rreth kishës, qëllimit dhe programit të saj në këtë epokë. Për shkak të interesit të madh aktual, më poshtë është zgjedhur për më shumë shqyrtim të zgjeruar, një nga aspektet më praktike të besimit dhe të praktikave të përbashkëta.

## KISHA DHE SHËRIMI HYJNOR

Sa herë që kisha anashkalon ndonjë pjesë nga e vërteta, që Perëndia ka dhënë në Fjalën e Tij, do të ketë gjithmonë nga ata që e kapin këtë pjesë dhe e bëjnë më thelbësore se sa duhet të jetë. Kjo është një mënyrë tjetër e të thënurit që mbrapa çdo kulturi apo herezie në Krishtërim ndodhet një e vërtetë e harruar, e cila është pjesë e trashëgimisë së plotë të besimit të krishterë.

Kjo është ajo çfarë ka ndodhur në çështjen e shërimit hyjnor. Për shkak se e kemi anashkaluar plotësinë e shpengimit të Perëndisë për njerëzimin, ne ua kemi dorëzuar mashtruesve dhe kultistëve diçka të çmuar që Krishti bleu për ne në kryq - shërimin e trupit, si dhe pastrimin e shpirtit.

### *1. Mësimi i Biblës*

Për të parë që kjo është e vërtetë, na duhet thjesht të kujtojmë disa nga premtimet e Fjalës së Perëndisë, si dhe zakonet e Zotit tonë dhe të kishës së hershme. Për shembull: “Beko, shpirti im, Zotin dhe mos harro asnjë nga të mirat që ka bërë. Ai fal të gjitha paudhësitë e tua dhe shëron të gjitha sëmundjet e tua” (Ps.103:2-3); “Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar”(Isa. 53:5).

Ose përsëri: “Jezusi shkante kudo nëpër Galile, duke mësuar në sinagogat e tyre, duke predikuar ungjillin e mbretërisë dhe duke shëruar çdo sëmundje dhe lëngatë në popull” (Mat.4:23); “Edhe një turmë nga qytetet përreth turrej në Jeruzalem, duke sjellë të sëmurët dhe ata që mundoheshin nga frymëra të ndyra dhe të gjithë shëroheshin” (Vep. 5:16)

Ose nga Letrat: “Dikujt pra i jepet me anë të Frymës, fjalë diturie . . . një tjetri dhuntitë e shërimeve nëpërmjet po atij Fryme”(1 Kor. 12:8-9); “A është i sëmurë ndonjë nga ju? Le të thërrasë pleqtë e kishës dhe ata të luten përmbi të, dhe le ta lyejnë me vaj në emër të

Zotit, dhe lutja e besimit do ta shpëtojë të sëmurin dhe Zoti do ta mëkëmbë” (Jak. 5:14-15).

Këto vargje mund të shumfishohen shumë herë, por është dhënë mjaft për të treguar që Bibla na mëson se Fuqia e Perëndisë në jetën njerëzore nuk është e kufizuar në shpirtëroren, me gjithë rëndësinë që asaj i jepet.

Në të vërtetë, nuk ka mrekulli më të madhe sesa shërimi i shpirtit, çlirimi i tij nga sëmundja kanceroze e mëkatit. Shërimi fizik në më të mirën e tij është vetëm për një periudhë të shkurtër kohe. Shpejt apo vonë fiziku dobësohet dhe vdekja vjen tek çdo qenie njerëzore. Doktorit i mjekësisë përfundimisht humbet çdo pacient që ai mjekon. Por shërimi i shpirtit është një punë që është e përjetshme, me potencial shëndet-dhënës dhe jetë-dhënës që nuk mbaron kurrë.

## 2. Shërimi prej besimit dhe shërimi hyjnor

Sigurisht ne duhet të kuptojmë që jo të gjitha shërimet pa mjekim janë shërime *hyjnore*. Ka një lloj shërimi prej besimit i cili është mëse real, por që në të nuk ka asgjë prej Perëndisë. Pratikantët e kulteve shëruese marrin rezultate; nuk ka dyshim për këtë. Por sektet të cilat mohojnë hyjninë e Krishtit dhe fuqinë e gjakut të Tij për të shpëtuar nga mëkati nuk janë nga Perëndia.

Shërimi prej besimit funksionon sepse ka një lidhje më të afërt midis mendjes dhe trupit sesa pranohet shpesh. Sot, mjekët dhe psikiatrit po na tregojnë se shumë prej sëmundjeve të cilat mendojnë trupin njerëzor janë “psikogjenetike” - domethënë se, ato janë të shkaktuara nga mendja, dhe shpesh mund të kurohen nga mendja. Që ulçera në stomak, mund të shkaktohet nga shqetësimi dhe tensioni është e mirënjohur tashmë, dhe kur shkaku largohet sëmundja shumë herë shërohet me një shpejtësi të çuditshme. Dhe ka shumë raste të regjistruara të paralizës fizike aktuale e cila është plotësisht mendore në burim, dhe që mund të kurohet mendërisht.

Ne duhet të pranojmë se ka shumë në këtë fushë që nuk kuptojmë. Për çdo gjë që shkenca mjekësore mund të zbulojë, rreth mënyrave sesi trupat tanë janë “krijuar në mënyrë të mahnitshme dhe të

mrekullueshme,” ne mund të falenderojmë Perëndinë. Por nuk duhet të biem në grackën e të besuarit se shërimi pa mjekim është patjetër “hyjnor”. Shumë prej tyre janë plotësisht natyrore.

Përsëri, ne duhet të kuptojmë se në njëfarë kuptimi i gjithë shërimi është hyjnor. Nëse kjo tingëllon sikur po marrim mbrapsht nga dritarja atë që hodhëm jashtë nga dera, më lejoni t’ju shpjegoj. Fuqitë e vetëmbrojtjes të cilat janë një pjesë kaq e mrekullueshme e trupave njerëzorë janë fuqi të dhëna nga Perëndia. Shumë njerëz të mjekësisë janë të gatshme të pranojnë që “Natyra” bën atë çfarë ata nuk mund ta bëjnë, dhe se puna e tyre është të bëjnë të mundshëm aktivizimin e veprimit restaurues të vet trupit. Por “Natyra” është vetëm një emër që fsheh prapa tij Perëndinë. Çfarëdo që “Natyra” bën e ka burimin e vet tek Perëndia.

Megjithatë, përtej shërimit nëpërmjet “besimit” apo sugjerimit mendor dhe shërimit nëpërmjet “Natyres,” ka shërime të mrekullueshme, të cilat janë rezultate të ndërhyrjes së drejtëpërdrejtë të fuqisë së Perëndisë, në përgjigje të lutjes së besimit nga ana e popullit të Tij. Kjo është ajo çfarë ne kuptojmë me të vërtetë me termin “shërim hyjnor”.

### 3. *Shërimi si “i kushtëzuar”*

A shëron Perëndia çdonjërin që i kërkon të shërohet? Për këtë, përgjigja ka qënë gjithmonë, “Jo.” Apostulli Pal kishte shumë dhunti shërimi, por ai shkruan, “Trofimin e lashë të sëmurë në Milet.” (2 Tim. 4:20). Kjo ndodh për shkak se shërimi është “i kushtëzuar” - ashtu si thonë teologët - dhe jo i “pakushtëzuar” siç është shpëtimi. Pra çdokush që lutet për shpëtim me besim dhe pendim do të shpëtohet, sepse Perëndia në mënyrë të pakushtëzuar mundëson shpëtimin e të gjithëve që besojnë në Birin e Tij, Jezus Krishtin.

Por shërimi është “i kushtëzuar” sipas vullnetit të caktuar të Perëndisë, dhe besimi për shërim është një dhunti e veçantë. Le të vërehet se Bibla kurrë nuk flet për “dhuntinë e shërimit” por gjithmonë për “dhuntitë e shërimit.” Shërimi nuk është një çështje e dhënies së ndonjë fuqie të përgjithësuar tek disa “predikues

shpëtimtarë,” për t’u përdorur në të njëjtën mënyrë mbi ata që vijnë në takimet e tij të “ringjalljes shëruese.” Shkrimet në vend të kësaj flasin për “dhuntitë shëruese” të veçanta të cilat janë dhënë në përputhje me vullnetin personal të Perëndisë në çdo rast individual.

#### 4. Sëmundja dhe mëkati.

A tregon sëmundja se personi i sëmurë ka qënë fajtor për mëkat apo i pakujdesshmëm në jetesën e krishterë? Përsëri, përgjigja është “Jo”, dhe kësaj pyetje duhet t’i përgjigjet gjithë kohës historia e Jobit në Dhjatën e Vjetër. Nëse sëmundja kuptonte mëkat, atëherë shenjtorët nuk do të vdisnin kurrë fizikisht, por Perëndia ka caktuar për secilin nga ne të vdesim një herë. (Heb. 9:27)

E megjithatë lavdia e ungjillit është se sëmundja, dobësia dhe vdekja nuk kanë fjalën e fundit me njërëzit e Perëndisë. Jo vetëm që shpirtërat tanë janë të shfajësuar dhe të shenjtëruar, por trupat tanë janë destinuar të përlëvdohen - të ringjallen në ngjashmëri me trupin e Tij të përlëvduar. “Por ende nuk është shfaqur ç’do të jemi; por dimë se, kur të shfaqet ai, do të jemi të ngjashëm me të, sepse do ta shohim se si është ai” (1 Gjon. 3: 2).

Përfundimisht, e gjithë vepra shëruese e Perëndisë në trupat njerëzore ka një synim moral në vetvete. Sa shpesh u tha Jezusi atyre që Ai shëronte, “Mos mëkato më që të mos të të bëhet një gjë më e keqe” (Gjon. 5:14); ose “Bir, mëkatet e tua të janë falur” (Mark 2:5)! Kur Perëndia vepron me fuqi shëruese në favorin tonë, Ai e bën atë që ne të mund të marrim shërim dhe forcë që “të mund të shërbejmë pa frikë në shenjtëri e në drejtësi përpara tij, të gjitha ditët e jetës sonë” (Lu. 1:74-75).

## ESKATOLOGJI: E ARDHMJA

Dy çështje të tjera kërkojnë vëmendjen tonë në studimin tonë të shkurtër *Besimet që kanë më shumë rëndësi*. Këto kanë të bëjnë me fundin e epokës, të ardhmen. E para është ardhja e dytë e Krishtit. Tjetra është gjendja e përjetshme. Këto çështje i përkasin asaj që quhet eskatologji, një term që do të thotë doktrinë e gjërave të fundit.

## 1. Ardhja e Zotit

Kur Zoti Jezus Krisht i la dishepujt e tij për t'u rikthyer në qiell, Ai bëri dy premtime të mëdha. Njëri prej tyre kishte të bënte me ardhjen e Frymës së Shenjtë si Shenjtëruesi i Kishës: “Megjithatë unë ju them të vërtetën: është mirë për ju që unë të shkoj, sepse, po nuk shkova, nuk do të vijë tek ju Ngushëlluesi, por, po shkova, unë do t’jua dërgoj” (Gjo. 16:7)

Premtimi i dytë kishte të bënte me ardhjen e Atij vetë sërish: “Dhe kur të shkoj e t’ju përgatis vendin, do të kthehem dhe do t’ju marr pranë meje që aty ku jam unë, të jeni edhe ju” (Gjo. 14:3). Ky premtim i veçantë i Jezusit u përsërit me më shumë detaje nga ëngjëjt në Ngritjen e Tij në qiell: “Burra Galileas, pse qëndroni e shikoni drejt qiellit? Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell” (Vep. 1:11).

Një nga temat më të përmendura në Dhjatën e Re është siguria e këtij premtimi: Jezus Krishti, i cili u morr tutje nga kjo tokë mbi 2000 vjet më parë, është duke ardhur sërish për të marrë të vetët tek vetja e tij, dhe për të sjellë ditën e përjetshme të Perëndisë. Kjo është shpresa e bekuar e besimtarëve.

Ka dy pika të cilat duhet të sqarohen nëse duam të kuptojmë mësimet e Biblës rreth ardhjes së dytë të Jezusit.

*a. Koha e panjohur.* Së pari, asnjë njeri nuk e di as ditën as orën kur Krishti do të vijë (Mat.24:36), dhe çdonjëri që vendos një datë është me siguri gabim. Mjafton vetëm të përmendim gabimin e Adventistëve në 1844 dhe “zhgënjimin e madh” që vijoi pas tij. Megjithatë, ndërsa asnjë nuk mund të zgjedhë një datë për rikthimin e Zotit, Shkrimet gjithashtu në mënyrë të qartë mësojnë se njerëzit e Perëndisë nuk kanë pse të befasohen si nga ardhja e një vjedhësi natën, por mund të jetojnë në gatishmëri për ardhjen e Krishtit. (1 Thes.5:4). Megjithëse janë bërë shumë pretendime fantastike, akoma “shenjat e kohës” (Mat. 16:3) janë ato të cilat njeriu mendjehollë i sheh. Tek kjo do të kthehem më vonë.

Është, patjetër, urtësia hyjnore ajo e cila ia ka fshehur njohurisë njerëzore kohën e saktë të rikthimit të Krishtit. Sikur të ishte ditur

data, atëherë shumë njerëz do të prisnin deri vetëm një ditë më parë që të kujdeseshin për punët e papërfunduara me Perëndinë. Natyra njerëzore, trishtueshëm, priret të jetë e tillë. Dita e fundit për pagesën e taksave është akoma dita më e zënë e vitit!

*b. Një ngjarje e dyfishitë* Pika e dytë që duhet shqyrtuar nëse duam të kuptojmë mësimet e Biblës rreth ardhjes së dytë të Krishtit është se e njëjta ngjarje, “dita e Zotit,” do të thotë gjëra të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Në mënyrë më të veçantë, ajo ditë do të jetë shpresa e bekuar për Kishën dhe ditë trishtimi për të papërgatiturit.

Për shembull, Isaia jep pyetjen shqetësuese, të përsëritur dy herë, “Roje, në ç’ pikë ka arritur nata? Roje në ç’ pikë ka arritur nata?” Dhe përgjigja, plot me nënkuptim simbolik është: “Vjen mëngjesi, gjithashtu dhe nata. Në rast se doni të pyesni, pyesni, pra; kthehuni, ejani” (Is. 21:11-12). E fshehur në këtë pyetje dhe në përgjigjen e vet të thjeshtë dhe deri diku të qartë, është çelësi për të hapur një pjesë të mirë të misterit në lidhje me ditën e Zotit. Sepse i njëjti rrotullim i tokës që i sjell agimin e një dite të re njerës gjysmë të globit, i sjell errësirën gjysmës tjetër.

Ardhja e Zotit është agimi i ditës së përjetshme për njerëzit e Perëndisë. Është muzgu i natës së përjetshme të botës jobesimtare. Kur Krishti të kthehet, “mëngjesi vjen” për njerëzit e Tij; “dhe gjithashtu nata” për të papenduarit dhe ata që nuk janë gati. Kështu që nuk ka kontradikta ndërmjet vargjeve që flasin për ditën e Zotit, që vjen si një vjedhës, dhe atyre që thonë se nuk do të na zërë në befasi si një vjedhës. Nuk ka mospajtim ndërmjet referencave të asaj dite si një kohë katastrofe dhe gjykimi dhe atyre që flasin për të si një kohë e lavdishme e shfajësimit të popullit të Perëndisë.

*c. Finalizimi i ardhjes së Tij.* Në këtë pikë duhet të marrim shumë seriozisht të vërtetën që Jezusi shprehu në shëmbëlltyrën e dhjetë virgjëreshave tek Mat. 25:1-13. Kjo është historia e dhjetë vajzave që ishin zgjedhur shoqëruese të nuses në një dasëm të madhe. Secilës prej tyre iu dha një llampë (ose pishtar) dhe iu thanë t’i dilnin para dhëndrit kur të vinte. Por gjysma e tyre nuk morrën vaj për llampat e tyre.

Kur mesnata erdhi, u dëgjua një britmë se dhëndri po vinte dhe të gjitha ato duhet t'i dilnin para. Atëherë, “virgjëreshat që ishin gati, hynë bashkë me të në dasmë; dhe dera u mbyll” (v. 10). Vajzat që s'ishin gati u lanë jashtë, dhe kur ato trokitën për t'u lejuar dhe ato të hynin, dëgjuan zërin e dhëndrit: “Në të vërtetë po ju them se nuk ju njoh”(v. 12).

Asnjë zemër e re le të mos mashtrohet nga mbrojtësit e teorisë së “fesë që mëkaton” se paska një shans të dytë për t'u shpëtuar, pasi Krishti të ketë ardhur. Ky është një iluzion dhe një kurth. Kur dhëndri të vijë, dera do të mbyllet, përfundimisht dhe përjetësisht.

*d. Shenjat e kohëve.* Një nga zhvillimet befasuese të dy dekadave të fundit ka qënë rritja e gjerë e një sensi të një kulm të afërt në çështjet njerëzore. Ndërkohë që Kisha e ka neglizhuar paralajmërimin e vet se kjo epokë larg Perëndisë është nën gjykim, njerëzit në pushtet, edukatorë e mësues, gazetarë dhe drejtues ushtarakë ia kanë nisur refrenit të tyre të ashpër.

Gjenerali i ndjerë Douglas MacArthur (*Dëgllas MëkArthur*) tha: “Ne kemi pasur shansin e fundit. Nëse nuk shpikim ndonjë sistem tjetër të ndryshëm nga lufta, mbarimi i botës është tek dera.”

Robert Gordon Sproul (*Robert Gordën Sprall*), atëherë president i Universitetit të Kalifornisë, deklaroi: “Me bombën atomike ne kemi gjetur tashmë një rrugë për të vdekur së bashku, ndoshta deri tek njeriu i fundit. Por asnjë shkencëtar akoma nuk ka zbuluar një formulë e cila do të na mësojë neve sesi të jetojmë së bashku. Për këtë duhet të mendojmë në gjithë botën përreth. Nuk ka më shumë kohë.”

Kryeministri i ndjerë Uinston Çurçill (*Winston Churchill*) paralajmëroi, “Nëse lufta vjen përsëri, shtetet ndërluftuese jo vetëm do të shkatërrojnë gjithçka që ne quajmë civilizim, por mundësisht do të copëtojnë edhe vetë globin. “Ajo çfarë Z. Çurçill është duke folur, sigurisht, është fakti që njeriu nuk qesh më me shpalljen tek 2 Pje. 3:10 që në ditën e Zotit elementët do të shkrihen me nxehtësi të lartë dhe vetë toka do të digjet. Kjo është bërë e mundur vetëm me zbulimin e bombave atomike dhe atyre me hidrogjen. Kur një



shkencëtar i ri, i cili kishte punuar mbi projektin e bombës atomike, u pyet rreth nivelit të tij universitar, ai u përgjigj, “Unë jam një doktor i eskatalogjisë.” Ndoshta ai nuk po bënte shaka. Mund të jetë më vonë nga sa ne e mendojmë.

*e. “Jini pra gati.”* Qëllimi i mësimëve biblike rreth rikthimit të Zotit nuk është që të na frikësojë neve apo të kufizojë planifikimin tonë për punët e Perëndisë në të ardhmen. Ne jemi urdhëruar nga Zoti të “tregtoni derisa të kthehem” (Lu. 19:13). Për ta bërë këtë mirë, ne duhet të bëjmë plane afatgjata: për shkollim, për familje, dhe për të ardhmen. Por çështja është se ne akoma më shumë duhet të mbajmë zemrat në gatishmëri për ardhjen e Tij sërish. Asnjëherë Bibla nuk na urdhëron, “Bëhuni gati.” Gjithmonë në fakt thotë: “Jini gati, sepse ju nuk e dini ditën as orën.” Mos jetofshim jashtë shpresës së bekuar të krishterë. “Dhe kushdo që e ka këtë shpresë në të, le ta pastrojë veten, siç është i pastër ai.” (1 Gjo. 3:3)

## 2. Gjendja e përjetshme

Është një histori e shkurtër që shpesh është treguar dhe që s’duhet lënë pa u treguar edhe këtu. Ajo ka lidhje me një burrë të ri që po i tregonte shokut të tij më të vjetër rreth ambicjeve të tij për jetën.

“Pas universitetit, unë do të studioj në fakultetin juridik,” tha ai.

“Dhe pastaj?” iu përgjigj shoku i tij.

“Dhe pastaj, do të futem në një zyrë ligjore dhe do të ushtroj profesionin tim.”

“Dhe pastaj?”

“Pastaj unë do të marr pjesë rregullisht në garë me kuaj, dhe do të gëzoj jetën.”

“Dhe pastaj?”

“Oh, pastaj, pasi të bëhem plak unë mendoj do të dal në pension.”

“Dhe pastaj?”

Me më pak siguri në vetvete, “Dhe pastaj, përfundimisht unë do të vdes.”

Akoma pyetja e përsëritur, “Dhe pastaj?”

Nuk kishte asnjë përgjigje.

Por është një pyetje e rëndësishme, dhe kërkon një përgjigje.

Në qoftë se marrim si të vërtetë besimin universal të racës njerëzore se kjo jetë nuk është e gjitha, dhe mësimin e qartë të Biblës që “është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjyqi” (Heb. 9:27), atëherë pyetja zhbiruese, “Dhe pastaj?” nuk mund të anashkalohet.

*a. Shpresa e përjetshme.* Një nga faktet më të rëndësishme rreth besimit të krishterë është dimensionin e tij të përjetshëm. Ai shkon përtej kufive të ngushtë të një jete të vetme njerëzore dhe ka gjëra të rëndësishme për t’u thënë rreth asaj se çfarë do ta ndjekë këtë jetë. Disa herë ne dëgjojmë të krishterët të thonë, “Nëse nuk do të kishte qiell apo ferr, ende do të ishte më e mira të jetoje jetën e krishterë.” Kjo është padyshim e vërtetë. Ka qat më shumë në hirin shpëtues dhe shenjtëruar të Zotit Jezus Krisht sesa thjesht një shkallë shpëtimi nga zjarri.

Por apostulli Pal nuk pranoi plotësisht këtë këndvështrim. Ai tha, “Në qoftë se shpresojmë në Krishtin vetëm në këtë jetë, ne jemi më të mjerët e të gjithë njerëzve” (1 Kor. 15:19). Shpresa jonë në Krishtin, aq sa është e mrekullueshme në këtë jetë, është akoma më e lavdishme kur shikohet në dritën e plotë të përjetësisë.

Tani me kuriozitet mund të të pyesin shumë gjëra rreth jetës mbas vdekjes për të cilën Bibla nuk përgjigjet. Pyetjet themelore kanë përgjigje me siguritë të plotë. Detajet e rastësishme janë të fshehura nga pamja.

*b. Fat i përjetshëm për të gjithë.* Ndërmjet sigurive themelore për jetën pas vdekjes në Fjalën e Perëndisë është siguria që të gjitha qëniet njerëzore janë të paracaktuara për përjetësinë nga vetë fakti që ato janë krijuar në imazhin e Perëndisë. Është bërë popullorë në ditët e sotme të mësohet se vetëm të shpëtuarit do të jetojnë përgjithmonë, ndërsa të tjerët do të pushojnë së ekzistuari, ose që me vdekjen e tyre, ose pas gjykimit, përmes aktit hyjnor të “asgjësimit.”

Megjithatë, ne nuk duhet të harrojmë që i njëjti libër, i cili na tregon për bekimin e përjetshëm të të shpënguarve, gjithashtu

përshkruan dënimin e përjetshëm të atyre që nuk pranojnë hirin e Perëndisë në Krishtin. Ne nuk kemi bazë për shpresën e qiellit derisa ne gjithashtu nuk kuptojmë realitetin e frikshëm të ferrit të përjetshëm.

c. "*Çmoni veten.*" Drejtimet tona morale, të cilat kanë filluar në këtë jetë janë sqaruar kur për secilin prej nesh koha bëhet përjetësi. Si C.S.Lewis (*C.S. Lues*) ka theksuar gjithashtu, kur një njëri këmbëngul në të jetuarin jashtë vullnetit të Perëndisë, vdekja në fund sjell plotësimin e kësaj dëshire. Ky nuk është një gjykim arbitrar nga ana e Perëndisë. Ky është një plotësimi i dëshirës së shprehur në zgjedhjen e bërë nga vetë personi.

Kjo nuk do të thotë se Perëndia nuk gjykon ata që nuk pranojnë Birin e Tij, Jezus Krishtin. Kjo do të thotë që gjykimi i Tij është i bazuar në vet-gjykimin e jetës individuale. Pali tha: "nuk e çmoni (*gjykoni* në disa përkthime) veten të denjë për jetën e përjetshme" (Vep. 13:46), dhe, në greqisht në origjinal, është pikërisht e njëjta fjalë e përdorur kur Gjoni e përshkroi Fronin e Bardhë të lartë në Zbulesën 20 dhe tha, "Dhe pashë të vdekurit, të mëdhenj e të vegjël, që rrinin në këmbë përpara Perëndisë, edhe librat u hapën; dhe u hap një libër tjetër, që është libri i jetës; dhe të vdekurit u gjykuan në bazë të gjërave të shkruara në libra, sipas veprave të tyre." (vargu 12). Perëndia nuk i mallkon njerëzit. Ata mallkojnë veten e tyre.

d. *Ferri*. Ferri nuk është një pamje e këndshme për t'u parë në Dhjatën e Re, dhe shumë do të preferonin ta largonin atë nga mendimet e tyre. Por ta shuash alarmin nuk e largon zjarrin. Termi i Dhjatës së Re për ferrin si një vend dënimi është *gehenna* (greqisht). Ajo është përdorur gjithsej dymbëdhjetë herë, gjithmonë veçse një herë nga Jezusi, Shpëtimtari i dashur dhe i butë.

Duke i vendosur këto referenca së bashku ne zbulojmë se ferri është një vend, jo thjesht një gjendje; ai është një vend vetëdije dhe memorje, një vend torture dhe vuajtje; një vend i ndarjes së përjetshme nga Perëndia dhe jeta, kështu kjo njihet si "vdekja e dytë"; një vend nga i cili s'ka kthim; dhe përfundimisht, një vend tek i cili nuk ka pse të shkosh nëse pranon hirin e Perëndisë në Birin e Tij dhe Shpëtimtarin tonë, Zotin Jezus Krishtin.

Ndërsa lexojmë këto pasazhe serioze, ne kuptojmë që Perëndia na ka treguar neve aq shumë rreth ferrit sa mund të përkthehet në gjuhën e kohës, por që ky realitet është më i tmerrshëm sesa mendja mund të përfytyrojë. Të kalojmë përjetësinë pa dritën e jetës është përtej asaj që kapaciteti ynë mund të kuptojë.

*e. Qielli.* Ashtu si ferri është i pamundur të përshkruhet plotësisht me terma njerëzore, po kështu edhe lavditë e qiellit shkojnë përtej asaj që kapaciteti i të folurit njerëzor ka mundësi për të treguar. Rrethanat më të madhërishme janë pikturuar, dhe është e qartë se realiteti shkon akoma më tutje se imazhi i dhënë. Porta prej perle, rrugë prej ari, një qytet që nuk ka nevojë për diell sepse Krishti i përjetshëm është Drita e tij; zhdukja e vuajtjes, sëmundjes, deformimit, hidhërimit, dhe lotëve - këto janë superlativa për të lëkundur imagjinimin dhe të japin zemër.

Qielli është gjithashtu një vend, jo thjesht një gjendje. Bibla shpall se, çdo gjë që prania e Frymës së Shenjtë brenda nesh do të thotë tek zemra e krishterë, tani e tutje është një "garanci" një shijim i mëparshëm, ose një lloj kapari për atë çfarë pritet të vijë në të ardhmen. (Efe. 13:14).

*O Shpëtimtar, Shpëtimtari im i çnuar,  
Çfarë do të jetë prezenca jote,  
Nëse kjo jetë me gëzim mund të kurorëzojë  
Ecjen tonë në tokë me Ty?*

*Ne besojmë se Zoti Jezus Krisht do të vijë përsëri; se ne që jemi gjallë në ardhjen e Tij nuk do të jemi përpara atyre që kanë fjetur në Krishtin Jezus; por në qoftë se ne jemi në Të, do të merremi sëbashku me shenjtoret e ringjallur për t'u takuar me Zotin në ajër, dhe kështu do të jemi përherë bashkë me Zotin.<sup>12</sup>*

<sup>12</sup> *Ibid.* Neni XV.

*Ne besojmë në ringjalljen e të vdekurve, se trupat e të drejtëve dhe të padrejtëve do të ringjallen në jetë dhe do të bashkohen me shpirtrat e tyre - "ata që kanë bërë të mirën në ringjalljen e jetës; dhe ata që kanë bërë të keqen, në ringjalljen e dënimit."*

*Ne besojmë në gjykimin e ardhshëm në të cilin çdo person do të dalë para Perëndisë për t'u gjykuar sipas veprave të tij ose të saj në këtë jetë.*

*Ne besojmë se jeta e lavdishme dhe e përjetshme është siguruar për ata që i kanë besuar për shpëtim dhe me bindje ndjekin Jezus Krishtin, Zotin tonë; dhe se të papenduarët përfundimisht do të vuajnë përjetësisht në ferr.<sup>13</sup>*

*Ne besojmë se pagëzimi i krishterë, i urdhëruar nga Zoti ynë, është një sakrament që nënkupton pranimin e përfitimeve, që rrjedhin nga shlyerja e Jezus Krishtit, të cilat duhet t'u zbatohen besimtarëve, dhe se ai deklaron besimin në Jezus Krishtin si Shpëtimtarin e tyre dhe dëshirën për bindje në shenjtëri dhe drejtësi.*

*Pagëzim, duke qenë një simbol i besëlidhjes së re, mund të zbatohet edhe për fëmijët e vegjël, me kërkesën e prindërve ose kujdestarëve, të cilët japin garanci se këta fëmijë do të marrin edukimin e duhur të krishterë.*

*Pagëzimi mund të bëhet me spërkatje, derdhje ose zhytje, në përputhje me zgjedhjen e kandidatit.<sup>14</sup>*

*Ne besojmë se Darka Përkujtimore e Kungimit e themeluar nga Zoti dhe Shpëtimtari ynë Jezus Krisht është në thelb një sakrament i Dhjatës së Re, që shpall vdekjen e Tij flijuese, për hir të së cilës besimtarët kanë jetën, shpëtimin dhe premtimin e bekimeve shpirtërore në Krishtin. Veçanërisht, ajo është për ata që janë përgatitur për vlerësimin e thellë të domethënies së saj, me anë të së cilës ata shpallin vdekjen e Zotit derisa Ai të vijë përsëri. Duke qenë*

<sup>13</sup> Ibid, Neni XVI.

<sup>14</sup> Ibid, Neni XII.

*një kremtim bashkësie, vetëm ata që kanë besim në Krishtin dhe dashuri për shenjtorët duhet të thirren që të marrin pjesë.<sup>15</sup>*

*Ne besojmë në doktrinën e Biblës së shërimit hyjnor dhe i nxisim njerëzit të kërkojnë të ofrojnë lutje besimi për shërimin e të sëmurëve. Ne gjithashtu besojmë se Perëndia shëron përmes mjeteve të shkencës mjekësore.<sup>16</sup>*

### Për diskutim të mëtejshëm

1. Cilat janë dy mënyrat që Dhjata e Re flet rreth kishës?
2. Cili është mësimi nga Bibla në lidhje me shërimin hyjnor?
3. Si mund të bëni dallimin ndërmjet shërimit të besimit dhe shërimit hyjnor?
4. Çfarë kuptojmë me esktalogji? Çfarë përfshin ajo?
5. Në çfarë kuptimi është ardhja e Jezusit një ngjarje e dyfishtë? Në ç'kuptim është ajo përfundimtare?
6. Cila është rëndësia e besimit në fatin e përjetshëm?
7. Cila është baza për gjykimin final të Perëndisë mbi njeriun?
8. Çfarë sugjerojnë kufizimet gjuhësore në lidhje me realitetin e qiellit dhe të ferrit?

<sup>15</sup> *Ibid*, Neni XIII.

<sup>16</sup> *Ibid*, Neni XIV.

**Libra të tjerë që janë shkruar ose janë kontribuar  
nga W. T. Purkiser**

Conflicting concepts of Holiness  
(Koncepte konfliktuale të shenjtërisë)

Exploring Christian Holiness,  
Vol. 1: The Biblical Foundations  
(Shqyrtimi i shenjtërisë së krishterë,  
Vëllimi 1: Themelet biblike)

Exploring Our Christian Faith  
(Shqyrtimi i besimit tonë të krishterë)

Exploring the Old Testament  
(Shqyrtimi i Dhjatës së Vjetër)

The gifts of the Spirit  
(Dhuntitë e Shpirtit)

God, Man, and Salvation  
(Perëndia, njeriu dhe shpëtimi)

Know Your Old Testament  
(Njihni Dhjatën tuaj të Vjetër)

The Lordship of Jesus:  
A study in Christian Discipleship  
(Jezusi Zot: Një studim në dishepullizimin e krishterë)

The New Testament Image of Ministry  
(Imazhi i shërbimit në Dhjatën e Re)

Primer in Prayer  
(Udhërrëfyes në lutje)

Security: The False and the True  
(Siguria: E vërteta dhe gënjeshtër)